


# RAPORT

## Kadastri i mbeturinave të rrezikshme dhe kimikateve në Republikën e Kosovës





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry Of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

**AGJENCIA PËR MBROJTJEN  
E MJEDISIT TË KOSOVËS**

**KOSOVSKA AGENCIJA  
ZA ZAŠTITU SREDINE**

**KOSOVO ENVIRONMENTAL  
PROTECTION AGENCY**

---

**Raport**  
**Kadastri i mbeturinave të**  
**rrezikshme dhe kimikateve në Republikën e**  
**Kosovës**

**2021**

## **LISTA E SHKURTESAVE**

AM	Automobilat Mbeturinë
AMMK	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ARBK	Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
ARR	Absolut e Rrezikshme
CAS	Chemical Abstract Service
CLP	Klasifikimi, Etiketimi dhe Ambalazhimi
DK	Doganat e Kosovës
DMM	Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit
ECHA	European Chemical Agency
FSK	Forcat e Sigurisë së Kosovës
GHS	Sistemi i Harmonizuar Globalisht i Klasifikimit dhe Etiketimit të Kimikateve
GLP	Good Laboratory Practices
IUPAC	International Union of Pure and Applied Chemistry
KFOR	Kosovo Force
LTS	Lista Teknike e Sigurisë
MBPZrR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
MND	Mbeturinat nga Ndërtim Demolimi
MRr	Mbeturinat e Rrezikshme
MRRK	Mbeturinat e Rrezikshme dhe Kimikatet
MSh	Ministria e Shëndetësisë
PB	Produkte Biocide
PFSHP	Prodhimi, Formulimi Shpërndarja dhe Përdorimi
PIC	Prior Informed Consent
POP	Persistent Organic Pollutant
PRR	Pasqyruese e Rrezikshme
PZP	Përgjegjësia a Zgjeruar e Prodhuesit
REACH	Registration, Evaluation, Authorisation and Restriction of Chemicals
SIMKRR	Sistemit Informativ i Mbeturinave dhe Kimikateve të Rrezikshme
ToR	Termet e Referencës
UNECE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën
WFD	Direktiva Kornizë e Mbeturinave

<b><u>1</u></b>	<b><u>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</u></b>	<b><u>5</u></b>
<b><u>2</u></b>	<b><u>INFRASTRUKTURA LIGJORE PËR MENAXHIMIN E MRRK .....</u></b>	<b><u>13</u></b>
<b><u>3</u></b>	<b><u>DOKUMENTET DHE RAPORTET RELEVANTE .....</u></b>	<b><u>21</u></b>
<b><u>4</u></b>	<b><u>KADASTRI I MBETURINAVE TË RREZIKSHME .....</u></b>	<b><u>22</u></b>
<b><u>5</u></b>	<b><u>RAPORTIMI I MBETURINAVE TË RREZIKSHME NGA PERSONAT E LICENCUAR DHE OBLIGUESIT TJERË LIGJOR .....</u></b>	<b><u>141</u></b>
<b><u>6</u></b>	<b><u>KADASTRI I KIMIKATEVE TË RREZIKSHME .....</u></b>	<b><u>143</u></b>
<b><u>7</u></b>	<b><u>ZBATIMI I INSTRUMENTIT TË LEJES PËR IMPORTIN DHE FUTJEN NË TREG TË KIMIKATEVE .....</u></b>	<b><u>240</u></b>
<b><u>8</u></b>	<b><u>RAPORTIMI I KIMIKATEVE NGA OBLIGUESIT LIGJOR.....</u></b>	<b><u>242</u></b>
<b><u>9</u></b>	<b><u>GJETJET DHE REKOMANDIMET MBI HAPAT E ARDHSHËM .....</u></b>	<b><u>243</u></b>

## 1 Përmbledhje ekzekutive

Projekti i kadastrit të mbeturinave të rrezikshme dhe kimikateve (MRRK) filloi implementimin më 4 Nëntor 2019. Projekti i është dhënë për implementim kompanisë konsulente KIWER Consulting me seli në Prishtinë. Sipas Termave të Referencës (ToR) është kërkuar zhvillimi i databazës për MRRK për territorin e Republikës së Kosovës përmes së cilës personat e licencuar dhe obliguesit tjerë ligjor do të mund të raportojnë MRRK e tyre nën menaxhim. Me ToR poashtu është kërkuar hartimi i raportit përfundimtar i cili do të përmbaj aspektet relevante të zbatimit të projektit së bashku me analizën e gjendjes së segmentit dhe të dhëna tjera relevante.

Sipas nenit 42 të Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikatet, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), mban regjistrin e përgjithshëm të kimikateve, në formë të shkruar dhe elektronike. Kimikatet që prodhohen, importohen, tregtohen, dhe magazinohen, duhet të regjistrohen në këtë regjistër përmes raportimeve të rregullta të operatorëve të cilët importojnë, prodhojnë, tregtojnë, dhe përdorin këto kimikate.

Poashtu Ligji i Mbeturinave Neni-58 "Raporti për menaxhimin e mbeturinave" thekson: personat e licencuar që merren me menaxhimin e mbeturinave dmth prodhuesit, zotëruesit, eksportuesit dhe ricikluesit duhet të paraqesin raportin vjetor deri më 31 Mars të vitit vijues duke specifikuar të dhënat e mbeturinave që i kanë nën menaxhim ose zotërim.

Sipas ToR-it dhe infrastrukturës ligjore dosja për secilin kimikat të regjistruar duhet të përmbaj:

- emrin tregtar të kimikatit dhe emrin sipas nomenklaturës së kimikateve - IUPAC, si dhe emra tjerë identifikues të kimikateve;
- të dhënat për sasinë e kimikateve të vendosura në qarkullim;
- të dhënat për mënyrën e përdorimit të kimikateve;
- të dhënat për përmbajtjen kimike;
- klasifikimi dhe etiketimi i kimikateve;
- shënimet për vetitë fiziko- kimike të kimikatit;
- shënimet për efektet e kimikatit në mjedis;
- rezultatet nga testimet toksikologjike dhe ekotoksikologjike;
- mënyrat e mundshme të shndërrimit të substancave të rrezikshme në të parrezikshme;
- shënimet për shkallën e pastërtisë dhe përmbajtjen e shtesave të rrezikshme në substancë, nëse ato janë të rrezikshme dhe nëse është e nevojshme për klasifikimin dhe etiketimin e kimikateve të rrezikshme.

Përmbajtja e kadastrit të mbeturinave të rrezikshme sipas ToR-it dhe infrastrukturës ligjore duhet të hartohet dhe të përmbaj:

- vetitë e tyre të rrezikshme (të ndezshme, oksiduese, toksike, gërryese etj),
- vetitë fizike (ngurta, gjysëm të lëngëta, lëngëta),
- licensat mjedisore për administrimin e MRr,
- prodhuesve, zotëruesve, operatorëve për transportim dhe trajtim të MRr,
- sipas sasisë së mbeturinave,
- lokacionit, kohës së krijimit, largimit, etj.
- metodën e trajtimit, magazinimit dhe deponimit,
- objektet për trajtimin e tyre, si dhe
- ambalazhin dhe paketimin.

Strategjia e implementimit të projektit ka qenë që të hartohet një regjistër fillestar i MRRK për vitin 2019 me të dhënat e siguruara nga operatorët, raportet ekzistuese relevante, të dhënat e importeve dhe aplikimit të vlerësimeve dhe kalkulimeve të nevojshme. Përvoja nga ky aktivitet ka shërbyer që të mësohet gjendja aktuale e segmentit, të identifikohen të arriturat problemet dhe pengesat në hartimin e regjistrit të konsoliduar të MRRK si dhe në përpilimin e rekomandimeve të përmirësimit dhe hapave të ardhshëm për klientin respektivisht MEA.

Përvoja nga hartimi i raportit fillestar të MRRK është përdorur edhe në dizajnimin e arkitekturës së databazës elektronike të MRRK e cila i përshtatet në nivel optimal specifikave të Kosovës njëkohësisht duke garantuar përmbushjen e kërkesave të infrastrukturës ligjore.

MRr në Kosovë përbëhen nga MRr që gjenerohen nga procesi i prodhimit të operatorëve si dhe mbeturina të produkteve me përmbajtje të substancave rrezikshme qoftë të përdorura apo të hudhura. Një pjesë e konsiderueshme e MRr është trashëguar nga ish komplekset industriale të paraluftës si ish Kombinati Trepca me njësitë e saja në Mitrovicë, Zveçan, Leposaviq, Pejë dhe Kishnicë, ish kombinati i tekstilit Emin Duraku Gjakovë, Ish Kombinati i Lëkurës në Pejë, ish fabrika e autopjesëve Cërvena Zastava në Pejë, ish Industria e baterive në Gjilan, Ish fabrika e tekstilit në Dragash, ish fabrika për përpunimin e metalit Metallac Janjevë etj. Shumica e këtyre ndërmarryeve është privatizuar dhe i është tjetërsuar destinimi ndërsa pronarët e rinjë i kanë në zotërim të përkohshëm këto mbeturina deri sa të gjendet një zgjedhje e kënaqshme. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre MRr nuk janë të klasifikuara, etiketuara dhe klasifikuara si udhëzohet me infrastrukturën ligjore dhe kjo paraqet problem për regjistrimin e tyre.

Nga të dhënat e siguruar nga operatorët, raportet ekzistuese, të dhënave e importeve dhe vlerësimeve sasia e identifikuar e MRr për vitin 2019 është 192,994.4 ton për të gjitha kategoritë e mbeturinave sipas katalogut shtetëror të mbeturinave. Sasia totale e MRr është shumë herë më e madhe para së gjithash për shkak të MRr nga sterili i flotacionit të xehes sulfide në deponitë e Trepçës (60.4 milion ton), agrokimikateve të skaduara nga ish agrokombinatet që shtrihen gjithandej nëpër komunat e Kosovës, si dhe MRr të trashëguara nga ish komplekset industriale që gjenden të magazinuar në disa hotspote dhe në mbikëqyrje të KFOR dhe FSK.

MRr janë prezentuar në tabelën e mëposhtme sipas kategorive kryesore të mbeturinave të përmbajtura në katalogun shtetëror të mbeturinave respektivisht listës së mbeturinave të BE-së.


Tabela Nr.1 Prezentimi i konsoliduar i mbeturinave të rrezikshme në Kosovë për 2019		
Kategoria	Sasia e mbeturinave e krijuar në 2019	Pjesëmarrja %
Mbeturinat që vijnë si rezultat i eksplorimit, minierave, gurorëve si edhe nga trajtimet fiziko-kimike të mineraleve	110,000 ton	57.0%
Mbeturinat që dalin nga agrokultura, hortikultura, kultura ujore, pylltaria, gjuetia dhe peshkimi, si dhe përgatitja dhe përpunimi i ushqimit	160.8 ton	0.1%
Mbeturinat që dalin nga përpunimi i drurit, prodhimi i paneleve dhe mobilieve, brumit të letrës, letrës dhe kartonit	650 ton	0.3%
Mbeturina që dalin nga industria e lëkurës, gëzofit dhe tekstilit;	-	0.0%
Mbeturinat nga rafinimi i naftës, nga pastrimi i gazit natyror dhe nga trajtime pirolotike të thëngjillit	-	0.0%
Mbeturina nga proceset kimike inorganike	-	0.0%
Mbeturina nga proceset kimike organike	-	0.0%
Mbeturina nga PFSHP i shtresave të ngjyrave (ngjyra, llaqe dhe e-malime të tejudkshme), ngjithësve, puthitësve dhe ngjyrave të makinave për shtypje	24,684.0 ton	12.8%
Mbeturina të industrisë fotografike	7.0 ton	0.0%
Mbeturina nga proceset termike	-	0.0%
Mbeturina nga trajtimi kimik i sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve dhe materialeve të tjerë; hidrometalurgjia e metaleve joferrorë	-	0.0%
Mbeturina nga trajtimi fiziko-mekanik dhe dhënia e formës së metaleve dhe plastikave	-	0.0%
Mbeturinat e vajrave dhe mbeturina të karburanteve të lëngshëm (përveç vajrave ushqimore në kapitullin 05 dhe 12)	5,016.6 ton	2.6%

Mbeturina të tretësve organike ftohës dhe pompues /shtytes (përveç 07 dhe 08)	-	0.0%
Paketime mbeturinash; absorbente, rroba fshirëse, materiale të filtrave dhe rroba mbrojtëse të paspecifikuara ndryshe	-	0.0%
Mbeturina të paspecifikuara në listë	4,393.0 ton	2.3%
Mbeturinat nga konstrukt demolimi (përfshirë dhera të gërmuara nga zona të kontaminuara)	3,707.0 ton	1.9%
Mbeturina nga kujdesi shëndetësor njerëzor ose shtazor dhe kërkime që lidhen me to (me përjashtim të mbeturinave të kuzhinave dhe restoranteve që nuk lidhen drejtpërdrejt me kujdesin shëndetësor)	2,000.0 ton	1.0%
Mbeturinat nga nga impiantet e trajtimit të mbeturinave, të ujërave të ndotur (jo në vend) dhe përgatitja e ujit për përdorim njerëzor dhe industrial;	33,901.0 ton	17.6%
Mbeturina komunale (mbeturina shtëpiake dhe tregtare, mbeturina industriale e institucionale të ngjashme) përfshirë fraksionet e mbledhura ndaras	8,475.0 ton	4.4%
<b>Total:</b>	<b>192,999.4 ton</b>	<b>100 %</b>

Kjo sasi e mbeturinave është provizore dhe e bazuar në raportimet vullnetare të operatorëve kryesorë përmes plotësimit të pyetësorëve si dhe shfrytëzimit të të dhënave të importeve nga Doganat e Kosovës (DK) për vitin 2019 si dhe vlerësimin dhe kalkulimin e sasive të pritshme të MRr duke zbatuar parametrat përkatës.

Sasia reale e MRr pritet që të jetë më e madhe nga regjistri fillestar për faktin se ka shumë operatorë që nuk kanë mundur të identifikohen, ose janë të vegjël për nga madhësia dhe të shpërndar gjithandej ndërsa nuk kanë mundur të aplikohen kalkulimet apo vlerësimet zëvendësuese për ata. Sido që të jetë të dhënat e MRr priten të konsolidohen në vitet e ardhëshme kur të funksionalizohet databaza e MRr dhe e njëjta të shfrytëzohet si vegël raportimi nga personat që obligohen të raportohen bazuar nga infrastruktura ligjore.

Sipas të dhënave të përpunuara kategoritë kryesore të gjenerimit të MRr janë Kategoria 1 „Mbeturinat që vijnë si rezultat i eksplorimit, minierave, gurorëve si edhe nga trajtimet fiziko-kimike të mineraleve“ 57.0%, e pasuar nga kategoria 19 „Mbeturinat nga nga impiantet e trajtimit të mbeturinave, të ujërave të ndotur (jo në vend) dhe përgatitja e ujit për përdorim njerëzor dhe industrial 17.6%“, pastaj kategoria 9 „Mbeturina nga PFSHP i shtresave të ngjyrave (ngjyra, llaqe dhe e-malime të tejdukshme), ngjitësve, puthitësve dhe ngjyrave të makinave për shtypje“ 12.8 %, kategoria 20 „Mbeturina komunale (mbeturina shtëpiake dhe tregtare, mbeturina industriale e institucionale të ngjashme) përfshirë fraksionet e mbledhura ndaras“ 4.4% e kështu me radhë.



Kimikatet sipas Ligjit të Kimikateve dhe direktivave të KE përshkruhen si substanca apo përzierje. Kimikatet e rrezikshme përbëjnë shumicën e kimikateve konsiderohen si substanca me veti të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin ujor dhe jujor.

Sipas ligjit të kimikateve qdo kimikat që është i futur në treg në Kosovë duhet të regjistrohet në MEA duke parashtruar informacionet e kërkuara si emrin tregtar dhe kodin IUPAC të kimikatit, sasinë e kimikateve të vendosur në qarkullim, mënyrën e përdorimit, përmbajtjen kimike, klasifikimin dhe etiketimin, vetitë fiziko- kimike, ndikimin në mjedis, etj.

Regjistri fillestar i kimikateve për 2019 është bazuar nga të dhënat e importeve të Doganave të Kosovës (DK) meqë sasinë e kimikateve të cilat janë pajisur me leje të importit nga MEA është simbolik.

Tabela Nr. 2: Importet e kimikateve sipas DK për vitin 2019		
Kodi Tarifor	Vlera Mallrave (€)	Netweight (kg)
<b>Kimikate inorganike</b>	<b>4,435,685.6</b>	<b>15,882,465.9</b>
Elementet Kimike	1,210,641.0	2,704,123.3
Acidet inorganike dhe përbërjet inorganike të oksigjenit të jometaleve	1,004,271.7	6,977,955.1
Përbërjet halogjene apo sulfurore të elementeve jometalike	1,269.0	3.6
Bazat inorganike dhe oksidet inorganike; hidroksidet dhe peroksidet e metaleve	783,180.03	3,660,369.76
Kripërat dhe peroksikripërat, të acideve inorganike dhe metaleve	1,169,474.8	2,342,503.0
Kimikate të ndryshme inorganike	266,849.1	197,511.3
<b>Kimikate organike</b>	<b>7,203,260.1</b>	<b>5,595,583.2</b>
Hidrokarbonet dhe derivatet e tyre, të halogjenuara, të sulfonatuara, nitratuara apo të nitrosuara	250,166.9	132,948.3
Alkoolët dhe derivatet e tyre, të halogjenizuara, të sulfonatuara, të nitratuara apo të nitrosatuara	1,247,456.3	1,941,361.9
Fenolet, fenol-alkoolët, dhe derivatet e tyre	586.6	7.8
Eteret, peroksidet alkoolike, peroksidet eterike, peroksidet ketonike, epoksidet me tre atome brenda ciklit, acetalet dhe hemiacetalet, dhe derivatet e tyre të halogjenizuara, të sulfonatuara, të nitratuara apo të nitrosatuara	272,630.0	57,028.8
Përbërjet me grupe funksionore aldehide	10,295.4	6,762.8
Përbërjet me grupe funksionore ketonike dhe përbërjet me grupe funksionore kinonike	21,987.1	10,869.4

Acide karboksilike dhe anhidritet, halidet, peroksidet dhe peroksiacidet e tyre, dhe derivatet e tyre të halogjenizuara, të sulfonatuara, të nitratuara apo të nitrosaturuara	1,625,288.3	1,646,107.2
Esteret e acideve inorganike dhe kripërat e tyre, dhe derivatet e tyre të halogjenizuara, të sulfonatuara, të nitratuara apo të nitrosaturuara	376,952.6	4,292.5
Përbërjet me grupe funksionore azoti	2,950,982.1	1,696,897.2
Përbërjet organo- inorganike, përbërjet heterociklike, acidet nukleike dhe kripërat e tyre dhe sulfonamidet	408,261.4	96,473.2
Glykocidet dhe alkaloidet, natyrale apo të riprodhuara nga sintezat, dhe kripërat, eteret, Esteret dhe derivatet e tjera të tyre	19,124.0	1,385.9
Përbërje të tjera organike	19,529.4	1,448.2
<b>Ekstraktet ngjyrosëse dhe tanike; taninet dhe derivatet e tyre; ngjyrosësit, pigmentet dhe lëndë të tjera ngjyrosëse; Bojrat dhe llustruesit; stuko dhe mastice të tjera; bojrat e shkrimit</b>	<b>33,929,389.1</b>	<b>71,846,950.3</b>
Ekstraktet tanine me origjinë vegjetale; taninet dhe kripërat e tyre, eteret, esteret dhe derivatet e tjere	3,268.8	1,360.0
Substancat organike sintetike tanine; substancat inorganike tanine; preparatet tanine	32,249.3	10,852.6
Lëndë ngjyrosëse me origjinë bimore apo shtazore përfshirë edhe ekstraktet ngjyrosëse	98,591.5	12,168.6
Lëndë ngjyrosëse organike sintetike; preparatet e bazuara në lëndë ngjyrosëse organike sintetike	505,044.8	131,498.2
Llaçet ngjyruese; preparatet e bazuara në llaçet ngjyrosëse	10,486.6	712.6
Lëndë të tjera ngjyruese; produktet inorganike të një lloji të përdorur si luminifore	1,637,266.8	723,110.2
Pigmentet e përgatitura, preparatet opake të përgatitura dhe ngjyruesit e përgatitur, smaltrat dhe glazurat e qelqëzuara, bojrat e glazurave, llustra të lëngshme dhe preparate të ngjashme	209,968.5	16,720.8
Bojrat dhe llustruesit bazuar në polimere sintetike apo polimere natyrale kimikisht të modifikuara	5,769,474.4	2,664,937.1
Bojrat dhe llustruesit bazuar në polimeret sintetike apo në polimeret natyrale të modifikuara kimikisht	4,244,030.0	6,127,372.4
Tharësit e përgatitur	195,046.8	65,388.2
Pigmentet përfshirë pluhurat dhe fetezat metalike të shpërndara në një mjedis jo ujor	251,063.6	52,539.5
Bojra për piktura artistike, të studenteve apo bojrat për tablele, modifikuesit e gradacionit të ngjyrave, ngjyrat për zbavitje	246,248.9	50,778.8
Stuko xhami, stuko transplatuese, çimento resini, përbërjet stukuese dhe mastice të tjera; mbushjet që përdoren në piktura	19,120,465.1	61,498,818.0
Bojra shkrimi, bojrat shtypi dhe vizatimi dhe bojra të tjera	1,270,887.7	227,913.3
<b>Plehëruesit</b>	<b>8,347,455.72</b>	<b>26,681,223.42</b>
Plehëruesit me origjinë bimore apo shtazore, nëse janë apo jo të përzier së bashku apo të trajtuar kimikisht; plehëruesit e prodhuar nga përzierja apo trajtimi kimik i produkteve bimore apo shtazore	134,159.3	448,792.0
Plehëruesit mineral apo kimik, azotike	128,836.8	424,452.0
Plehëruesit minerale apo kimike, fosfatike	110,715.0	651,750.0
Plehëruesit minerale apo kimike, potasike	47,129.7	26,424.8
Plehëruesit minerale apo kimike që përmbajnë dy apo tre prej elementeve plehërues nitrogjen, fosfor dhe kalium; plehërues të tjerë; mallrat e këtij Kapitulli në tableta apo në forma apo në paketa të ngjashme të një peshe bruto jo më tepër se 10 kg	7,926,614.9	25,129,804.6
<b>Agjentët organike me veprim të sipërfaqshëm, preparatet larëse, preparatet lubrifikuese, dyllet artificiale, dyllet e përgatitura, preparatet lustrosje apo pastruese, qirinjtë dhe artikujt të ngjashëm, pastat modeluese, "dyllet dentare" dhe preparatet dentare me bazë allçie</b>	<b>35,051,534.08</b>	<b>33,582,619.29</b>
Agjentet organike me veprim sipërfaqësor; preparatet me veprim sipërfaqësor, preparatet larëse dhe preparatet pastruese	30,535,785.4	31,807,195.0
Preparatet lubrifikuese (përfshirë vajin ftohës, përgatitjet për çlirim dhe dadove dhe bulonave, preparatet anti-ndryshk apo anti-korozionit dhe preparatet për levizjen nga format nga kallëpi, bazuar në lubrifikantet) dhe preparatet e një lloji të përdorur për trajtimin vajor apo lubrifikues të materialeve tekstile, lëkureve, gëzofeve apo materialeve të tjera	2,551,208.4	803,048.6
Dyllet artificiale dhe dyllet e përgatitura	71,770.0	19,540.5
Lustruesit dhe kremrat, për mbathjet e këmbëve, mobiljet, dyshemetë, karrocërite, qelqit apo metalit, pastat dhe pluhurat për pastrim dhe preparate të ngjashme (nëse janë apo jo në formë te letrave, mbushjeve, shajakut, tekstileve të pathurura, të gomës poroze apo të plastikave poroze, të ngopura, veshura apo mbuluara me preparate të tillë	1,308,379.2	734,685.4

Qirinjtë, qirinjtë e hollë dhe të ngjashmit e tyre	239,015.1	112,799.4
Pastat për modelim, përfshirë edhe ato të ndërtuara për argëtimin e fëmijëve; preparatet e njohura si "dylle dentare" apo si " përbërje për gjurmë në stomatologji", vendosur në komplete, në paketa për shitjen me pakicë apo në pllaka, formë patkoi, shufra apo në formë të ngjashme; preparate të tjera për përdorim në stomatologji, me bazë allçie	345,375.9	105,350.3
<b>Produkte të ndryshme kimike</b>	<b>24,484,471.91</b>	<b>59,159,691.39</b>
Grafiti artificial; grafitet koloidal apo gjysem koloidale	1,929,300.8	2,808,038.7
Karbon i aktivizuar; produkte minerale natyrale të aktivizuara; qymyr me origjinë shtazore	235,568.3	312,948.0
Vaj tall, nëse është apo jo i rafinuar	13,146.7	25,815.0
Finjë mbeturinash të rrjedhura nga përpunimi i brumit të drurit	526.65	1,275.00
Rrëshirë, terpine druri apo sulfati dhe vajra të tjera terpenike prodhuar prej distilimit apo ndonjë trajtimi tjetër të drurëve halore	738.42	90.00
Acidet e kollofonit dhe të rreshirës, dhe derivatet prej tyre; alkoolet e kollofonit dhe vajrat e tij	13,722.3	9,471.0
Katran druri; vajrat e katranit të drurit; krezot druri; ligroine druri; katranet vegjetale; katran nga zierja e birrës dhe preparate të ngjashme të bazuara në kollofon	67.6	25.3
Insekticidet, rodenticidet, fungicidet, herbicidet, produktet kundër rritjes dhe rregullatoret e rritjes së bimëve, disinfektantet dhe produkte të ngjashme	4,417,244.7	804,934.9
Agjentet ilustrues, agjentet mbajtëset e bojës për të shpejtuar ngjyrosjen apo fiksimin e bojrave dhe produkte dhe preparate të tjera të një lloji përdorur në industrinë e tekstilit, të letrës, lëkurës apo në industri të ngjashme	2,319,804.1	2,328,416.9
Preparatet për piklim për sipërfaqet metalike; flukset dhe preparate të tjera ndihmëse për saldim, saldim të ngurtë apo për tegel saldimi	211,139.3	179,122.5
Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi, stabilizator rrëshirë, përmirësues viskoziteti, preparatet kundër korrozionit dhe elemente të tjera të përgatitura shtesë, për vajrat minerale	115,472.3	47,326.0
Përsheptuesit e përgatitur prej gomës; plastifikues të përbërë për plastike dhe gomë, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër; preparatet anti-oksides dhe stabilizatore të tjerë të përbërë prej gome dhe plastike	179,321.4	36,230.1
Preparatet dhe ngarkesat për zjarrfikëset; ngarkesat për granadat zjarrfikëse	36,869.2	30,098.0
Solventet dhe hollues me përbërje organike, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër; fshirësit e përgatitur të bojrave apo të llustrosesve	694,999.63	544,995.29
Nismetaret e reaksioneve kimike, përsheptuesit e reaksioneve kimike dhe preparatet katalitike, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	120,412.6	42,325.1
Çimento refraktare, llaç, beton refraktar dhe përbërje të ngjashme	1,399,473.6	2,116,657.2
Lëngjet për frenat hidraulike dhe lëngje të tjera të përgatitura për transimion hidraulik, që nuk përmbajnë apo që përmbajnë më pak se 70 % ndaj peshë vajra naftë apo vajra të fituara nga mineralet bituminoze	221,309.7	113,419.3
Preparatet anti-ngjirje dhe fluide të përgatitura për shkrirje akulli	2,027,428.1	2,011,066.9
Mjedis i përgatitur për kulturat për zhvillimin e mikro-organizmave apo të qelizave të bimëve, njerëzve apo shtazëve	228,447.0	16,018.7
Reagentët diagnostikues apo laboratorik mbi një bazament dhe reagentët e përgatitur diagnostikues apo laboratorik nëse janë apo jo mbi një bazament	3,052,171.7	97,255.5
Lidhësit e përgatitur për format apo kallëpet apo zemrat në fonderi; produktet kimike dhe preparatet kimike të industrive kimike apo të lidhjeve	7,250,401.3	47,622,056.0
Produkte mbetje të industrise kimike apo të industrive të lidhura me të, të papërmendura apo të papërfshira diku tjetër; mbeturinat urbane; llumrat e ujrave të zeza; mbeturina të tjera të përcaktuara në shenimin 6 të këtij kapitulli:	169.87	5.70
<b>Mallrat fotografike apo kinematografike</b>	<b>935,802.2</b>	<b>70,777.6</b>
Pllakat fotografike dhe filma jo në role prej çdo lloj materiali, të ndjeshëm dhe të paekspozuar, përveçse letrës, kartonit apo tekstileve; filma fotografike të menjëhershëm jo në role, të ndjeshme, të paekspozuar, nëse janë apo jo në paketa	505,031.1	29,067.6
Filma fotografike në role, të ndjeshëm, të paekspozuara, prej çdo lloj materiali përveç letrës, kartonit apo tekstileve; filma fotografike të menjëhershëm në role, të ndjeshëm të paekspozuar	15,332.8	1,712.1
Letër, karton dhe tekstil fotografik, të ndjeshme, të paekspozuara	62,860.0	18,131.2

Pllaka, filma, letër, karton dhe material tekstili fotografik, të ekspozuara por jo të zhvilluara	0.0	0.0
Pllakat dhe filma fotografike, të ekspozuara dhe të zhvilluar, përveçse filmat kinematografike	0.0	0.0
Filma kinematografike, të ekspozuara dhe të zhvilluara, nëse janë të ndërthurur apo jo me kotone zanore apo që konsistojnë vetëm në gjurmët e zërit:	0.0	0.0
Preparatet kimike për përdorim fotografik	352,578.3	21,866.7
<b>Total importe të kimikateve për 2019</b>	<b>114,387,598.7 €</b>	<b>212,819.3 ton</b>

Vlera e kimikateve të futura në qarkullim për 2019 është gjithsej 213 ton apo 114 milion € e shprehur në vlerë monetare dhe kjo vlerë korrespondon me sasinë e importeve të kimikateve sipas të dhënave të DK për 2019. Kjo vlerë reflekton besueshëm edhe sasinë e përdorur të kimikateve meqë shumica dërmuese e kimikateve importohen ndërsa nuk prodhohen përbrenda dhe se sasia e importeve diktohet nga kërkesa e tregut.

Disa nga gjetjet e procesit janë të prezantuara si në vijim:

Nga gjithë obliguesit ligjor vetëm Ferronikeli, Sharrceci dhe KEK-u kanë raportuar mbi MRR si pjesë e raporteve vjetore mjedisore. Sa i përket kimikateve vetëm KEK-u ka raportuar mbi përdorimin e tyre.

Vetëm një numër simbolik i operatorëve ka apliku për leje të importit të kimikateve të MEA dhe kjo është në disproporcion të theksuar me sasinë e kimikateve të importuara sipas të dhënave të DK të cilat kanë hyrë në Kosovë dhe futur në treg. Poashtu obligimi i regjistrimit të kimikateve që futen/qarkullojnë në treg tek MEA është zbatuar simbolikisht.

Raportimi aktual i MRRK nga operatorët si Ferronikeli, Sharrceci dhe KEK-u megjithatë është i pjesshëm referuar kërkesave ligjore dhe duhet të përmirësohet respektivisht të avancohet.

MEA ka lëshuar licenca operimi për disa operatorë, kryesisht të grumbullimit, riciklimit dhe trajtimit të vajrave mbeturinë dhe produkteve të naftës. Megjithatë këta operatorë nuk raportojnë mbi mbeturinat që i gjenerojnë përkundër se kjo është obligim ligjor i sanksionuar në kushtet e licencë dhe se një gjë e tillë i'u është kërkuar edhe nga ekipi i projektit.

Infrastruktura ligjore kërkon që operatorët e qendrave të grumbullimit dhe çmontimit të automjeteve mbeturinë, akumulatorëve dhe baterive, MPEE, dhe rrjedhave tjera të mbeturinave t'i nënshtrohen procesit të licencimit për të ushtruar veprimtarinë e tyre. Por referuar të dhënave të MEA këta operatorë vazhdojnë veprimtarinë pa u pajisur me leje.

Në Kosovë ngadal por sigurt po hapen veprimtari të ndryshme ekonomike prodhuese që në rrjedhë të veprimtarive të tyre përdorin kimikate si dhe prodhojnë mbeturina një pjesë e të cilëve mund të jenë të rrezikshme. Këtu përfshihen prodhuesit e mobileve dhe përpunuesit e drurit, prodhuesit e barnave, industria e ngjyrave dhe materialeve ndërtimore, etj. Këta prodhues dhe operatorë nuk janë në dijeni mbi kërkesat ligjore të raportimit të mbeturinave të rrezikshme dhe kimikateve dhe kërkesave tjera të infrastrukturës ligjore.

Mosnjohja e infrastrukturës ligjore dhe mungesa e kapaciteteve të operatorëve të lartëcekur jo vetëm që ka impakt në identifikimin e kimikateve në qarkullim dhe mbeturinave të rrezikshme të gjeneruara apo në zotërim, por ajo ka të ngjarë që të shpie te menaxhimi joadekuat i tyre karshi kërkesave ligjore dhe dëmtimit të shëndetit njerëzor dhe mjedisit.

Konkretisht ka mundësi reale që një pjesë e vajrave mbeturinë dhe drurit mbeturinë me përbërës të rrezikshëm të përdoren si lëndë djegëse, pastaj llumrat e proceseve prodhuese industriale dhe kimikateve të skaduara të shkarkohen të patrajuara në kanalizim apo mjedis ujor.

Ne vijim janë dhënë disa nga rekomandimet për hapat që duhet të ndërmerren në përmirësimin e gjendjes së raportimit të MRRK dhe menaxhimit më të mirë të tyre:

- Koordinimi me DK për të parandaluar importimin dhe futjen e kimikateve në treg pa pajisjen e lejeve për kimikate nga MEA konform kërkesave të Ligjit të Kimikateve. Ky zhvillim do të sillte ndërmjet tjerash edhe deri te identifikimi i të gjithë operatorëve që

importojnë, tregtojnë dhe përdorin kimikate të rrezikshme dhe vjeljes së taksës nga MEA për subjektet e lartëcekura

- Hartimi i strategjisë së kimikateve përveq se do të përmbushte obligimin ligjor do të ndihmonte me plane dhe aktivitete konkrete konsolidimin e regjistrimit të MRK
- Trajnimi kontinual i MEA dhe obliguesve ligjor në lidhje me procesin e raportimit të MRRK është shumë i rëndësishëm që të futen të gjithë obliguesit ligjor nën skemën e raportimit dhe të sigurohet informacion i besueshëm dhe i konsoliduar
- Intensifikimi i implementit të skemave të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP): do të siguronte që shumica dërmuese e MRr për rrjedha të caktuara të mbeturinave do të futeshin nën skemën e PZP dhe do të raportoheshin konform kërkesave ligjore
- Bashkëpunimi me komunat është i rëndësishëm esenciale që të identifikohen obliguesit ligjor dhe që raportimi i tyre të jetë i besueshëm dhe i konsoliduar
- Zhvillimi i një databaze elektronike për qarkullimin, regjistrimin dhe importin e kimikateve të rrezikshme do të siguronte që MEA ta zbatojë në mënyrën efikase procesin e shqyrtimit të aplikacioneve për leje të importit dhe regjistrimit të kimikateve si dhe ky informacion të integrohet me databazën e MRRK
- Bashkëpunimi me Odën Ekonomike të Kosovës (OEK), shoqatat dhe akterët tjerë do të ishte në funksion të identifikimit të obliguesve ligjor të raportimit dhe sensibilizimit të gjithë akterëve dhe shoqërisë mbi rëndësinë e menaxhimit të duhur të MRRK dhe raportimit të tyre tek AMMK

## 2 Infrastruktura ligjore për menaxhimin e MRRK

Infrastruktura ligjore relevante që rregullon sferën e kimikateve dhe mbeturinave të rrezikshme përfshin aktet ligjore sa vijon:

- Ligji nr.03/l-025 për mbrojtjen e mjedisit;
- Ligji nr. 04/l-060 për mbeturina;
- Ligji nr. 04/l-197 për kimikate;
- Ligji nr. 03/l-042 i produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Ligji nr.03/l-119 për produktet biocide;
- Udhëzimi administrativ nr. 13/2013 për katalogun Shtetëror të mbeturinave;
- Udhëzimi Administrativ (UA) nr.20/2012 për eksport, import dhe tranzit të mbeturinave, nënshkruar;
- UA nr.05/2013 Për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinat me vajra;
- UA nr.16/2013 Për Vlerat kufitare të përqëndrimeve për komponentet e rrezikshme në mbeturina;
- UA nr. 22/2013 Për administrimin e mbeturinave medicinale humane dhe veterinare;
- UA nr. 25/2014 Për administrimin e mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike;
- UA nr. 26/2014 Për mbeturinat nga bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar;
- UA nr. 05/2015 Për menaxhimin e bifenileve dhe trefenileve të polikloruara dhe mbeturinave me PCB dhe PCT;
- UA nr. 15/2015 Për administrimin e mbeturinave nga gypat fluoreshent që përmbajnë merkur;
- UA nr. 22/2015 për administrimin e mbeturinave që përmbajnë azbest;
- UA nr. 02/2017 Për listën e kategorive të mbeturinave të rrezikshme sipas origjinës;
- UA nr. 13/2017 Për menaxhimin e mbeturinave Medicinale- Patologjike;
- UA nr.14/2017 për menaxhimin e mbeturinave që përbejnë materie me ndotës organik të qëndrueshëm;
- UA nr.10/2011 për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme;
- UA për listën teknike të sigurisë për kimikate, përmbajtjen dhe mënyrën e plotësimit të sajë; dhe
- UA nr 07/2014 për kompetencat e zotëruesit të mbeturinave prodhuesit dhe importuesit të produktit.

Analiza e provizioneve kyçe ligjore të akteve të sipërpërmendura që ka ndikim në menaxhimin e kimikateve dhe mbeturinave të rrezikshme është dhënë si në vijim:

### 2.1 Ligji i mbeturinave 04 / L - 60

Ligji i mbeturinave është ligji bazik i cili e rregullon menaxhimin e mbeturinave në Kosovë përfshi edhe menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme. Ligji përcakton autoritet kompetente, mandatet e tyre, klasifikimin e mbeturinave, listën e kategorive të mbeturinave të rrezikshme sipas origjinës dhe përmbajtjes (lista Y), lista e komponentëve në mbeturina, prezenca e të cilave i bëjnë mbeturinat të rrezikshme (lista C); vlerat kufitare të koncentrimave për komponentët e rrezikshme në mbeturina në bazë të cilave përcaktohen karakteristikat e mbeturinave; parametrat për caktimin e veçorive fiziko-kimike të mbeturinës së rrezikshme, e cila do të dërgohet për trajtim fizik dhe kimik; dhe aspektet tjera të mbeturinave të rrezikshme.

Mbeturinat klasifikohen sipas katalogut shtetërorë të mbeturinave i cili është kompatibil me Katalogun Evropian të mbeturinave. Mbeturinat e rrezikshme klasifikohen sipas origjinës, veçorive dhe përmbajtjes nga e cila behët e rrezikshme.

Ministria, me akt nënligjor nxjerr; katalogun shtetërorë të mbeturinave; listën e kategorive të mbeturinave (Lista -Q); listën e kategorive të mbeturinave të rrezikshme sipas origjinës dhe përmbajtjes (lista Y); lista e komponentëve në mbeturina, prezenca e të cilave i bëjnë mbeturinat të rrezikshme (lista C); vlerat kufitare të koncentrimave për komponentët e

rrezikshme në mbeturina në bazë të cilave përcaktohen karakteristikat e mbeturinave; llojin dhe përmbajtjen e formës për raportimin për ekzaminimin e mbeturinave; parametrat për caktimin e veçorive fiziko-kimike të mbeturinës së rrezikshme, e cila do të dërgohet për trajtim fizik dhe kimik; parametrat për ekzaminimin e mbeturinës dhe shqyrtimin e aluatit dhe kullimit nga deponimi i realizuar i mbeturinave; mënyrën dhe procedurën e klasifikimit të mbeturinave.

Mbeturinat e rrezikshme konsiderohen mbeturinat që paraqesin një apo më shumë vetitë e rrezikshme të listuara në Shtojcën III si eksplozive, irrituese, kancerogjenike, korrozive, mutagjenike, toksike, e kështu me radhë. Ministria sipas ligjit mbulon shpenzimet administrative dhe të menaxhimit të mbeturinave përfshi mbeturinat e rrezikshme të cilat nuk janë në kompetencë të komunës dhe kur zotëruesi i tyre nuk është i njohur.

Zotëruesit e mbeturinave përfshirë dhe operatorët që bëjnë grumbullimin, transportimin, trajtimin, përpunimin, magazinimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave duhet të jenë të licencuar dhe të regjistruar në regjistrin për menaxhimin e mbeturinave. Ata poashtu janë të obliguar që të raportojn tek ministria mbi mbeturinat që i kanë nën zotërim apo menaxhim.

Prodhuesi i mbeturinave është i detyruar që të: pajiset me dokumentacion përkatës për përcaktimin e veçorive të rrezikshme të mbeturinave nga laboratorit i autorizuar si dhe mbledh dhe klasifikoj mbeturinat, varësisht nga mënyra e trajtimit të tyre. Prodhuesi i mbeturinave të rrezikshme duhet të hartoj raportin vjetor për menaxhimin e mbeturinave të cilin në afatin e caktuar ia dorëzon organit kompetent.

Sistemi i informimit për menaxhimin e mbeturinave përmban shënimet nga planet e menaxhimit të mbeturinave nga operatorët dhe prodhuesit e mbeturinave të rrezikshme; regjistrin dhe shënimet për licensat e lëshuara për menaxhimin e mbeturinave; regjistrin dhe shënimet për lëshimin e lejeve për importimin, eksportimin dhe kalimin tranzit të mbeturinave; shënimet për sasinë e llojeve të mbeturinave, që janë importuar, eksportuar dhe kanë kaluar tranzit.

Regjistri i të dhënave përmban shënimet për llojin, karakteristikat, sasinë, klasifikimin e mbeturinave dhe lejet për objektet për menaxhimin e mbeturinave. Raporti për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Republikës së Kosovës, hartohet për çdo vitë dhe i prezantohet Qeverisë në tre(3) mujorin e dytë të vitit vijues. Zotëruesit dhe prodhuesit e mbeturinave të rrezikshme janë të detyruar t'i paraqesin raportin vjetor deri më 31 mars të vitit vijues.

Personat e licencuar që merren me menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme duhet të paraqesin raportin vjetor deri më 31 Mars të vitit vijues. Raporti vjetor duhet të përmban të dhënat për: llojin, përbërjen, karakteristikat, sasinë, origjinën, ruajtjen, transportin, trajtimin, përpunimin, riciklimin, magazinimin dhe deponimin e mbeturinave si dhe mbeturinave të cilat pranohen në objektet dhe pajisjet për menaxhimin e mbeturinave.

## **2.2 Ligji i Kimikateve 04 / L - 197**

Ligji në fjalë përcakton kushtet për vendosjen në treg të substancave dhe pëzierjeve të rrezikshme si dhe përcaktimin e mënyrës së kontrollimit të tyre; përcaktimin dhe vlerësimin e rreziqeve që mund të ndikojnë dëmshëm në shëndetin e njëriut dhe mjedisin; shqyrtimin dhe lëshimin e lejeve për qarkullimin, trajtimin dhe përdorimin e kimikateve.

Ligji rregullon mbajtjen e regjistrit të kimikateve, regjistrin e personave fizik dhe juridik që tregtojnë dhe përdorin kimikatet; kushtet për klasifikimin, etiketimin, paketimin, importin, eksportin dhe tranzitin e kimikateve të rrezikshme si dhe përgjegjësitë e autoritetit kompetent për zbatimin dhe monitorimin e këtij ligji.

Kimikatet sipas ligjit përfshijnë substancat kimike dhe pëzierjet / preparatet kimike. Operatorët relevant për Ligjin janë prodhuesit, eksportuesit, importuesit, shpërndarësit, furnizuesit dhe përdoruesit. Kimikate të rrezikshme konsiderohen kimikatet që klasifikohen si të tilla sipas Rregullores (EC) 1272/2008 mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin të substancave dhe pëzierjeve.

Autoriteti kompetent për administrimin e kimikateve në kuadër të këtij ligji është MEA. MEA përcakton kushtet për administrimin dhe mbikqyrjen për detergjentet, kimikatet e rrezikshme që përdoren në industrinë minerare/ekstraktive dhe të ngjyrave, substancat dhe përzierjet e rrezikshme që përdoren për hulumtime dhe studime shkencore në laboratorë dhe për koordinimin dhe mbikqyrjen e hulumtimeve shkencore të cilat do të kryhen sipas dispozitave të këtij ligji. MEA, sipas këtij ligji, është autoriteti kompetent për bashkëpunimin me Agjencinë Evropiane për Kimikate (ECHA).

MEA harton legjislacionin dhe aktet nenligjore për menaxhimin e kimikateve; publikon listën e klasifikimit dhe etiketimit të harmonizuar të substancave të rrezikshme; publikon listën e substancave me rrezik të lartë - listën e substancave kancerogjene, mutagjene, azo-ngjyrave; listën e kimikateve të rrezikshme të ndaluara dhe kufizuara për përdorim.

MEA mban regjistrin e përgjithshëm të kimikateve; lëshon leje për prodhimin, importin, eksportin, vendosjen në treg dhe përdorimin e kimikateve të rrezikshme; lëshon leje për shfrytëzimin e substancave tension-aktive në detergjente; bën heqjen e kimikateve nga tregu ose kufizimin e përdorimit të tyre kur përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisit;

MEA mban të dhëna mbi rrezikshmërinë e kimikateve; harton raportin vjetor për gjendjen e kimikateve si pjesë e raportit për gjendjen e mjedisit. MEA sipas ligjit bënë mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe shkëmbimin e informacioneve me institucionet vendore për kimikatet.

MEA, harton Strategjinë për menaxhimin e kimikateve në Republikën e Kosovës për një periudhë kohore dhjetë (10) vjeçare, të cilën e miraton Qeveria.

### **2.3 Ligji i produkteve biocide nr. 03/L-119**

Dispozitat e Ligjit të kimikateve nuk zbatohen për kimikatet që hidhen në treg si produktet për mbrojtjen e bimëve; dhe produktet biocide (PB).

Qëllimi i Ligjit të Produkteve Biocide është të caktoj dhe të rregulloj kushtet për vendosjen në treg dhe përdorimin e substancave aktive që përdoren për prodhimin e produkteve biocide (PB). Substancat aktive lejohen të vendosen në treg dhe të përpunohen në produkte biocide nëse janë të regjistruara apo në proces të regjistrimit në listat e substancave I, ose IA të harmonizuara të cilat gjenden në Shtojcën I.; IA.; IB.; të Direktivës 98/8/EC. Substancat themelore mund të vendosen në treg dhe përdoren si produkte biocide vetëm nëse janë të regjistruara në Listën e substancave IB, dhe nëse janë plotësuar kushtet për klasifikim, paketim, shënjim në pajtim me dispozitat e këtij ligji, si dhe nëse është punuar Lista teknike e sigurisë sipas Ligjit për Kimikate.

### **2.4 UA 2014/17 për klasifikim, etiketim dhe paketim të kimikateve të rrezikshme**

Ky udhëzim transpozon Rregulloren (EC) 1272/2008 mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve dhe e komplementon ligjin e kimikateve. UA përshkruan obligimet e prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit të kimikateve të rrezikshme sa i përket klasifikimit, etiketimit dhe paketimit të kimikateve të rrezikshme.

Sa i përket klasifikimi UA jep: përcaktimin e vetive, mënyrës së testimeve, përqendrimeve, rreziqeve, përmbajtjen e listës së klasifikimit dhe etiketimit të harmonizuar të substancave të rrezikshme. Sa i përket etiketimit UA jep sqarime në lidhje me paraqitjen e rrezikut, listën e sigurisë teknike, përmbajtjen e etiketës, dimensionet, formati dhe informacioni, piktogramet e rrezikut, fjalët paralajmëruese, etj.

### **2.5 UA 2017/18 për listën teknike të sigurisë për kimikate dhe mënyrën e plotësimit të saj**

Ky UA komplementon UA 2014/17 për klasifikim, etiketim dhe paketim të kimikateve të rrezikshme për pjesën e listës teknike të sigurisë LTS. Personi i cili prodhon, importon apo i lëshon në treg kimikatet të klasifikuara si të rrezikshme sipas UA 2014/17 dhe Ligjit të Kimikateve duhet që të siguroj për këto kimikate LTS dhe e njëjta paraqet dokumentin bazë

për lëshimin e lejes për qarkullimin, trajtimin dhe përdorimin e kimikateve dhe mbajtjen e regjistrimit të kimikateve.

LTS duhet të sigurohet nga prodhuesi i kimikatit dhe duhet të shpërndahet falas për shpërndarësit dhe përdoruesit të kimikatit. LTS duhet të përmbajë informacionin e detajuar sa vijon: identifikimi i substancës, identifikimi i rrezikshmërisë, përbërja, vetitë fiziko-kimike; informatën mbi reaktivitetin, informatat toksikologjike dhe ekotoksikologjike, informatat mbi transportin, magazinimin e mbeturinave, etj. Shtojca 1 jep detajet për plotësimin nga prodhuesit të LTS.

## **2.6 UA 2016/18 për qarkullimin e kimikateve të rrezikshme, kushtet e magazinimit dhe procedurat për marrjen e lejes dhe licencës**

Ky UA komplementon ligjin për kimikate sa i përket aspekteve të qarkullimit dhe magazinimit të kimikateve të rrezikshme si dhe licencimit të personave juridik që merren me prodhimin, importin dhe shpërndarjen e kimikateve të rrezikshme. Prodhuesi sipas UA duhet të ketë në posedim objektet e përshtatshe për lëndë të para, laboratorin, pajisjet për prodhim, infrastrukturën për magazinim, pajisje për mbrojtje në punë, shenjëzimet, etj. Prodhimi, importi dhe vendosja në treg të kimikateve të rrezikshme bëhet vetëm nga operatorët e pajisur me leje nga ministria. UA përshkruan procedurat për leje të importit dhe eksportit të kimikateve të rrezikshme. UA përmban si shtojca formularët për parashtrimin e kërkesave për pajisje me licencë dhe leje për kimikatet e rrezikshme.

## **2.7 UA 2015/09 për leje për vendosje në treg, regjistrimi dhe leje importi të produkteve biocide**

Ky UA komplementon për aspektet e lartëpërmendura të ligjit për produkte biocide 03/L-119. Prodhuesit, importuesit, shpërndarësit dhe personat tjerë që fusin në treg produkte biocide mundë ta ushtrojnë këtë aktivitet vetëm nëse pajisen me licencë respektivisht leje valide. UA përshkruan procedurat të cilat duhet ti ndjekin aplikuesit potencial si dhe të procesit të licencimit. UA përmban si shtojca formularët për parashtrimin e kërkesave për pajisje me licencë dhe leje për produktet biocide.

## **2.8 Direktiva 1907/2006/EC mbi regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (REACH)**

Rregullorja REACH është legjislacioni bazë i BE i cili rregullon sferën e kimikateve të prodhuara dhe të vëna në qarkullim me qëllim primar mbrojtjen e shëndetit të njeriut, botës shtazore dhe mjedisit ujor dhe jo ujor. Prodhuesit dhe importuesit e kimikateve u kërkohet të mbledhin informacion mbi vetitë e substancave të tyre kimike, të cilat do të lejojnë menaxhimin dhe përdorimin e tyre të sigurt, dhe të regjistrojnë informacionin në një bazë të dhënash qendrore në Agjencinë Evropiane të Kimikateve (ECHA) në Helsinki. ECHA ka caktuar tre afate kryesore për regjistrimin e kimikateve subjekt i tonazhit të prodhuar ose importuar, me 1000 ton / vit deri më 1 dhjetor 2010, 100 ton / vit deri më 1 qershor 2013 dhe 1 ton / vit brenda 1 qershor 2018. Rreth 143,000 substanca kimike të tregtuara në Bashkimin Evropian ishin para-regjistruar brenda afatit 1 dhjetor 2008.

Rregullorja gjithashtu kërkon zëvendësimin progresiv të kimikateve më të rrezikshme (të ashtuquajtura me shqetësim më të lartë) me kimikate më të sigurta. Nga 1 qershor 2011, ECHA duhet të njoftohet për praninë e këtyre substancave në artikuj nëse sasia e përgjithshme e përdorur është më shumë se një ton në vit dhe është e pranishme në më shumë se 0.1% të masës së objektit. Disa përdorime të këtyre substancave mund të jenë subjekt i autorizimit paraprak nga ECHA, duke përfshirë plane për të zëvendësuar përdorimin e tyre me një alternative më të sigurtë.

## **2.9 Direktiva 1272/2008/EC mbi Klasifikimin, Etiketimin dhe Paketimin e Substancave dhe Përzierjeve**

Direktiva Nr. 1272/2008 për Klasifikimin, Etiketimin dhe Paketimin e Substancave dhe Përzierjeve, e njohur zakonisht si Rregullorja CLP, harmonizon legjislacionin ekzistues të BE-së me Sistemin e Harmonizuar Globalisht të Kombeve të Bashkuara për Klasifikimin dhe Etiketimin e Kimikateve (GHS). Rregullorja CLP gjithashtu kërkon që furnizuesit e një substance të rrezikshme të njoftojnë ECHA për klasifikimin dhe etiketimin e saj brenda një muaji nga hedhja e substancës në treg për herë të parë. Kjo shpesh quhet njoftim C&L. Klasifikimi i një substance ose përzierje pasqyron llojin dhe ashpërsinë e rreziqeve të sajë. Furnizuesit duhet të vendosin për klasën e rrezikut dhe kategorinë e rrezikut të një substance ose përzierje duke mbledhur të dhëna në dispozicion dhe duke iu referuar kritereve të klasifikimit kimik të dhënë në rregulloren CLP.

Shtojca VI e rregullores CLP përfshin klasifikimin dhe etiketimin e harmonizuar për mijëra substanca të rrezikshme. Është obligative për furnizuesit e substancave ose përzierjeve përkatëse që të aplikojnë klasifikimin dhe etiketimin e harmonizuar. Rregullorja CLP kërkon që informacionin e një substance, duhet t'i njoftohet ECHA brenda një muaji pasi vendosjes në tregun e BE-së për herë të parë. Informacioni mbi klasifikimin dhe etiketimin duhet të përfshihen në Listën teknike të Sigurisë. Shtojca II e REACH ka përcaktuar kërkesa të hollësishme për formatin dhe përmbajtjen e LTS. Çdo LTS e re duhet të jetë në harmoni me kërkesat e Rregulloren REACH 2015/830.

## **2.10 Direktiva 850/2004 mbi ndotësit organikë të vazhdueshëm POP**

Kjo rregullore synon të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga ndotësit organikë të vazhdueshëm, duke ndaluar dhe kufizuar prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e këtyre substancave në përputhje me konventën e Stokholmit dhe Protokollin e Konventës rajonale të UNECE për ndotjen ndërkufitare të ajrit me distanca të gjata nga ndotësit organikë të qëndrueshëm. Ky grup ndotësish përbëhet nga pesticide (si DDT), kimikate industriale (siç janë bifenilet e poliklorinuara PCB) dhe nënprodukte të proceseve industriale (si dioksina dhe furanet). Shtetet Anëtare duhet të krijojnë inventarë të emetimeve për NOV të prodhuara pa dashje, planet kombëtare të zbatimit dhe mekanizmat e monitorimit dhe shkëmbimit të informacionit.

## **2.11 Direktiva 528/2012/EC për vurjen në dispozicion në treg dhe përdorimin e produkteve biocide**

Kjo direktivë themelon listës e substancave aktive që mundet të përdoret në produktet biocide si dhe vurjen në treg dhe përdorimi e produkteve biocide. Kërkesa kryesore e direktivës është që të gjitha produktet biocide të kërkojnë një autorizim nga Agjensia e Kimikateve Evropiane (ECHA) përpara se ato të vendosen në tregun e BE-së, dhe substancat aktive të përfshira në atë produkt biocid duhet të aprovohen më parë.

## **2.12 Direktiva 2008/98/EC mbi mbeturinat**

Direktiva kornizë e mbeturinave 2008/98/EC është dokumenti bazë ligjorë për menaxhimin e mbeturinave në vendet e BE-së. Ajo vendos parime të përgjithshme për administrimin e mbeturinave siç janë Hierarkia e Mbeturinave, Parimet themelore Ndotësi Pagan, Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit, etj. Direktiva synon të zvogëlojë ndikimin mjedisor të mbeturinave dhe të inkurajojë efikasitetin e burimeve përmes ripërdorimit, riciklimit dhe rikuperimit. Ajo shpjegon kur mbeturinat pushojnë së qenuri mbeturina sipas kriterit fundi i statusit të mbeturinave dhe bëhen lëndë e parë si dhe bëhet dallimi midis mbeturinave dhe nën-produkteve.

Klasifikimi i mbeturinave si mbetje të rrezikshme duhet të jetë bazuar, ndër të tjera, në legjislacionin e Komunitetit mbi kimikatet, veçanërisht në lidhje me klasifikimin e përgatitjet si të rrezikshme, përfshirë kufirin e përqendrimit vlerat e përdorura për atë qëllim. Direktiva përcakton synime të tilla si mbledhja e veçantë e letrës, metaleve, plastikës dhe qelqit për

mbeturinat shtëpiake deri në vitin 2015. Përveç kësaj, të paktën 50% nga pesha e mbeturinave shtëpiake, të tilla si letra, metali, plastika dhe qelqi, do të riciklohen ose të përgatitur për ripërdorim deri në vitin 2020. WFD përcakton dispozita për mbeturinat e rrezikshme siç janë klasifikimi, etiketimi, paketimi, grumbullimi i veçantë, ndalimi i përzierjes. Shtojca III përmban parametrat e mbeturinave të cilat klasifikohen si të rrezikshme.

### **2.13 UA 2014/21 për menaxhimin e mbeturinave nga industria ekstraktive dhe minierave dhe Direktiva 2006/21/EC mbi menaxhimin e mbeturinave nga industritë ekstraktive**

UA 2014/21 për menaxhimin e mbeturinave nga industria ekstraktive dhe minierave në masë të konsiderueshme bazohet në direktivën 2006/21/EC mbi menaxhimin e mbeturinave nga industritë ekstraktive. Qëllimi i UA është që të minimizoj impaktin negativ në ujë, mjedis dhe shëndet të njeriut nga menaxhimi i mbeturinave të industrisë ekstraktive dhe minierave. UA rregullon aspektet si licencimi i operatorit, përgjegjësitë e operatorit të objektit të mbeturinave, mbyllja e objektit dhe mirëmbajtja pas mbylljes, incidentet mjedisore, garancioni financiar e provizione tjera të ngjashme.

### **2.14 UA 2014/27 për menaxhimin e mbeturinave nga ambalazhet dhe paketimet dhe Direktiva 94/62/EC për paketimin dhe mbeturinat e paketimit**

UA 2014/27 ka objektivi që të rregulloj aspektet e ambalazhimit dhe mbeturinave nga ambalazhimi në mënyrën që siguron mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit njerëzor. Shtetet anëtare sipas direktivës 94/62/EC duhen të marrin masa që të reduktojnë konsumin e ambalazhimit sidomos për qeset plastike dmth 90 qese për person deri më 31.12.2019 dhe 40 qese për person deri 31.12.2025. Më së largu deri më 31.12.2018 qeset duhen të jenë me pagesë në pikat e shitjes. Direktiva ka edhe caqe specifike për rikuperimin dhe riciklimin e mbeturinave nga ambalazhimi dmth 60% për qelq, letër dhe karton, 50% për metal, 22.5% për plastikë dhe 10% për dru.

Prodhuesi i ambalazhit duhet të mbaj shënime dhe të ofroj dëshmi në formë çertifikate mbi prezencën e metaleve të rënda si plumbi, kadmiumi, dhe kromi gjashtëvalent në ambalazh. Shitësit obligohen që të grumbullojnë në formë të ndarë të ambalazhit dhe ta dërgojnë deri te ricikluesi. Prodhuesi dhe ambalazhuesi i cili nxjerr në treg ambalazhin duhet të ngarkohet me taksë. Personat që merren me prodhimin, grumbullimin dhe trajtimin e ambalazhit duhen të licencohen dhe të njëjtit duhet të raportojnë ministrinë në bazë vjetore mbi ambalazhin dhe mbi menaxhimin e mbeturinave ambalazh.

### **2.15 UA 2014/25 për MPEE dhe kufizimin e përdorimit të substancave në MPEE, Direktiva 2012/19 / BE për MPEE dhe Direktiva 2011/65/BE për kufizimin e përdorimit të disa substancave në PEE**

Ky udhëzim dhe direktivat e BE-së vendosin masat për menaxhimin e PEE dhe mbeturinave të tyre me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe jetës së njeriut, të reduktimit të prodhimit të tyre, reduktimin e përbërjes hazarde si dhe të rritjes së shkallës së rikuperimit dhe riciklimit. Prodhuesi, importuesi dhe distributori i PEE duhet të sigurojnë që PEE e hedhura në treg janë në harmoni me legjislacionin në treg dhe përmbajnë substanca të rrezikshme nën kufijt e lejuar me rregullore si dhe që dizajni i PEE të jetë i tillë që të çmontohet lehtë dhe të ripërdoret dhe riciklohet në masën më të madhe. PEE të futura në treg duhen të përmbajnë shenjën CE dhe deklaratën e konformitetit për së paku për 10 vite.

Shtetet anëtare duhen të sigurojnë që në minimum MPEE të hidhen me mbeturinat tjera por që të grumbullohen nga qendrat e specializuara në mënyrë të ndarë pa pagesë prej zotëruesve dhe distributorëve. Rregullorja ndalon deponimin e MPEE para se të kaloj procesin e trajtimit. Direktivat kanë të përcaktuara caqet minimale të grumbullimit 45% deri në 2016 dhe 85% 2019 (65% për PEE jashtë BE-së). Caku i grumbullimit të ndarë për MPEE është 4 kg për kokë banori. Prodhuesit e PEE duhet të mbulojnë shpenzimet e grumbullimit, trajtimit, rikuperimit dhe depozitimit të sigurt të MPEE për shtëpiakët dhe sektorin komercial.

Prodhuesit munden të zgjedhin nëse i zbatojnë obligimet individualisht apo në formë të asociacionit me prodhuesit tjerë. Direktiva obligon që të behët regjistrimi i te gjithë prodhuesve apo përfaqësuesve të autorizuar të PEE. Prodhuesit e PEE duhet të raportojnë mbi llojin dhe sasin e prodhuar dhe futur në treg.

Operatorët e qendrës së grumbullimit të MPEE duhet të mbajnë evidencë për llojin dhe sasinë e MPEE të grumbulluara, mënyrën e trajtimit, etj.

#### **2.16 UA 2014/26 për menaxhimin e mbeturinave nga bateritë dhe akumulatorët dhe Direktiva 2006/66/EC për bateritë dhe akumulatorët dhe bateritë dhe akumulatorët mbeturinë**

UA rregullon aspektet e etiketimit, rigjenerimit dhe depozitimit dhe grumbullimit të ndarë, përmbajtjen e metaleve të rënda (plumb, kadmium, dhe merkur) dhe aspektet tjera relevante. Bateritë e vendosura në treg nuk guxojn të përmbajnë mbi 0.0005% merkur dhe 0.002% kadmium të peshës së tyre. Prodhuesi dhe importuesi duhen të mbajnë evidencë mbi bateritë dhe akumulatorët e prodhuar/importuar dhe të vënë në treg dhe udhëzuesin teknik të përdorimit dhe mirëmbajtjes.

Operatorët e licencuar mund të hapin qendra të grumbullimit të baterive dhe akumulatorëve mbeturinë duke mbajtur evidencë mbi sasinë dhe llojin e grumbulluar. Çdo person është i detyruar që bateritë dhe akumulatorët mbeturinë ti dorëzoj te prodhuesi, importuesi, operatori i licencuar apo shitësi pa pagesë. Pikat e grumbullimit të baterive dhe akumulatorëve duhet të pajisen me kontejnerë special dhe hapësirat të ajrosen. Pikat e grumbullimit duhen të jenë të shpërndara që të mbulojnë popullatën prej 1000 banorëve për një pikë grumbullimi.

#### **2.17 UA 2017/14 për menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë materje me ndotës organik të qëndrueshëm, Rregullorja 850/2004 për NOQ dhe Direktiva 96/59/EC për deponimin e bifenileve të poliklorinuara dhe terfenileve poliklorinuara (PCB / PCT)**

UA i lartpërmendur rregullon mënyrën dhe procedurat për mbeturinat me NOQ si dhe vlerat kufitare të mbeturinave që përmbajnë apo janë kontaminuar me NOQ. UA përfshin MPEE, vajrat mbeturinë, mbeturinat nga pesticidet, mbeturinat nga ndërtim demolimet dhe mbeturinat tjera. Lista e substancave me NOQ dhe vlerat kufitare është e dhënë në aneksin nr. 1 të UA.

Grumbullimi i mbeturinave që përmbajn NOQ bëhet në mënyrë të ndarë dhe me kontejnerë special si dhe prodhuesit dhe zotëruesit duhen ti dërgojnë deri te qendra e licencuar e magazinimit para se ti nënshtrohen trajtimit përfundimtar respektivisht shkatërrimit të tyre. Operacionet e mundëshme të rikuperimit apo të deponimit mund të përfshijnë operacionet: R1, R4, D5, D9 dhe D12. Personat që administrojn mbeturinat që përmbajnë apo janë të kontaminuara me NOQ duhen të jenë të licencuar. Shtojca1 përmban listën e materialeve që përmbajn NOQ me përqëndrimet kufitare ndërsa shtojca 2 përmban listën e mbeturinave me NOQ për të cilat mundet me u zbatu deponimi alternativ. Për shkak të magnitudës së këtij problemi të trashëguar vendet që ballafaqohen me stoqe të mëdha të këtyre mbeturinave mundë të aplikojnë për ndihmë tek fondet strukturore të BEs. Personat e licencuar që menaxhojnë mbeturinat me NOQ duhet të raportojnë ministrinë me mbeturinat të cilat i kanë në zotërim.

#### **2.18 UA 2012/19 për menaxhimin e automjeteve mbeturinë dhe komponentët e tyre Direktiva 2000/53/EC për automjetet mbeturinë**

Ky udhëzim aplikohet për automjetet e çregjistruara, automjetet e paregjistruara për 6 muaj dhe automjetet e vëna jashtë përdorimit nga aksidentimet. AM sipas UA duhet të grumbullohen në qendrat e grumbullimit dhe çmontimit të licencuara nga ministria me pëlqim për lokacion nga komuna dhe VNM.

Prodhuesit dhe importuesit e automjeteve duhen qe të përdorin në minimum komponenta që përmbajnë supstanca të rrezikshme dhe mundësisht që të bëjnë zëvendësimin e tyre me

substancia më pak të rrezikshme si dhe dizajni dhe materiali i përdorur të mundësoj sa më shumë riciklimin. Personave dhe operatorëve sipas UA u ndalohej të shesin pjesë që përmbajnë plumb, kadmium dhe krom gjashtëvalent ndryshe nga shtojca 1.

AM klasifikohen sipas katalogut shtetëror të mbeturinave. Operatorët duhet të parashtrajnë raportin vjetor tek ministria mbi AM dhe automjetet që i kanë në zotërim. Shtojca 1 e UA përmban listën e materialeve të rrezikshme dhe përqëndrimet e lejuara. Shtojca 4 përmban instruksione mbi etiketimin e AM dhe komponentëve mbeturinë. UA nuk i përmban disa provizione të rëndësishme të direktivës 2000/53/EC sa i përket operacioneve të eliminimit të ndotjes të AM si heqja e akumulatorëve dhe rezervuarëve të derivateve, jastëkve të ajrit, derivateve, vajrave të motorrit dhe ndrruesit të shpejtësive, vajrave të frenave, lëngjeve ftohës, antifrizit, kondicionerëve të ajrit e kështu me radhë.

### **2.19 UA për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe vajrat mbeturinë**

Ky udhëzim rregullon vajrat mbeturinë të motorëve, këmbysve të shpejtësive, kompresorëve dhe turbinave, transformatorëve, për izolim termik, hidraulike, grasot, lecat e përdorura, filtrat e përdorur, dhe i kontaminuar, separatorët e vajit etj. Hierarkia e menaxhimit të vajrave i jep përparësi rigjenerimit, pastaj rikuperimit dhe në fund depozitimit dhe asgjësimit. Vajrat e përdorur dhe mbeturinat nga vajrat duhen të grumbullohen ndaras nga mbeturinat tjera dhe ndaras në mes llojeve të vajrave kurdoherë kjo e pengon rigjenerimin dhe trajtimin e tyre. Prodhuesi i vajrave mbeturinë duhet të siguroj enë dhe kanistra të veqantë për grumbullim e vajrave mbeturinë dhe ti etiketojë ato si dhe pajisje për ndarjen dhe absorbimin e vajrave. Nëse vajrat përmbajnë PCB dhe PCT mbi 50 mg/kg atëherë enët duhen të jenë prej materialeve antikorozeve si aluminit apo çelikut të zinkuar. Personat që menaxhojnë vajrat e përdorura duhet të licencohen nga ministria. Personat që tregtojnë vajrat e përdorura duhet të bëjnë analizat tek laboratorët e akredituar me theks të veqantë prezencën e ndotësve të qëndrueshem organik si PCB dhe PCT. Punëtorit të cilat servisojnë/riparojnë automjetet dhe pajisjet tjera gjatë ndërrimit dhe largimit të vajrave duhen të kenë separatorin e vajrave, dhe enë apo kanistra për grumbullimin e ndarë të vajrave dhe lëngjeve sipas llojit.

Trajtimi dhe rigjenerimi i vajrave bëhet vetë nga personat e licencuar. Rigjenerimi bëhet vetëm nëse vajrat nuk përmbajnë mbi 50 mg/kg PCB dhe PCT dhe 30 mg/kg të halogjenurëve ndërsa për rikuperim të energjisë kur përmbajtja e ujit është maksimum 15%, e PCB dhe PCT 10 mg/kg dhe vlera minimale kalorike 30 MJ/kg. Për djegie në incinerator kufiri është 50 mg PCB dhe PCT. Asgjësimi i vajrave me përmbajtje të kontaminuar bëhet vetëm kur mundet të kontrollohet emisioni i gazrave helmuese nën kufijtë e lejuar konform ligjit të ajrit.

Direktiva 75/439 EEC mbi vajrat mbeturinë është shfuqizuar më 12 dhjetor 2010 ndërsa fusha e rregullimit të vajrave mbeturinë rregullohet me direktivën kornizë të mbeturinave 2008/98/EC respektivisht me nenin 21 paragrafet a, b dhe c.

### **2.20 UA 2015/07 për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtim dhe demolimi i objekteve ndërtimore**

Mbeturinat nga ND janë kompetencë e komunave përmes nxjerrjes së akteve nënligjore. Mbledhja dhe transportimi i MN bëhet nga operatori i licencuar si dhe prodhuesi apo zotëruesi i MN. Komunitat brenda territorit të tyre caktojnë qendrat për grumbullimin, trajtimin dhe deponimin e MN. Komunitat me numër të banorëve më të madh se 60000 duhet të pajisen me pëlqimin mjedisor sipas ligjit 03/L-214 për VNM ndërsa komunitat më të vogla zbatojnë kërkesat e UA. Klasifikimi dhe kategorizimi i mbeturinave bëhet sipas UA 2013/13 Katalogut shtetëror të mbeturinave. MN në përbërjen e të cilave ka materje apo komponentë të rrezikshme sipas shtojcës 3 të listës H me përqëndrime më të larta konsiderohen mmbeturina të rrezikshme.

### **3 Dokumentet dhe raportet relevante**

#### **3.1 Strategjia për mbrojtjen e mjedisit 2013 – 2022**

Për sa i përket kimikateve kjo strategji i adreson ato në formë marginale pa dhënë një përshkrim të gjendjes problemeve, kornizës së veprimeve dhe buxheteve. Ndërmjet objektivave të strategjisë janë krijuar një organi kompetent për administrimin e kimikateve; si dhe monitorimi dhe vënia në funksion e kontrollit të prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit të kimikateve të rrezikshme; dhe në realizimin e tyre nuk ka pasur ndonjë progres të ndjeshëm.

Sa i përket mbeturinave të rrezikshme si objektiv është vendosur përcaktimi i saktë dhe inventarizimi i mbeturinave të rrezikshme. Objektiv tjetër e përcaktuar e strategjisë është edhe rritja e taksave për hedhjen e mbeturinave industriale dhe të rrezikshme; Ekziston edhe një objektiv e cila kërkon ndërtimin e objekteve lokale dhe instalimeve për trajtimin e mbeturinave, duke përfshirë edhe djegien e lëndëve të mbeturinave të rrezikshme;

#### **3.2 Strategjia e mbeturinave 2013 -2022**

Ministria ka nxjerrë strategjinë e mbeturinave 2013-2022 dhe është në proces të rifreskimit të saj. Strategjia i kushton rol të rëndësishëm mbeturinave të rrezikshme porse qasja në adresimin e problemit si dhe caktimi i objektivave, masave dhe hapave nuk është konsistent dhe jo qdo herë në harmoni me legjislacionin dhe praktikën e mira të menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme.

Ndër masat e strategjisë së mbeturinave të rrezikshme, janë Përcaktimi i saktë dhe inventarizimi i mbeturinave të rrezikshme dhe Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme të trashëguara, që janë në kompetencë të Qeverisë. Strategjia sugjeron se nuk ka informata të plota mbi mbeturinat e rrezikshme duke identifikuar nevojën e hartimit të një regjistri të konsoliduar.

Strategjia parashtron si masë ndërtimin e një qendre të magacinimit të mbeturinave të rrezikshme si dhe trajtimin ose asgjësimin e mbeturinave nga substancat kimike të rrezikshme.

#### **3.3 Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë, 2017**

Raporti në fjalë i cili është publikuar nga AMMK adreson gjendjen e përbërësve të mjedisit si Ajri, Uji, Toka, Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura, Mbeturinave dhe ndikimet e tyre në Shëndetin publik. Raporti në fjalë i adreson në formë marginale kimikatet dhe mbeturinat e rrezikshme.

#### **3.4 Raport mbi mbeturinat e rrezikshme industriale në Kosovë 2019**

Ky raport është publikuar nga AMMK në vitin 2019 dhe adreson qështjen e mbeturinave të rrezikshme industriale në Kosovë sidomos mbeturinat e trashëguara nga industrinë që kanë operuar në vitet 80-90 dhe më parë.

Raport në formë mjaft të mirë përshkruan gjendjen në magacinimet e përkohëshme të mbeturinave të rrezikshme industriale si TC Kosova A (KEK), TC Kosova B, Flotacioni-Tuneli i parë dhe Parku Industrial Trepça- Mitrovicë, Flotacionet në Zveçan, Leposaviq dhe në Kishnicë, Fabrika për prodhimin e metalit "GC METAL"- Janjevë, Fabrika e tekstilit "SHARRTEX" – Dragash, Ish Kombinati i Lëkurës – Pejë, ish Fabrika e Baterive Industriale Trepça Pejë, Ish Kosova Steel Pejë, Metaliku- Gjakovë, ish fabrika e prodhimit të tekstilit Emin Duraku.

Raporti në mënyrën se si është konceptualizuar nuk i ka përfshirë të gjitha kategoritë e mbeturinave të rrezikshme sipas katalogut shtetëror të mbeturinave me theks të veçantë mbeturinat nga agrikultura, sistemit shëndetësor, ndërtim demolimi, automobilat e përdorur dhe autopjesët, vajërat e përdorura e të ngjashme.

## 4 Kadastri i mbeturinave të rrezikshme

Kadastri i mbeturinave të rrezikshme i prezentura në vijim, është formuluar në linjë me katalogun shtetëror të mbeturinave dhe listën e mbeturinave të BE-së. Të dhënat mbi mbeturinat e rrezikshme janë përgatitur dhe prezantuar duke u bazuar në informatat e ofruara nga operatorët ekonomik dhe institucionet, raportet e MEA, të dhënat të importeve nga Doganat e Kosovës (DK) për vitin 2019 si dhe vlerësimeve dhe kalkulimeve të gjenerimit të MRr bazuar në parametrat relevant.

### 4.1 Mbeturinat nga eksplorimi, ekstraktimi dhe trajtimi fiziko - kimik të gurorëve dhe mineraleve

Minierat paraqesin një element të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës ndërsa në të njëjtën kohë janë një nga ndotësit më të mëdhenj mjedisor të sajë. Eksploatimi i minierave kryesisht atyre sulfide të pasura me plumb, zink dhe metale tjera të rënda dhe teknologjive jo të avancuara të koncentrimit të xeheve ka rezultuar në një prodhim masiv të mbeturinave me prezencë dhe koncentrim të lartë të metaleve të rënda. Këto mbeturina janë depozituar gjerësisht në Kosovë në lokacione të papërshtatshme sa i përket lokacionit, karakteristikave gjeomekanike, topografike dhe hidrogjeologjike dhe shpesh në zonat që kanë potencial bujqësor, furnizimit me ujë, zonave urbane, rrjedhjeve të ujit, etj. Poashtu këtyre deponive iu kanë munguar elementet kritike të deponive për të kontrolluar rrjedhjet e ujit nga trupi i pendes, vërshimet, erozionin e brigjeve dhe bartjes së grimcave nga erëra duke krijuar bartje të mbeturinave të deponisë tek vendbanimet dhe tokat bujqësore.

Shumica dërmuese e mbeturinave nga eksplorimi, ekstraktimi dhe trajtimi fiziko - kimik të gurorëve dhe mineraleve në Kosovë referuar përbërjes së tyre dhe koncentrimet së substancave të rrezikshme klasifikohen sipas katalogut të mbeturinave si mbeturina të rrezikshme. Sasia e mbeturinave të rrezikshme nga koncentrimi i xeheve minierare në total është rreth 60 milion ton e deponuar në tetë deponi Kelmend Mitrovicë; Gornje Polje Zveçan; Zhitkoc Zveçan; Bostanishte Laposaviq; Gornji Kërnjin Laposaviq; Staro Jalovishte Kizhnicë; Badovc; dhe Mareci 1&2 Artanë. Për vitin 2019 sasia e mbeturinave të rrezikshme është rreth 110 mijë ton apo 57.1 % e total mbeturinave të rrezikshme nga të gjitha kategoritë. Të dhënat në fjalë i referohen mbeturinave minerare nga StanTërgu të deponuara në deponinë e Kelmendit dhe ato të Artanës të deponuara në deponinë e Badovcit. Mbeturinat e deponuara në Bostanishte nga minierat e Cërnacit nuk janë të përfshira në mungesë të të dhënave.

Mbeturinat nga eksplorimi, ekstraktimi dhe trajtimi fiziko - kimik të gurorëve dhe mineraleve përfaqson kategorinë e parë në katalogun shtetëror të mbeturinave me hyrjen 01 dhe e cila përmban katër nënkategori sa vijon:

1. Mbeturinat nga nxjerrja e mineraleve (01 01)
2. Mbeturinat nga procesimet fizike dhe kimike të mineraleve metalore (01 03)
3. Mbeturinat nga procesimet fizike dhe kimike të mineraleve jometallore (01 04)
4. Balta nga shpimet dhe mbeturinat tjera nga shpimet (01 05)

Në tabelën në vijim janë dhënë nënkategoritë e mbeturinave të rrezikshme të shoqëruara me kodin dhe llojin e hyrjes në terme të rrezikshmërisë. Mbeturinat sipas rrezikshmërisë së tyre ndahen në mbeturina absolutisht të rrezikshme (ARr), mbeturinat pasqyruese të rrezikshme (PRr) dhe pasqyruese të parrezikshme (PP) ku rrezikshmëria e tyre është subjekt i kufirit të rrezikshme dhe mbeturinat absolutikisht të parrezikshme (AP)<sup>1</sup>. Kategoritë me hyrje absolutikisht të rrezikshme dhe pasqyruese të rrezikshme janë hyrje me shenjë asteriks.

Kategoria e parë sa i përket mbeturinave të rrezikshme përmban tre kategori katër shifrore me gjashtë nënkategori gjashtëshifrore të rrezikshme të paraqitur në tabelën e mëposhtme:.

---

<sup>1</sup> Absolute hazardous (AH); Absolute non-hazardous (AN); Mirror hazardous (MH); Mirror non-hazardous (MNH).

**Tabela Nr. 3: Kategorizimi i mbeturinave të rrezikshme që dalin nga eksplorimi, miniera, gurore, si edhe nga trajtimet fiziko - kimike të mineraleve**

Kodi	Emërtimi i kategorisë	Lloji i hyrjes
01 03	Mbeturinat nga procesimet e mëtutjeshme fizike dhe kimike të mineraleve metalore	
01 03 04*	Mbeturinat acidike nga përpunimi i xeherorëve me përmbajtje të sqfurit	PRr
01 03 05*	Mbeturina tjera që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
01 03 07*	Mbeturina të tjera që përmbajnë substanca të rrezikshme nga përpunimet fiziko-kimike të mineraleve metalore	PRr
01 04	Mbeturina që dalin nga përpunimet fiziko-kimike të mineraleve jometalore	
01 04 07*	Mbeturina që përmbajnë substanca të rrezikshme nga përpunimet fiziko- kimike të mineraleve jo-metalike	PRr
01 05	Balta nga shpimet dhe mbeturinat tjera nga shpimet	
01 05 05*	Balta dhe mbeturinat tjera nga shpimet për naftë- hidrokarbure	PRr
01 05 06*	Balta dhe mbeturinat tjera nga shpimet që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr

#### 4.1.1 Vendburimet me minerale metalore në Kosovë

Vendburimet me minerale metalore në Kosovë përfshijnë minierat e plumbit dhe zinkut me shtrirje në pjesën verilindore të Kosovës, minierat me nikël dhe kobalt në pjesën qendrore të Kosovës, dhe minierat me krom në jug të Kosovës.

##### 4.1.1.1 Minierat metalore me përmbajtje plumbi dhe zinku

Vendburimet më të rëndësishme minerale me përmbajtje të plumbit dhe zinkut gjenden në brezin i cili shtrihet në pjesën verilindore të vendit, duke filluar nga Leposaviqi gjerë në Gllamë (Gjilan) me gjatësi mbi 80 km dhe gjerësia mesatare 30 km.

Në Republikën e Kosovës dallojmë një numër të caktuar të minierave të zhvilluara (minierat kyçe), si dhe një numër i vendburimeve më parë të vlerësuara, por të pazhvilluara. Miniera të zhvilluara (kyçe) janë: miniera “Trepça” në Stantërg, Hajvalia, Badofci, Kizhnica, Artana, Bellobërda dhe Cërnaci.

Paraqitjet dhe vendburimet më të rëndësishme (më parë të hulumtuara dhe të vlerësuara) janë: Melenica, Zjaqa, Magjera, Gjidoma, Tërstena, Rashani, Vidishiçi, Mazhiçi dhe Gumnishta në zonën e Stantërgut, Quka e Batllavës në juglindje të Podujevës; Kaltërina e Përroi i Ngjyrosur në zonën e Artanës, si dhe Kallugjerica dhe Gomile, në pjesën veriore të Kosovës. Për vendburimin e zinkut dhe plumbit në Cërpulë, në jugperëndim të Mitrovicës nevojiten hulumtime intensive, pasi hulumtimet e mëparshme kanë dhënë rezultate të favorshme.

- *Stantërgu*

Ndërtimi gjeologjik i zonës metalogjenike të Stantërgut me rrethinë është kompleks, me prezencën e trupave masivë të xeheve sulfite me rëndësi ekonomike, ku raporti Pb / Zn është rreth 1.4 : 1.0.

Shfrytëzimi i xeheve nga kjo minierë daton nga viti 1930 deri në ditën e sotme në miniera të ndryshme dhe intenzitete të ndryshme. Prodhimi i xeheve nga miniera Trepça në Stantërg është realizuar në kontinuitet, me një shkëputje në vitin 1991, kur miniera praktikisht mbyllet, pas largimit të punëtorëve shqiptarë me dhunë nga puna.

Miniera me infrastrukturën e vetë si dhe me metodat bashkëkohore të mbushjes, ka kapacitetin e shfrytëzimit të xeheve prej 500.000 deri në 650.000 ton xehe në vit me kusht të operimeve dhe investimeve optimale.

Tabela Nr. 4: Rezervat minerare sipas lokacioneve në regjionin e Stantërgut dhe kompozicioni i tyre <sup>2</sup>								
	Miniera	Sasia e xehes Mt	Koncentrimi i xehes			Sasia e xehes		
			Pb (%)	Zn (%)	Ag (gr/t)	Pb ('000t)	Zn ('000t)	Ag (t)
1	Stantërg	20.7	4.02	4.02	76.0	834	674	1,577
2	Melenica	2.6	5.80	5.80	85.0	148	107	217
3	Maçjera	0.6	3.80	3.80	72.0	22.8	18.0	43
4	Mazhiq – Maja e madhe	1.5	3.30	3.30	60.0	49.5	42.0	90.0
5	Gjidomë Mazhiq	2.0	3.30	3.30	60.0	66.0	56.0	120.0
6	Rashan - Tërstenë	2.5	3.30	3.30	60.0	82.5	70.0	150.0
7	Zjaqë	5	2.83	2.83	16.0	146.4	112.8	82.8
	<b>Total</b>	<b>35.0</b>	<b>3.85</b>	<b>3.85</b>	<b>65.0</b>	<b>1,350</b>	<b>1,080</b>	<b>2,280</b>

Miniera e Stantërgut me vendburimet që e rrethojnë, ka rezerva prej rreth 75 Mt, ose shprehur përmes sasisë të metaleve në xehe, 1,349,579 ton plumb, 1,080,504 ton zink dhe 2,280,224 kg argjend, dhe aktualisht paraqet një nga potencialet më të rëndësishme të xeheve sulfite të Pb dhe Zn në regjion.

- *Kompleksi i minierave (Artanë, Hajvali, Badovc, Kizhnicë)*

Kompleksi i minierave Artanë, Hajvali, Badovc, Kizhnicë, shtrihet në pjesën lindore të vendit në një sipërfaqe rreth 400 km<sup>2</sup> në territoret e disa komunave: Graçanicë (minierat Hajvalia, Badovci, Kizhnica dhe flotacioni në Kizhnicë), Artanës, (miniera Artana dhe fushat mineral mbajtëse Përroi i Thartë dhe Kaltrina) dhe Podujevës (miniera në hapje “Çuka e Batllavës”). Këto vendburime të mineraleve sulfite kanë përbërje të Plumbit (Pb) - 4.67 %, Zinkut (Zn) 6.52 % dhe metaleve të çmueshme të arit (Au) dhe argjendit (Ag) 89.91 g/t. Shprehur përmes sasisë së metaleve në xehe, në këto vendburime janë 749,354 t plumb, 1,045,444 t zink dhe 1,441,879 kg argjend.

- *Kompleksi i minierave Bello Bërdë / Cërnac*

Minierat Cërnac dhe Belobërdë shtrihen në pjesën veriore të Kosovës, kurse flotacioni i përbashkët i këtyre minierave është i vendosur në Leposaviq. Në total, kompleksi i minierave Bellobërdë / Cërnac që shtrihen në rrethinën e komunës Albanik (Leposaviq), kanë totalin e rezerva ve të xeheve prej 7.55 Mt, me përbërje mesatare të metaleve në xehe Pb - 6.85 %, Zn - 5.07 % dhe Ag – 96.13 g/t, ose shprehur përmes sasisë së metaleve në xehe, në këto vendburime janë 516,645 t plumb, 382,373 t zink dhe 725,256 kg argjend.

- *Rezervat minerare të minierave të Pb, Zn dhe Ag*

Bazuar në të dhënat e fundit, me qëllim që të pasqyrohet potenciali real gjeologjik i Trepçës, është bërë mbledhja fizike e të dhënave nga lokacionet të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr. 5: Potenciali mineral i xeheve sulfide në Kosovë <sup>3</sup>							
	Xehe (Mt)	Pb (%)	Zn (%)	Ag (g/t)	Pb (Mt)	Zn (Mt)	Ag (t)
Stantërgu	35.0	3.85	3.85	65.0	1.3	1.1	2.3
Cërnac	7.5	6.85	5.07	96.13	0.5	0.4	0.7
Artanë	16.0	4.67	6.52	89.91	0.7	1.0	1.4
Total:	58.6	4.46	4.28	75.81	2.6	2.5	4.4

Miniera e Stantërgut merr pjesë në sasinë e tërësishme të metaleve (Pb+Zn), merr pjesë me 47.43%. Kompleksi i minierave të Artanës, Hajvalisë dhe Kishnicës, merr pjesë 27,34% në rezervat totale, kurse me sasinë e metaleve (Pb+Zn) merr pjesë me 35.02%. Minierat e zonës së Leposaviqit, marrin pjesë me 12.86% në rezervat totale të Trepçës, kurse në sasinë e tërësishme të metaleve pjesëmarrja arrin në 17.54%.

<sup>2</sup> Strategjia minerare e Republikës së Kosovës 2012 – 2025 fq. 22

<sup>3</sup> Strategjia minerare e Republikës së Kosovës 2012 – 2025 fq. 23

Xehet e Trepçës përbëjnë edhe metale tjera si ari (Au), Bi (bizmuth), Cd (kadmium), Se (selen), Te (telur), In (indium), Ge (germanium), etj. Vleresohet që përmbajtja mesatare e ari në xehe është 0.8 gr/t qka i shton vlerën ekonomike këtij resursi mineral.

Në të kaluarën. N ga viti 1930 gjerë 1980, janë prodhuar këto sasi të xeheve, koncentrateve dhe metaleve në Kosovë: xehe Pb-Zn: 45.87 Mt, me 2.98 Mt Pb-koncentrat dhe 2.882 Mt Zn-koncentrat, Ag-2,461 t, Bi-1,860 t, Cd-827 t, Ari-10,771 kg. Nga viti 1979 deri më 1998, janë përpunuar 21.3 Mt xehe, me përmbajtje rreth 3.1 % Pb dhe 2.2 % Zn; janë prodhuar 649,000 t Pb dhe 442,500 t Zn. Për më shumë, janë nxjerrë 1,200 t Ag dhe 2,600 kg ari. Për një periudhë 70 vjeçare, vetëm Stantërgu ka prodhuar mbi 36 Mt xehe, mbi 2.1 Mt Pb, 1.4 Mt Zn dhe 3.6 t Ag.

#### 4.1.2 Rezervat minerare të Nikelit (Ni) dhe Kobaltit (Co)

Hulumtimet e mineraleve silikatë të nikelit në territorin e Kosovës datojnë që nga viti 1958, ku janë përcaktuar shfaqjet e para mineralizuese të nikelit në territorin e Gllavicës, afër minierës së magnezitit në Magurë. Në kuadër të Ferronikelit funksionojnë dy miniera me shfrytëzim sipërfaqësor: Gllavica dhe Çikatova (Dushkaja dhe Suka)

Miniera e nikelit silikat "Gllavica" gjendet në distancë prej rreth 20 km në jugperëndim të Prishtinës. Vendburimi i nikelit Gllavica shtrihet në masivin peridotit të Goleshit në bregun lindorë të kodrës Gllavicë. Drejtimi i shtrirjes së vendburimit përafërsisht është Veri-Jug në gjatësi prej 1,050 m. Miniera e nikelit silikat "Çikatova e Vjetër" gjendet në regjionin e masivit peridotit të Dritanit (Dobroshevcit) komuna e Gllgovcit. Në minierën e nikelit „Çikatovë e Vjetër“ ekzistojnë dy vendburime (trupa mineral): „Dushkaja“ dhe „Suka“. Rezervat gjeologjike në dy minierat (Gllavicë dhe Çikatovë) janë vlerësuar të jenë rreth 13 Mt me përbërje mesatare të nikelit 1.31% dhe të kobaltit 0.06%.

Shfrytëzimi i xehes së nikelit ka filluar në vitin 1982, ndërsa shkëmborja ka filluar punën nga viti 1984. Mes viteve 1982 - 1999, janë shfrytëzuar rreth 7 Mt xehe me 1.21 % Ni, dhe janë prodhuar gjithsej 36,728 ton nikel metal. Puna në minierat sipërfaqësore u ndërpre në vitin 1999 për shkak të luftës. Ferronikeli është privatizuar me vendim të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, me metodën e "Spin-off"-it special. Pas privatizimit nga kompania NeĒCo Ferronikeli Complex L.L.C.- (prill, 2006), shfrytëzimi ka rifilluar në të dy minierat, gjatë vitit 2007.

Procesi teknologjik është sa vijoon: Oksidi laterik i përmbajtur në xehe thërmohet fillimisht dhe pastaj homogjenizohet dhe përzihet me linjitin për ta përgatitur më tej atë për përpunim. Materialet e përzier më pas vendosen në furrat rotulluese, ku zhvillohen zvogëlimet dhe kalcinimet. Mineralet zhvendosen në furrat e reduktimit elektrik, ku hiqet afërsisht 50% e squfurit nga lëgura e hekurit / nikelit. Squfuri i mbetur hiqet nga metali i lëngshëm në konvertuesit e oksigjenit, dhe lëgura e hekurit / nikelit ngelet në granulat e feronikelit.

Gjatë procesit teknologjik krijohet edhe mbeturina minerare e cila deponohet në lokalitetin Sukë por e cila nuk ka përbërësit dhe kufijtë për tu konsideruar si mbeturinë e rrezikshme.

#### 4.1.3 Mbeturinat nga procesimi fiziko - kimik i mineraleve metalike

##### 4.1.3.1 Mbeturinat nga procesimi fiziko kimik i mineraleve sulfide

Në këtë grup hyjnë mbeturinat e procesit të flotacionit të xeheve në minierat e Stantërgut, Belo Bërdo-Cërnac, Artanës, dhe Kizhnicës. Sasia totale kumulative e mbeturinave minerale sulfide të deponuara është rreth 60.4 Mt të paraqitura në tabelën më poshtë:

**Tabela Nr. 6: Sasia e mbeturinave minerare nga koncentrimi i xehes sulfide<sup>4</sup>**

	Emri dhe lokacioni i deponisë	Statuti i deponisë	Sasia e mbetjeve (Mt) në fillim të 2019	Sasia e mbeturinave gjatë 2019	Sasia e mbetjeve (Mt) në fund të 2019	Pjesëmarrja %
1	Kelmend Mitrovicë	Aktiv	9.0 Mt	0.074 Mt	9.1 Mt	15.0 %
2	Gornje Polje Zvecan	Pasiv	12.0 Mt	-	12.0 Mt	19.8 %
3	Zhitkovc Zvecan	Pasiv	12.0 Mt	-	12.0 Mt	19.8 %
4	Bostanishte Leposavic	Aktiv	3.6 Mt	0.032 Mt	3.7 Mt	6.1 %
5	Gornji Kërnjin Leposavic	Pasiv	2.6 Mt	-	2.6 Mt	4.3 %
6	Staro Jalovishte Graçanic	Pasiv	11 Mt	-	11 Mt	18.2%
7	Badovc Badovc	Pasiv	8.0 Mt	-	7.7 Mt	12.7 %
8	Mareci 1&2 Novobërdë	Pasiv	1.0 Mt	-	2.4 Mt	4.0%
	<b>Total</b>		<b>60.4 Mt</b>	<b>0.11 Mt</b>	<b>60.5 Mt</b>	<b>100%</b>

#### 4.1.3.1.1 Deponia e Kelmendit

Deponia e skorjes në Kelmend ndodhet 2 km në verilindje të qytetit të Mitrovicës e ndërtuar të pranohet mbeturinat minerare nga fabrika e flotacionit Tuneli i parë që nga viti 1975 dhe ende është aktive. Procesi i flotacionit përfshin trajtimin e xehes minerale me substancat si sulfat zinku, sulfat bakri, kripëra, gëlqere dhe natrium-cianid për të ndarë zinkun dhe plumbin nga xehja. Një pjesë e mbetjeve në formë rëre kthehet prapë në galeri ndërsa pjesa tjetër përfundon në deponi. Pozicioni i deponisë shtrihet në luginë mes dy kodrinave në fund të së cilës është ndërtuar penda me lartësi 85 m. Kapaciteti maksimal i deponisë është 8 Mt dhe aktualisht shfrytëzimi i sajë është rreth 50%. Mbeturinat nga flotacioni në deponi transportohen përmes tunelit hidraulik.

Sipas analizave të bëra nga vetë Trepça mbeturinat e sterilizimit në deponi përmbajnë metalet e rënda sa vijon:

**Tabela Nr. 7: Kompozicioni i mbeturinave të sterilizimit në deponinë e Kelmendit**

	Pjesëmarrja e metaleve në mbeturinë %	Sasia e mbeturinave në deponi (Mt)	Sasia e metaleve të përmbajtura në mbeturinë (t)
Pb	0.33%	9 Mt	13,200 t
Zn	0.26%		10,400 t
Bi	49 g/t		596 t
Cu	0.019 %		7,600 t

Prezenca e metaleve të rënda në deponi paraqet rrezik për kontaminimin e tokës dhe ujërave të nëntokës dhe ajrit sidomos për faktin se deponija nuk mirëmbahet si duhet duke siguruar drenimin e ujërave si dhe moskultivimin e sipërfaqes së deponis me vegjetacion.

Të dhënat mbi metalet të rënda sipas listës së klasifikuar të ECHA është dhënë në tabelën e mëposhtme dhe ku shihet se elementet e përbëra në mbeturina të deponisë në koncentrimet aktuale paraqet rrezik për shëndetin e njeriut dhe rrezik për mjedisin ujor dhe joujor

<sup>4</sup> Të dhënat e raportuara nga menaxhmenti i Trepçës për vitin 2019

**Tabela Nr. 8: Klasifikimi dhe etiketimi i mbeturinave të sterilizimit në deponinë e Kelmendit**

	EC List No.	CAS No.	Index No.	Hazard Class and Category Code(s)	Hazard Statement Code(s)	Pictograms, Signal Word Code(s)
Pb lead powder; [particle diameter < 1 mm]	231-100-4	7439-92-1	082-013-00-1	Lact.	H362	GHS08 Dgr
				Repr. 1A	H360FD	
				STOT RE 1	H372	
Zn zinc powder - zinc dust (pyrophoric)	231-175-3	7440-66-6	030-001-00-1	Aquatic Acute 1	H400	GHS02 GHS09 Dgr
				Aquatic Chronic 1	H410	
Bi Bismuth	231-177-4	7440-69-9		Aquatic Chronic 4	H413	GHS02 Wng
				Flam. Sol. 2	H228	
Cu Copper	231-159-6	7440-50-8		Acute Tox. 4	H302	GHS09 GHS06 Dgr
				Eye Irrit. 2	H319	
				Acute Tox. 3	H331	
				Aquatic Acute 1	H400	
				Aquatic Chronic 1	H410	

#### *4.1.3.1.2 Deponia e Zhitkocit*

Deponija e sterilit në Zhitkoc gjendet në anën e majtë të lumit Ibër në fshatin Zhitkoc në distancë rreth 1km nga vendbanimi Zveçan. Deponia ishte aktive në periudhën 1963 – 1974 dhe ka shërbyer që të pranoj mbeturinat nga imipjanti i vjetër i flotacionit në Zveçan. Sipërfaqja e deponisë është afërsisht 26 ha, dhe vlerësohet se sasia e sterilit të deponuar është rreth 12 Mt.

#### *4.1.3.1.3 Deponia Gornje Pole*

Deponia e sterilit në Gornje Pole është vendosur në bregun e lumit Ibër ndërmjet Mitrovicës dhe Zvecanit. Në këtë deponi, mbeturinat e flotacionit nga flotacioni i vjetër në Zveçan janë depozituar që nga fillimi i operimit (1930) e deri në mbyllje të saj në 1983. Sipërfaqja e deponisë është afërsisht 50 ha, dhe rreth 12 Mt. Në veri të deponisë, sterilit nga nga skritorja e plumbit janë depozituar poashtu për një kohë të gjatë.

#### *4.1.3.1.4 Deponitë Bostanishte dhe Tvërgjanski Do*

Deponia e sterilit në Bostanishte dhe Tvërgjanski Do janë pjesë e të njëjtës deponi të sterilit në afërsi të qytezës Leposaviq në anën e djathtë të lumit Ibër. Deponia nismëtare e sterilit ka qenë Tvërgjanski Do dhe e njëjta është përdorur për të pranuar mbeturinat sterile nga procesi i koncentrimit të xehes nga minierat Belo Bërdo, Černac, Koporiq, Zhuta Përlina dhe Jelakce. Më vonë deponia është xzgjerruar edhe në lokalitetin Bostanishte. Sipërfaqja e deponisë është rreth 6.2 ha dhe në të janë deponuar rreth 6,6 Mt të sterilit minerar dmth 3.6 Mt të deponisë Bostanishte dhe 2.6 Mt të deponisë Tvërgjanski Do. Deponia Bostanishte është në gjendje të keqe për shkak të mungesës së mirëmbajtjes së sajë. Mungon mbulesa bimore, ndërsa brigjet e deponisë janë me pjerrësi të madhe dhe të zhveshura. Deponia nuk e ka sistemin e mbrojtjes nga ujërat sipërfaqësor dhe sistemin e drenazhimit. Për rrjedhojë sterili me përmbajtje të metaleve të rënda gjatë periudhës me erëra bënë barjen e pluhurit duke rrezikuar seriozisht qytezën e Leposaviqit dhe venbanimet përreth. Poashtu deponia paraqet rrezik të drejtpërdrejt për kontaminimin e lumit Ibër dhe akuiferin e përrethëm.

#### *4.1.3.1.5 Deponia Staro Jalovishte Kizhnicë*

Deponija e parë e mbeturinave minerare ndodhet në bregun e djathtë të lumit Graqanica që vjen nga diga e Liqenit të Badovcit dhe e njëjta i ka pranuar mbeturinat minerare dhe sterile nga miniera e Badovcit, Hajvalisë dhe Kizhnicës si dhe të flotacionit të Kizhnicës. Sipërfaqja e deponisë është rreth 5 hektar. Deponija ka një ngjyrë kafe të kuqërremtë metalike nga oksidimi i sipërfaqësor i metaleve prezente në sterilin e deponisë. Deponija mbulon rrafshinën aluviale, me lartësi rreth 15 m, ndërsa është e gjatë rreth 500 m. Në deponi janë deponuar rreth 11 Mt të xeheve nga të gjitha minierat e Hajvalisë, Kizhnicës dhe Badovcit.

#### *4.1.3.1.6 Deponija e Badovcit*

Deponija e sterilit minerar në Badovc ndodhet në kodrat në bregun e majtë të pjesës së poshtme të lumit që vjen nga Liqeni i Badovcit. Deponia është e vendosur në një luginë të vogël me shpatë të thepisura, e cila ishte një degë e bregut të majtë të lumit të Graqanicës. Kjo deponi është hapur pas mbylljes së deponisë së Kizhnicës me sipërfaqe prej rreth 1 hektar dhe me mbeturina të sterilit minerar të vlerësuar rreth 8 MT. Deponija e Badovcit ka pranuar mbeturina minerare dhe sterilit të flotacionit nga minierat e Artanës që nga viti 1978 të cilat janë dërguar përmes teleferikut tek flotacioni i Kizhnicës si dhe mbeturinat minerare dhe të sterilit të Hajvalisë, Badovcit dhe Kizhnicës.

Në deponinë e Badovcit janë bërë disa analiza për përmbajtjen e mbeturinave të xeheve dhe sterile.

**Tabela Nr. 9: Kompozicioni i mbeturinave të sterililit minerar në deponin e Badovcit**

	Al <sub>2</sub> O <sub>3</sub> %	Bi mg/kg	Cd mg/kg	Cu % (g/t)	Fe <sub>2</sub> O <sub>3</sub> %	MgO %	Ni %	Pb %	Zn %	Ge g/t	Ag g/t	In g/t	Te g/t
Studimi i Trepçës	5.1	18	34	0.032%	28	4	0.063	0.6	0.56	-	12	-	-
Projekti Francez <sup>5</sup>	-	52	-	568	-	-	-	0.59	1.35	9.9	26	6.6	5.4

#### 4.1.3.1.7 Deponitë Mareci 1 dhe 2

Dy deponitë e mbeturinave sterile të minerës së Artanës ndodhen 2 km në veri të Novobërdës, afër minierës së Novo Brdo dhe në rrjedhën e poshtme të koncentrarorit të vjetër Marevc, tani i braktisur përgjatë lumit të Marevcit. Deponitë në fjalë janë përdorur deri më vitin 1978 ku janë depozituar sterili i xehes nga miniera Artana dhe fushat mineralmbajtëse Përroi i Thartë dhe Kaltrina. Sasia e mbeturinave të procesimit të xehes në këto dy deponi vlerësohen 0.4 dhe respektivisht 1.6 Mt. Më pas me futjen në punë të koncentratorit të Kizhnicës është transportuar xehja atje ndërsa edhe sterili minerar është depozituar atje. Nuk ka të dhëna të detajuara mbi koncentrimin e metaleve të rënda por ka vlerësime se koncentrimi i Pb është 0.21% ndërsa e Zn është 0.14%<sup>6</sup>.

Deponitë Mareci 1 & 2 kanë përfituar nga një program të rregullimit të shtratit të realizuar nga UNDP në Kosovë e financuar nga qeveria Hollandeze. Megjithatë për shkak të mos mirëmbajtjes kontinuale gjendja në këto deponi prap është përkeqësuar.

#### 4.1.3.1.8 Deponia e mbeturinave të minierave të kromit në Devë të Gjakovës

Vendburimi më i njohur i xeheve të kromit në Kosovë, është miniera e kromit Deva e cila gjendet në afërsi të kufirit me Shqipërinë. Në këtë regjion janë edhe vendburimet: Babaj i Bokës, Kraleвица, Pllanik-Ponoshec, Popovc, Çafë Prush, etj. Kromi është shfrytëzuar pothuajse në të gjitha regjionet e paraqitjes së tij. Në Kosovë deri më 1991 kur u bë ndërprerja e shfrytëzimit të tij, janë shfrytëzuar 1.02 Mt xehe kromi.

Përbërja kimike e xehes së kromit sillet prej: Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub> - 35-55%, Al<sub>2</sub>O<sub>3</sub> - 8-23% dhe FeO rreth 13%. Nxjerrja dhe pasurimi i xehes në fabrikën e pasurimit në Devë ka krijuar edhe deponitë e sterililit minerar. Kjo deponi ka sipërfaqe prej 1 ha. Vlerësohet se kjo deponi paraqet burim potencial të ndotjes me metale të rënda dhe paraqet kërcënim për mjedisin dhe rrjedhat ujore në këtë zonë. Vlerësohet se sasia e sterililit minerar nga procesimi i xehes së kromiteve është 0.5 Mt.

#### 4.1.3.2 Deponia nga minierat e magnezitit në Golesh dhe Strezovc

Në Golesh dhe Strezovc ndodhen dy miniera të magnezitit (MgCO<sub>3</sub>). Te dyja këto miniera kanë nisur së eksploatuari si kariera dhe ka vazhduar eksploatimi dhe shfrytëzimi i tyre deri në mbyllje në vitin 1999. Sipas disa vlerësimeve në vitin 1990, në Golesh prodhohej rreth 110,000 t magnezit, 22,000 t magnezium dhe 10,000 t magneziumi kaustik të kalçinuar për vit. Miniera e Goleshit është shfrytëzuar me një pus minerar, ndërsa miniera në Strezovc me anë të nje galerie<sup>19</sup>.

Para luftës miniera e magnezitit në Golesh – Magurë ka prodhuar magnez kaustik të qëndrueshëm ndaj zjarrit, për shfrytëzuesit nga ish-Jugosllavia, dhe ka eksportuar në vendet tjera të Ballkanit dhe Itali. Shfrytëzimi i magnezitit nga miniera në Strezovc ka filluar në vitin 1956. Në vitin 1973 lëshohet në prodhim separacioni. Shfrytëzimi i resurseve të magnezitit

<sup>5</sup> French scientific cooperation 2007-2008 on the Trepča lead- zinc-silver mine and the gold potential of Novo Brdo/Artana tailings (Kosovo) Final Report BRGM/RP-57204-FR October, 2009

<sup>6</sup> Tailing Management in Kosovo, Based in Sustainable Development and Environment Friendly Principles Kemajl Zeqiri, Bislim Muqa, Musa Shabani

është kryer me metoda sipërfaqësore dhe nëntokësore. Këto dy miniera janë privatizuar nga kompania “Iminggrup mgo” Sh.p.k. në vitin 2007.

Si pasojë e mos përmbushjes së kushteve të Marrëveshjes së privatizimit nga ana e blerësit (“Iminggrup mgo”) bordi i AKP-së në vitin 2010 ka marrë vendim për ndëshkimin financiar dhe atë; MIM Golesh me 6,357,094 €, dhe XIM Strezoc me 5,475,119 €. Pra, edhe pas procesit të privatizimit këto miniera nuk kanë arritur të konsolidohen dhe fillojnë prodhimin<sup>7</sup>.

Në këtë minierë është kriju një deponi me sipërfaqe prej 15.13 ha ku janë depozitu metale të renda, magnez dhe me mbetje të vajrave të përdorura. Vlerësohet se sasia e mbeturinave minerare nga procesimi i xehes së magnezitit është 0.5 Mt.

#### 4.1.4 Kuantifikimi i mbeturinave Mbeturina që dalin nga eksplorimi, miniera, gurore, si edhe nga trajtimet fiziko - kimike të mineraleve

<b>Tabela Nr. 10: Mbeturina të rrezikshme që dalin nga eksplorimi, miniera, gurore, si edhe nga trajtimet fiziko - kimike të mineraleve</b>				
<b>Kodi</b>	<b>Emërtimi i kategorisë</b>	<b>Sasia në fillim të vitit raportues</b>	<b>Sasia e mbeturinave e krijuar në 2019</b>	<b>Sasia e mbeturinave në fund të periudhës raportuese</b>
01 03	Mbeturinat nga procesimet e mëtutjeshme fizike dhe kimike të mineraleve metalore	51.8 Mt	0.11 Mt	51.9 Mt
01 03 04*	Mbeturinat acidike nga përpunimi i xeherorëve me përmbajtje të squfurit	50.8 Mt	0.11 Mt	51.9 Mt
01 03 05*	Mbeturina tjera që përmbajnë substanca të rrezikshme	1.0 Mt	-	1.0 Mt
01 03 07*	Mbeturina tjera që përmbajnë substanca të rrezikshme nga përpunimet fiziko-kimike të mineraleve metalore	-	-	-
01 04	Mbeturina që dalin nga përpunimet fiziko-kimike të mineraleve jometallore	-	-	-
01 04 07*	Mbeturina që përmbajnë substanca të rrezikshme nga përpunimet fiziko- kimike të mineraleve jo-metalike	-	-	-
01 05	Balta nga shpimet dhe mbeturinat tjera nga shpimet	-	-	-
01 05 05*	Balta dhe mbeturinat tjera nga shpimet për naftë- hidrokarbure	-	-	-
01 05 06*	Balta dhe mbeturinat tjera nga shpimet që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
<b>Total mbeturina të rrezikshme që dalin nga eksplorimi, miniera, gurore, si edhe nga trajtimet fiziko - kimike të mineraleve</b>		<b>51,800 Mt</b>	<b>0.1 Mt</b>	<b>51.9 Mt</b>

<sup>7</sup> Strategjia minerare e Republikës së Kosovës 2012 – 2025 fq. 10

## 4.2 Mbeturinat nga agrokultura, hortikultura, kultura ujore, pylltaria, gjuetia dhe peshkimi

Në katalogun shtetëror të mbeturinave të Kosovës, kategoria e dytë e mbeturinave përfshinë „Mbeturinat nga bujqësia, hortikultura, akuakultura, pylltaria, gjuetia dhe peshkimi, përgatitja dhe përpunimi i ushqimit“.

Në këtë kategori përbahen shtatë nënkategori mbeturinash prej të cilave vetëm nënkategoria e parë përmban një hyrje të rrezikshme gjashtë shifrore të prezentuar në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr. 11: Mbeturinat nga bujqësia, hortikultura, akuakultura, pylltaria, gjuetia dhe peshkimi, përgatitja dhe përpunimi i ushqimit		
Kodi	Kategoria	Lloji i hyrjes
02 01	Mbeturinat nga bujqësia, kopshtaria, akuakultura, pylltaria, gjuetia dhe peshkimi	
02 01 08*	Mbeturinat bujqësore që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr

Në kategorinë e dytë të mbeturinave kemi vetëm një hyrje 6 shifrore të karakterizuar si hyrje e rrezikshme me emërtimin: „Mbeturinat bujqësore që përmbajnë substanca të rrezikshme (02 01 08)“. Të gjitha hyrjet tjera në kategorinë 2 konsiderohen si mbeturina të parrezikshme.

Sipas analizave të informacionit rezulton se mbeturinat e rrezikshme nga agrokultura, hortikultura, kultura ujore, pylltaria, gjuetia dhe peshkimi të gjeneruara në 2019 janë 160.8 t.

### 4.2.1 Mbeturinat bujqësore që përmbajnë substanca të rrezikshme

Mbeturinat e rrezikshme bujqësore iu referohen agrokimikateve të cilat përfshijnë substancat që përdoren në bujqësi për rritjen e pleshmërisë së tokës dhe parametrave të saj, preparateve për luftimin e sëmundjeve e kulturave bujqësore si dhe në blegtori substancave që përdoren në rritjen e bagëtive. Përdorimi i agrokimikateve është esencial në rritjen e rendimentit të kulturave bujqësore. Megjithatë përdorimi i agrokimikateve ka edhe mangësi sidomos në ndotjen e tokës, burimeve ujore, dhe ajrit.

Shumica nga akrokimikatet konsiderohen si të rrezikshme dhe të njëjtat duhet të identifikohen klasifikohen, etiketohen, paketohen dhe largohen nga prodhuesi apo zotëruesi i tyre në linjë me infrastrukturën ligjore:

Më poshtë janë disa nga shkaqet e gjenerimit të mbeturinave bujqësore të rrezikshme:

- Një sasi e agrokimikatit nuk absorbohet nga kultura bimore e trajtuar dhe e njëjta largohet nga bima përmes shiut apo erës dhe depozitohet në tokë apo në mjedisin ujor,
- agrokimikatet janë ndaluar të përdoren për shkak të vetive të tyre të rrezikshme;
- afati i agrokimikateve ka skaduar;
- gjendja fizike ose kimike e agrokimikateve për shkak të magazinimit joadekuat është përkeqësuar dhe bërë e papërdorshme;
- agrokimikatet nuk mund të identifikohen sepse nuk kanë etiketë, ose etiketa është e palexueshme;

### 4.2.2 Të dhënat sektoriale të bujqësisë

Sipas të dhënave të Regjistrimit të Bujqësisë 2014 të publikuara nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës, në shkallë vendi ka 130,775 Ekonomi Bujqësore, të cilat kultivojnë 413,635 hektarë të sipërfaqes së tokës bujqësore dhe rrisin 261,689 gjedhe, 183,584 dele dhe 28,430 dhi.

Në gjithsej sipërfaqen e shfrytëzuar të tokës bujqësore, sipërfaqja më e madhe i përket livadheve dhe kullosave (54%).

Nga gjithsej sipërfaqja e livadheve dhe kullosave, 77% e tokës bujqësore është kullotë. Sa i përket tokës së punueshme – arave, kultura që zë pjesën më të madhe të tokës së punueshme është gruri (50%).

Ndërsa, në sipërfaqen e tokës së kultivuar me perime, specat zënë rreth 38% të sipërfaqes së tokës me perime. Nga gjithsej sipërfaqja e tokës së kultivuar me vreshta, 58.6% e sipërfaqes është e kultivuar me rrush për prodhimin e verës. Një sipërfaqe e konsiderueshme e tokës së kultivuar me vreshta, kultivohet nga subjektet juridike (25%).

Pjesa më e madhe e sipërfaqes së plantacioneve me pemishte është e kultivuar me molla (56.1%) dhe me kumbulla (19.9%). Mollat dhe kumbullat janë po ashtu llojet më të rëndësishme të pemëve në pemishtet ekstensive (molla 34.3% dhe kumbulla 24.8%)

Në krahasim me vendet e BE-së, në Kosovë Ekonomi Bujqësore janë katër (4) herë më të vogla për nga madhësia mesatare e Ekonomive Bujqësore, sipas sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore. Ngjashmëria në këtë segment është më e madhe me vendet fqinje si psh Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia Veriore.

Sipas Anketës së ekonomive bujqësore në 2017 të publikuar nga ASK, sipërfaqja e tokës së plehruar me plehra minerale është 154,198 Ha ndërsa sasia e plehrave të përdorura është 73,386 ton apo 476 ton për hektar. Shumica e plehrave të përdorura është NPK<sup>8</sup>, NAG, URE dhe plehra tjera minerale me bazë azoti.

Sa i përket pesticideve Anketa ofron vetëm të dhënën e sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore të trajtuar me pesticide 115,543 Ha por jo edhe vlerën sasiore.

#### 4.2.3 Të dhënat mbi përdorimin e agrokimikateve

Në tabelat në vijim janë prezantuar të dhënat e importit të agrokimikateve dhe plehëruesve për 2019 nga DK:

<b>Tabela Nr. 12: Importet e Insekticideve, rodenticideve, fungicideve, herbicideve, produkteve kundër rritjes dhe rregullatorët e rritjes së bimëve, disinfektantët dhe produkte të ngjashme</b>		
Kodi Tarifor	Vlera Mallrave €	Pesha kg
3808599000 - Te tjera	54.0	7.3
3808610000 - Ne paketime me nje permbajtte te peshes neto qe nuk tejkalon 300 g	11,521.3	550.3
3808620000 - Ne paketime me nje permbajtte te peshes neto qe tejkalon 300 g por nuk tejkalon 7,5 kg	28,029.3	1,463.2
3808699000 - Te tjera	132.9	18.1
3808911000 - Bazuar në piretroide	132,198.7	19,083.1
3808914000 - Bazuar në përbërjet e organofosforit	26,901.5	2,430.0
3808919000 - Të tjera	709,724.9	124,684.6
3808921000 - Preparatet e bazuara në përbërjet e bakrit	166,605.6	27,075.5
3808922000 - Të tjera	222,038.2	56,147.2
3808923000 - Bazuar në ditiokarbamatet	117,508.6	18,055.0
3808925000 - Bazuar në diazole apo triazole	139,793.9	3,463.2
3808926000 - Bazuar në diazina apo morfolina	32,644.8	1,526.4
3808929000 - Të tjera	573,722.2	37,766.8
3808931100 - Bazuar në fenoksi - fitohormonet	310,598.8	122,500.8
3808931300 - Bazuar në triazinat	11,220.7	4,752.0
3808932300 - Bazuar në derivatet e urësë, të uracilit dhe sulfonilurese	80,599.2	15,282.0
3808932700 - Të tjera	1,279,995.6	177,812.5
3808939000 - Rregullatorët e rritjes së bimëve	12,281.0	880.1

<sup>8</sup> Nitrat gëlqeror i amonjakut

3808941000 - Bazuar në kripërat kuaternare të amoniakut	31,539.9	5,804.6
3808942000 - Bazuar në përbërjet e halogjenizuara	21,569.0	8,258.0
3808949000 - Të tjera	300,627.7	108,803.2
3808991000 - Rodenticidet	81,180.5	24,040.3
3808999000 - Të tjera	126,756.6	44,530.9
<b>Total importe të agrokimikateve për 2019</b>	<b>4,417,244.7</b>	<b>804,934.9</b>

Sipas të dhënave të DK në Kosovë importohen rreth 805 ton agrokimikateve në formë insekticidesh, rodenticidesh, fungicidesh, herbicidesh, produkteve kundër rritjes dhe rregullatorët e rritjes së bimëve, disinfektantët dhe produkte të ngjashme në vlerë monetare prej 4.4 milion €.

Poashtu sipas DK në Kosovë janë importuar gjithsej 26,681 ton të plehëruesve për vitin 2019 në vlerë prej 8.3 milion €.

<b>Tabela Nr. 13: Importet e plehëruesve për 2019</b>		
<b>Kodi Tarifor</b>	<b>Vlera Mallrave €</b>	<b>Pesha kg</b>
<b>3101 0000 00 Plehëruesit me origjinë bimore apo shtazore, nëse janë apo jo të përzier së bashku apo të trajtuar kimikisht; plehëruesit e prodhuar nga përzierja apo trajtimi kimik i produkteve bimore apo shtazore</b>	<b>134,159.3</b>	<b>448,792.0</b>
3101000000 - Plehëruesit me origjinë bimore apo shtazore, nëse janë apo jo të përzier së bashku apo të trajtuar kimikisht; plehëruesit e prodhuar nga përzierja apo trajtimi kimik i produkteve bimore apo shtazore	134,159.3	448,792.0
<b>3102 Plehëruesit mineral apo kimik, azotike:</b>	<b>128,836.8</b>	<b>424,452.0</b>
3102101000 - Ure që përmban më shumë se 45% ndaj peshës azot ndaj produktin të thatë anhidër	2,706,517.0	8,848,453.5
3102109000 - Ure që përmban jo me shumë 45% ndaj peshës azot ndaj produktin të thatë anhidër	84,468.2	214,411.3
3102210000 - Sulfat amoni	5,565.6	15,057.0
3102301000 - Nitrat amoni në solucion ujor	1,211.8	2,000.0
3102309000 - Nitrat amoni (ndryshe nga ai në solucion ujor)	582,121.7	1,660,669.0
3102401000 - Përzierje të nitratit të amonit me karbonat kalciumi apo substanca të tjera inorganike jo-plehëruese, me përmbajtje azoti jo më shumë se 28%	2,509,570.2	11,587,025.0
3102500000 - Nitrat natriumi	2,054.8	3,002.0
3102600000 - Kripërat dyfishe dhe përzierjet e nitratit të kalciumit dhe nitratit të amonit	23,841.4	51,900.0
3102800000 - Përzierjet e uresë dhe të nitratit të amonit në solucion ujor apo në solucion amoniakal	104,995.5	372,552.0
<b>3103 Plehëruesit minerale apo kimike, fosfatike</b>	<b>110,715.0</b>	<b>651,750.0</b>
3103190000 - Te tjera	106,576.9	647,400.0
3103900000 - Plehërues të tjere kimike fosfatike (ndryshe nga superfosfati)	4,138.1	4,350.0
<b>3104 Plehëruesit minerale apo kimike, potasike:</b>	<b>47,129.7</b>	<b>26,424.8</b>
3104201000 - Më përmbajtje kaliumi të vlerësuar si K <sub>2</sub> O, ndaj peshës, jo më shumë se 40% mbi produktin e thatë anhidër	18,671.5	5,000.0
3104209000 - Më përmbajtje kaliumi të vlerësuar si K <sub>2</sub> O, ndaj peshës, më shumë se 62% mbi produktin e thatë anhidër	507.9	650.0
3104300000 - Sulfat kaliumi	3,109.5	6,033.0
3104900000 - Të tjera	24,840.9	14,741.8
<b>3105 Plehëruesit minerale apo kimike që përmbajnë dy apo tre prej elementeve plehërues nitrogjen, fosfor dhe kalium; plehërues të tjerë; mallrat e këtij Kapitulli në tableta apo në forma apo në paketa të ngjashme të një peshe bruto jo më tepër se 10 kg</b>	<b>7,926,614.9</b>	<b>25,129,804.6</b>

3105100000 - Mallra te kapiullit 31 në tableta apo në forma te ngjajshme apo në paketa me peshe bruto jo më tepër se 10 kg	65,331.8	46,587.1
3105201000 - Plehëruesit kimike apo mineralë me te tre elementet plehërues nitrogen, fosfor dhe kalium, me me teper se 10% azot	5,529,431.9	17,428,498.3
3105209000 - Plehëruesit kimike apo mineralë me te tre elementet plehërues nitrogen, fosfor dhe kalium, me deri 10% azot	1,979,993.8	6,485,867.0
3105300000 - Pleherues kimik mineral - Hidrogenortofosfat diamoni (fosfat diamoni)	36,019.9	80,300.0
3105400000 - Pleherues kimik mineral - Dihidrogenortofosfat amoni (fosfat monoamoni) dhe përzierjet prej tyre me hidrogenortofosfat diamoni (fosfat diamoni)	2,984.8	2,400.0
3105510000 - Plehërues të tjerë minerale apo kimike që përmbajnë vetem nitrate dhe fosfate	93,240.0	288,000.0
3105590000 - Plehërues të tjerë minerale apo kimike që përmbajnë të dy elementet plehërues nitrogen dhe fosfor, por jo nitrate ose forfate	27,648.3	90,881.6
3105600000 - Plehëruesit minerale apo kimik që përmbajnë të dy elementet plehërues fosfor dhe kalium	6,145.1	6,161.2
3105908000 - Të tjera	185,819.4	701,109.4
<b>TOTAL:</b>	<b>8,347,455.72</b>	<b>26,681,223.42</b>

#### 4.2.4 Kuantifikimi i sasisë së mbeturinave të rrezikshme nga bujqësia

Agrokimikatet mbeturinë përmban dy komponente dmth agrokimikatet e skaduara nga ish agrokombinatet bujqësore si dhe nga agrokimikatet mbeturinë që gjenerohen gjatë vitit. Sa i përket agrokimikateve të skaduara është kontaktuar Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural MBPZHR të cilat kanë pohuar se ekziston sasi e konsiderueshme e këtyre mbeturinave të vendosura nëpër komuna të ndryshme të Kosovës si psh në Pejë, Suharekë dhe komuna tjera. Megjithatë MBPZHR nuk e ka bërë inventarizimin e këtyre mbeturinave kështuqë nuk ka qenë në gjendje të ofroj të dhëna për këtë cikël raportues.

Agrokimikatet mbeturinë të gjeneruara gjatë 2019 janë kalkuluar si përqindje e aplikuar në agrokimikatet e importuara respektivisht të përdorura. Njëra komponentë e agrokimikateve i dedikohet moshfrytëzimit nga kultura bimore respektivisht kontaminimit të tokës dhe mjedisit ujqor dhe komponenta tjetër i referohet agrokimikateve të skaduara po të nxjerruna nga përdorimi për qëllime të cekura më lartë.

Në pamundësi të sigurimit të të dhënave dhe me qëllim të thjeshtimit të kalkulimit sasia e importuar e kimikateve është adoptuar si agrokimikate të përdorura duke vlerësuar se importi e përcjell konsumin si dhe për shkak se agrokimikatet nuk prodhohen në vend.

Kalkulimi I agrokimikateve mbeturinë është prezantuar në tabelën në vijim:

Tabela Nr. 14: Kuantifikimi i mbeturinat të rrezikshme nga bujqësia, hortikultura, akuakultura, pylltaria, gjuetia dhe peshkimi, përgatitja dhe përpunimi i ushqimit				
			Faktori	Sasia e mbeturinave
Agrokimikatet e importuara të përdorura gjatë vitit			-	804 ton
Agrokimikatet e pashfrytëzuara nga kulturat bimore			10%	80.4 ton
Agrokimikatet e skaduara ose të nxjerrura jashtë përdorimit			10%	80.4 ton
Total mbeturinat				160.8 ton
Kodi	Emërtimi	Sasia në fillim të vitit raportues	Sasia e mbeturinave e krijuar në 2019	Sasia e mbeturinave në fund të periudhës raportuese
02 01	Mbeturinat nga bujqësia, kopshtaria, akuakultura, pylltaria, gjuetia dhe peshkimi	-	160.8 ton	160.8 ton

02 01 08*	Mbeturinat bujqësore që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	160.8 ton	160.8 ton
<b>Total mbeturina të rrezikshme nga bujqësia, hortikultura, akuakultura, pylltaria, gjuetia dhe peshkimi, përgatitja dhe përpunimi i ushqimit</b>		<b>-</b>	<b>160.8 ton</b>	<b>160.8 ton</b>

### 4.3 Mbeturinat nga përpunimi i drurit, paneleve, mobileve, pulpës, letrës dhe kartonit

Në tabelën në vijim janë paraqitur mbeturinat e rrezikshme së bashku me hyrjet katër dhe gjshtëshifrore. Siq mundë të shihet nga tabela ekzistojnë 6 lloje të mbeturinave të rrezikshme prej të cilave katër janë me hyrje absolute dhe dy pasqyruese.

Tabela Nr. 15: Mbeturinat e rrezikshme nga përpunimi i drurit, paneleve, mobileve, pulpës, letrës dhe kartonit		
Kodi	Emërtimi i kategorisë	Lloji i hyrjes
03 01	Mbeturinat nga përpunimi i drurit dhe prodhimit të paneleve dhe mobileve	-
03 01 04*	Pluhur sharre, ashklat, copa prej druri, panele me materiale grimcore dhe me pllaka që përmbajnë materiale të rrezikshme	PRr
03 02	Mbeturinat nga konservimi i drurit	-
03 02 01*	Komponime organike jo të halogjenuara që përdoren për konservimin e drurit	ARr
03 02 02*	Komponime organike të kloruara që përdoren për konservimin e drurit	ARr
03 02 03*	Komponime organometalike që përdoren për konservimin e drurit	ARr
03 02 04*	Komponime inorganike që përdoren për konservimin e drurit	ARr
03 02 05*	Komponime të tjera që përdoren për konservimin e drurit që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr

#### 4.3.1 Kimikatet dhe mbeturinat e rrezikshme në procesin e përpunimit dhe konservimit të drurit dhe prodhimit të paneleve dhe mobileve

Industria e konservimit të drurit ka një aplikim të gjerë dhe gjeneron produkte me aplikim të gjerë si binarët e trenit, shtyllat e rrjetit të rrymës, telefonisë fikse, televizionit kabllor, për konstruksionet e kulmeve, shtëpiza nga druri, dyer dhe dritare e produkte të ngjashme.

Industria e trajtimit të drurit konservon drurin përmes presionit ose impregnimit termik të kimikateve. Këto procese kërkojnë përdorimin e shumë kimikateve toksike, siç janë katrani, pentaklorofenoli dhe arsenikët për të parandaluar sulmet dhe dëmtimet nga kërpudhat, bakteret, insektet dhe krustaqet ndërmjet tjerash. Ndërsa këto kimikate kanë treguar efektshmëri në prezervimin e drurit, ato shoqërohen me shumë efekte negative shëndetësore për punëtorët e ekspozuar si dhe me emisione të dëmshme për mjedisin si psh llumrat e rrezikshme të shkarkuara në kanalizime dhe trupa ujore. Konservimi i drurit bëhet me qëllim që të përmirësohen cilësitë fiziko-mekanike të drurit, për të zgjatur jetën e dobishme si dhe mbrojtjen nga dëmtimi prej krimbave, insekteve, brejtësve si dhe efekteve korroduese të shiut, borës, dilatimeve termike dhe ekspozimeve të tjera të ngjashme.

Konservimi i drurit përfshin përgatitjen e drurit, trajtimin e tij me kimikate, dhe pastaj tharjen. Druri fillimisht thahet plotësisht përmes avullit dhe vakumit, zihet nën kushtet e vakumit dhe thahet në furrë. Paratrajtimi shoqërohet me një sasi të madhe të ujërave të zeza që përmbajnë supstanca të rrezikshme.

Trajtimi i drurit zbatohet përmes proceseve me dhe pa presion. Proceset nën presion mbështeten në impregnimin e drurit përmes forcës, ndërsa proceset pa presion mbështeten në konservuesit e mbartur nga vaji të aplikuar me ose pa nxehtësi. Konservuesit ripërdoren përsëri, duke rezultuar në akumulimin e mbeturinave të kontaminuara. Aerosolet dhe avujt gjithashtu mund të emetohen gjatë konservimit kimik.

Ekziston një gamë e gjerë e produkteve kimikate me bazë inorganike dhe organike që përdoren në procesin e konservimit të drurit. Kimikatet më të përdorura janë pentaklorofenoli, kreosoti, kripërat inorganike arsenike dhe ato kromatike si dhe katrani.

Katrani formohet nga distilimi i pjesshëm të karburanteve të papërpunuara të qymyrit dhe paraqet një prezervativ me bazë organike. Kjo përbërje përdoret si një ruajtës i drurit që vepron si një fungicid dhe pesticid i aplikuar në një proces të trajtimit nën presion, që forcon penetrimin e pesticideve në lëndën drunore. Katranin ka dukjen e një rrëshirë të trashë me ngjyrë të zezë. Përbërja kimike e katranit ndryshon në varësi të origjinës së qymyrit dhe natyrës së procesit të distilimit dhe mund të përbëhet nga deri në 10,000 kimikate të ndryshme. Gjashtë klasat kryesore të komponimeve të katranit përfshijnë: hidrokarbure aromatike, acide fenolike, heterociklet që përmbajnë azot, squfur apo oksigjen dhe aminet aromatike. Ka evidencë në rritje se katrani është një substancë kancerogjene. Kanceri i lëkurës mund të paraqitet pas ekspozimit afatgjatë, veçanërisht për shkak të kontaktit të drejtpërdrejtë me lëkurën gjatë trajtimit të drurit.

Arsenati i bakrit kromatik (Chromate copper arsenate CCA) është një prezervativ inorganik shumë efektiv i drurit sidomos nëse aplikohet së bashku me katran i cili lë sipërfaqen e drurit të pastër dhe të lyer. Ai aplikohet përmes procesit të lyerjes dhe trajtimit nën presion. Ky prezervativ përbëhet nga kromi, bakri dhe arseniku. Përkundë efektshmërisë në mbrojtjen e drurit, CCA mund të shkaktoj probleme serioze shëndetësore për organizmat dhe punëtorët që vijnë në kontakt me substancën. Druri që trajtohet me CCA mund të rrjedhë ruajtësin në mjedisin rrethues. Tre elementët që përbëjnë CCA janë toksike dhe kancerogjene për shumë organizma ujorë. Nëse druri i trajtuar me CCA digjet çon në formimin e dioksinave, duke gjeneruar më tej komponime të paqëndrueshme arseniku dhe organike toksike të hirit. Arseniku në CCA mund të shkaktoj kancer të lëkurës, mëlçisë, zorrëve dhe fshikëzës.

Pentaklorfenoli (Pentachlorophenol PCP) është një prezervativ me bazë organike i cili zbatohet për konservimin e drurit. PCP është një hidrokarbur i kloruar që përdoret si pesticid dhe herbicid duke u penetruar në lëndën drunore përmes presionit. Jeta e drurit të trajtuar me PCP mund të zgjatet deri 35 vjet. PCP është një substancë e rrezikshme kancerogjene që përmban substanca si heksaklorobenzeni (HCB) dhe dibenzodioksinat e kloruara dhe dibenzofuranet e kloruara (CDD dhe CDF). HCB është një ndotës i qëndrueshëm, bio-akumulues dhe toksik i mjedisit që kontaminon ujërat dhe burimet e zinxhirit ushqimor. Ekspozimi i njeriut ndaj HCB shoqërohet me dëmtime të lëkurës, sistemit nervor, mëlçisë, veshkave, efekte riprodhuese dhe kancer. CDD dhe CDF kanë treguar se janë substanca kancerogjene duke shkaktuar efekte negative endokrine, riprodhuese, zhvillimore, imunotoksicitet, hepatotoksicitet, neurotoksicitet, dhe një sërë kanceresh tek kafshët dhe njerëzit.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë të dhënat e klasifikimit të harmonizuar nga ECHA për disa disa nga kimikatet dhe substancat që përdoren më së shumti për konservimin e drurit.

**Tabela Nr. 16: Klasifikimi dhe etiketimi i kimikateve që përmbahen në procesin e konservimit dhe përpunimit të drurit**

	EC List No.	CAS No.	Index No.	Hazard Class and Category Code(s)	Hazard Statement Code(s)	Pictograms, Signal	Pictograms
Creosote	232-287-5	8001-58-9	648-101-00-4	Carc. 1B	H350	GHS08 Dgr	
Arsenic	231-148-6	7440-38-2	033-001-00-X	Acute Tox. 3 * Acute Tox. 3 * Aquatic Acute 1 Aquatic Chronic 1	H301 H331 H400 H410	GHS09 GHS06 Dgr	
Pentachlorophenol	201-778-6	87-86-5	604-002-00-8	Acute Tox. 3 * Acute Tox. 3 * Skin Irrit. 2 Eye Irrit. 2 Acute Tox. 2 * STOT SE 3 Carc. 2 Aquatic Acute 1 Aquatic Chronic 1	H301 H311 H315 H319 H330 H335 H351 H400 H410	GHS09 GHS08 GHS06 Dgr	
Hexachlorbenzene	204-273-9	118-74-1	602-065-00-6	Carc. 1B STOT RE 1 Aquatic Acute 1 Aquatic Chronic 1	H350 H372 ** H400 H410	GHS09 GHS08 Dgr	

#### 4.3.2 Kuantifikimi i sasisë së mbeturinave të rrezikshme nga përpunimi i drurit, paneleve, mobileve, pulpës, letrës dhe kartonit

Mbeturinat e rrezikshme nga përpunimi i drurit paraqitet mbeturina nga përpunimi i drurit dhe prodhimit të paneleve dhe mobiljeve si dhe mbeturinat nga procesi i konservimit të drurit.

Mbeturinat e rrezikshme nga përpunimi i drurit dhe prodhimit të paneleve dhe mobiljeve paraqitet në formë pluhuri sharre, ashklash, copash prej druri, panele me materiale grimcore dhe me pllaka. Në Kosovë sipas shoqatës së përpunuesve të drurit funksionojnë rreth 650 prodhuesih aktiv të mobileve dhe dyerve dhe dritareve që prodhojnë këso lloj mbeturinash gjatë procesit të prodhimit dhe madhësia e këtyre operatorëve variron prej prodhuesve të mëdhenj, të mesëm dhe të vegjël. Ndër prodhuesit kryesor mund të përmenden Binni, Cia Berto, Palma, Mob In, Graniti, Walker, Albed, Euro Mebel, Gacaferri, Bizzarro, Lesna, Amre, Berisha, Graniti, Ajos, e shumë operator tjerë. Nëse përvetësojmë se një mobileri mesatarisht prodhon një ton mbeturina në vit në formë pluhuri sharre, ashklash, copash prej druri, panele me materiale grimcore dhe me pllaka atëherë del se sasia e mbeturinave të rrezikshme nga kjo kategori është rreth 650 ton/vit.

Mbeturinat e rrezikshme nga konservimi i drurit paraqiten në formë të mbeturinave të ngurta, ujërave të ndotura dhe emisionet e gazrave. Format kryesore të këtyre mbeturinave janë llumrat e fundosura dhe nga trajtimi i ujrave të ndotura, tepricat e lëndës drurore, dhe ujërat e zeza nga procesi i tharjes.

Në tabelën në vijim janë dhënë parametrat e kalkulimit të mbeturinave nga procesimi i drurit në varësi të procesit të trajtimit të drurit apo kimikatit të përdorur. Megjithatë forma më e mirë e kalkulimit të mbeturinave është përmes raportimit të tyre nga operatori i procesimit të drurit.

Tabela Nr. 17: Gjenerimi i mbeturinave nga procesi i konservimit të drurit		
Lloji i mbeturinave	Procesi i trajtimit apo kimikati i përdorur	Sasai e mbeturinave
Ujëra të ndotura	Paratrajtimi i drurit	175 l/m <sup>3</sup> të drurit të konservuar
Llumra dhe reziduale	Katrani	0.542 l/m <sup>3</sup> të drurit të konservuar
Llumra dhe rezidualet	Pentaklorofenoli	0.845 l/m <sup>3</sup> të drurit të konservuar
Llumra dhe rezidualet	Konservuesit joorganik	0.051 l/m <sup>3</sup> të drurit të konservuar

Projekti nuk ka arritur të identifikoj operatorët që bëjnë konservimin e drurit për këtë cikël raportues kështuqë e gjithë sasia e mbeturinave të rrezikshme do i referohet mbeturinave nga përpunimi i drurit dhe prodhimit të paneleve dhe mobiljeve në formë pluhuri sharre, ashklash, copash prej druri, panele me materiale grimcore dhe me pllaka të cilat janë të paraqitura në tabelën në vijim:

Tabela Nr. 18: Mbeturinat e rrezikshme nga përpunimi i drurit, paneleve, mobileve, pulpës, letrës dhe kartonit				
Kodi	Emërtimi	Sasia në fillim të vitit raportues	Sasia e mbeturinave e krijuar në 2019	Sasia e mbeturinave në fund të periudhës raportuese
03 01	Mbeturinat nga përpunimi i drurit dhe prodhimit të paneleve dhe mobiljeve	-	650 t	650 t
03 01 04*	Pluhur sharre, ashklat, copa prej druri, panele me materiale grimcore dhe me	-	650 t	650 t
03 02	Mbeturinat nga konservimi i drurit	-	-	-
03 02 01*	Komponime organike jo të halogjenuara që përdoren për konservimin e drurit	-	-	-
03 02 02*	Komponime organike të kloruara që përdoren për konservimin e drurit	-	-	-

03 02 03*	Komponime organometalike që përdoren për konservimin e drurit	-	-	-
03 02 04*	Komponime inorganike që përdoren për konservimin e drurit	-	-	-
03 02 05*	Komponime të tjera që përdoren për konservimin e drurit që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
<b>Mbeturinat nga përpunimi i drurit, paneleve, mobileve, pulpës, letrës dhe kartonit</b>		-	<b>650 t</b>	<b>650 t</b>

#### 4.4 Mbeturinat nga lëkura, gëzofi dhe industrinë e tekstilit

Në tabelën në vijim janë paraqitur Mbeturinat e rrezikshme nga lëkura, gëzofi dhe industria e tekstilit 04 së bashku me hyrjet katër dhe gjshtëshifrore. Siq mundë të shihet nga tabela paraqiten dy hyrje katër shifrore të mbeturinave 04 01 Mbeturinat nga industria e lëkurës dhe gëzofit dhe 04 02 Mbeturinat nga industria e tekstilit me tre hyrje të rrezikshme gjashtë shifrore.

Tabela Nr. 19: Mbeturinat e rrezikshme nga përpunimi i drurit, paneleve, mobileve, pulpës, letrës dhe kartonit		
Kodi	Emërtimi i kategorisë	Lloji i hyrjes
04 01	Mbeturinat nga industria e lëkurës dhe gëzofit	-
04 01 03*	Mbeturinat nga heqja e yndyrës që përmbajnë tretës pa fazë të lëngët	PRr
04 02	Mbeturinat nga industria e tekstilit	-
04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	PRr
04 02 16*	Lëndët për ngjyrosje dhe pigmentet që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
03 02 19*	Llumrat nga rrjedhja në vendet e trajtimit që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr

##### 4.4.1 Kimikatet dhe mbeturinat e rrezikshme nga industria e lëkurës dhe gëzofit

Përpunimi i lëkurës është një proces kimik që konverton lëkurat e përpunuara të kafshëve në lëkurë të përpunuar që nuk kalbet, rezistente ndaj lagështisë, të buta dhe të qëndrueshme. Përpunimi i lëkurës nënkupton reagimin e fibrave të kolagjenit në lëkurë me tanin, krom, dhe agjentë të tjerë kimik. Kromi trivalent (Trivalent chromium) është agjenti me përdorimin më të gjerë në përpunimin e lëkurës. Formaldehidi, glutaraldehidi dhe vajrat e rëndë janë agjentë tjerë të tjerë të përdorur për këtë qëllim.

Procesi teknologjik i përpunimit të lëkurës bëhet mbi bazën vegjetale dhe të kromit. Në procesin vegjetal lëkurat fillimisht zhyten në ujë për të hequr kripën dhe për të rikthyer lagështinë e humbur. Pastaj indet e tepërta largohen, prej lëkurës si dhe bëhet ropja e leshit dhe qimeve përmes gëlqeres apo procesit termik oksiduese dhe kimik dhe mëpastaj lëkurat presohen në makina. Në vijim zhvillohet procesi i eliminimit të gëlqeres përmes agjentëve vegjetativ që zgjat përreth tre javë.

Procesi i përpunimit në bazë të kromit rezulton në produkt me cilësi më të lartë si dhe procesi teknologjik është më i shkurtër, më efikas dhe me kosto më të ulët. Procesi i parapërgaditjes së lëkurës është identik me procesin vegjetativ me dallim në fazën finale të përpunimit. Lëkura e konservuar me pH 3 trajtohet me kripë të kromit trevalent për të ngritur pH-shin deri në vlerën 8. Lëkura pastaj lyhet me yndyra të rënda për të rikthyer vajrat e humbura gjatë procesit të trajtimit.

Procesi i paratrajtimit është përgjegjës për rreth 40% të vëllimit të ujërave të zeza. Mbeturinat e paratrajtimit kanë një pH të lartë 10-12 dhe përmbajnë sasi të larta të proteinave, sulfideve, azotit, Kërkesave biologjike për oksigjen BOD dhe total grimcave të pezulluara TSS. Hapi i konservimit gjeneron mbeturina acidike (pH 2.5–3.5) që përmbajnë kripëra dhe nivelet toksike të larta të kromit trivalent dhe të kërkesave kimike për oksigjen COD nga përqendrime të larta të amoniakut apo fenolit nëse njëra apo dyjat janë përdorur gjatë procesit. Hapi i përpunimit final të lëkurës kontribuon në nivele më të larta të COD për shkak të futjes së ngjyrave organike, vajrave të rënda, pigmenteve dhe lyerjes.

Nga 1 ton lëkurë të papërpunuar, gjenerohen afërsisht 850 kg mbeturina të ngurta në përpunimin e lëkurës ndërsa vetëm 150 Kg të lëndës së parë shndërrohen në lëkurë.

Kompozicioni i mbeturinave është sa vijon:




- Mishëra: 56-60%
- Rruajtje kromi, copëza kromi dhe pluhur: 35-40%
- Copëza të prera të lëkurës: 5-7%
- Leshëra dhe qime: 2-5%

Gjatë procesit të përpunimit të paktën 300 kg kimikate (gëlqere, kripë etj) dhe agjentëve tjerë aplikohen për ton lëkure të papërpunuar. Teprica e kripërave të papërdorura do të shfaqen në ujërat e zeza. Qdo hap i procesit të përpunimit, me përjashtim të operacioneve finale, prodhon ujërat e zeza. Mesatarisht 35 m<sup>3</sup> të ujërave të zeza prodhohet për ton lëkure të papërpunuar. Ujërat e zeza përbëhen nga përqendrimi i lartë i kripërave, kromit, amoniakut, ngjyrave dhe tretësve organik.












Procesi që më së shumti shkakton mbeturina të rrezikshme ka të bëjë me heqjen e yndyrave respektivisht shkrirjen e dhjamt nga lëkura e papërpunuar duke përdorë tretës organik të cilët shmangin nevojën për ngritjen e temperaturës. Tretësirat më të përdorura për largimin e yndyrave janë parafina, shpirtusi, butil oksitoli, etil oksitoli, klorur natriumi, perchloroethene, trekloretileni TCE, perkloretileni PCE, mono-klor-benzeni dhe perkloro-benzeni. Rrezikshmëria e kimikateve është paraqitur në tabelën e mëposhtme duke iu referuar listës së harmonizuar të ECHA.

Në përgjithësi 5-10% të mbeturinave në procesin e përpunimit të lëkurës paraqesin mbeturina të rrezikshme.

**Tabela Nr. 20: Klasifikimi dhe etiketimi i kimikateve të rrezikshme në përpunimin e lëkurës nga lsh kombinati i lëkurë këpucëve Pejë**

Kodi nga katalogu i mbeturinave	Emërtimi i mbeturinave sipas katalogut	Informacion mbi sasinë e mbeturinave		Informacion mbi përbërësit kimik të mbeturinës						
		Gjendja në fillim të vitit raportues (t)	Sasia e krijuara në vitin raportues (t)	Gjendja në fund të vitit raportues (t)	Emërtimi i kimikatit	Identifikuesit nga lista e harmonizuar		Klasifikimi dhe etiketimi i kimikatit		
						EC No.	Cas No.	Index No.	Klasa e rrezikut dhe kodet e kategorisë	Kodet apo shenjat e piktogrameve të rrezikut
04 01 03*	Mbeturinat nga heqja e yndyrërave që përmbajnë tretës pa fazë të lëngët	200Kg	0kg	200Kg	Sodium bicarbonate	207-838-8	497-19-8	011-005-00-2	Eye Irrit. 2 H319 GHS07 Ëng	
04 01 03*	Mbeturinat nga heqja e yndyrërave që përmbajnë tretës pa fazë të lëngët	25Kg	0kg	25Kg	p-phenylenediamine	203-404-7	106-50-3	612-028-00-6	Acute Tox. 3 * H301 Acute Tox. 3 * H311 Eye Irrit. 2 H319 Skin Sens. 1 H317 Acute Tox. 3 * H331 Aquatic Acute 1 H400 Aquatic Chronic 1 H410 GHS09 GHS06 Dgr	 

**Tabela Nr. 21: Klasifikimi dhe etiketimi i kimikateve të rrezikshme në përpunimin e lëkurës**

	EC List No.	CAS No.	Index No.	Hazard Class and Category Code(s)	Hazard Statement Code(s)	Pictograms, Signal	Pictograms
2-butoxyethanol	203-905-0	111-76-2	603-014-00-0	Acute Tox. 4 * Skin Irrit. 2 Eye Irrit. 2 Acute Tox. 4 *	H302 H312 H315 H319 H332	GHS07 Wng	
2-ethoxyethanol	203-804-1	110-80-5	603-012-00-X	Flam. Liq. 3 Acute Tox. 4 Acute Tox. 3 Repr. 1B	H226 H302 H331 H360FD	GHS02 GHS08 GHS06 Dgr	  
Tetrachloroethylene	204-825-9	127-18-4	602-028-00-4	Carc. 2 Aquatic Chronic 2	H351 H411	GHS09 GHS08 Wng	 
Chlorobenzene	203-628-5	108-90-7	602-033-00-1	Iam. Liq. 3 Skin Irrit. 2 Acute Tox. 4 Aquatic Chronic 2	H226 H315 H332 H411	GHS02 GHS09 GHS07 Wng	  
Trichloroethylene	201-167-4	79-01-6	602-027-00-9	Skin Irrit. 2 Eye Irrit. 2 STOT SE 3 Muta. 2 Carc. 1B Aquatic Chronic 3	H315 H319 H336 H341 H350 H412	GHS08 GHS07 Dgr	 

#### 4.4.2 Mbeturinat e rrezikshme nga industria e tekstit

Industria e tekstit përfshin prodhimin e një game të gjerë të produkteve si tekstili për trikotazh, qilimat, fibrat industriale etj. Prodhimi i tekstit fillon me prodhimin e perit të papërpunuara nga, lënda natyrale (pambuku, leshi, mëndafshi), celuloza dhe sintetika. Fibrat e perit dërgohen pastaj në impijant ku kryhen operacionet e thurjes në material tekstili homogjen, ngjyrosjen, printimi i kallëpeve të ngjyrosura, përpunimi final i tekstit dhe fabrikimi i produktit.

Në nivel global sektori i industrisë së tekstit është një ndër ndotësit më të mëdhenj të ujit menjëher pas sektorit të bujqësisë. Më shumë se 3,600 ngjyra individuale dhe 8,000 kimikate përdoren në procese të ndryshme të prodhimit të tekstit duke përfshirë ngjyrosjen dhe shtypjen. Shumë prej këtyre kimikateve janë helmuese dhe dëmtojnë shëndetin e njeriut drejtpërdrejt ose indirekt si dhe mjedisin akuatik. Banka Botërore vlerëson se 17 deri në 20 % e ndotjes së ujit industrial vjen nga ngjyrosja e tekstit. Rreth 72 kimikate toksike janë identifikuar në ujë vetëm nga ngjyrosja e tekstit.

Sasi të mëdha uji janë të nevojshme për përpunimin e tekstit. Për finalizimin e një kg tekstili nevojiten 200 litra ujë, nga kjo sasi 16% konsumohet në ngjyrosje dhe 8% në shtypje dhe pjesa tjetër në përpunimin e tekstit. Harxhimi i ujit për ngjyrosje ndryshon nga 30 - 50 litra për kg tekstil në varësi të llojit të tekstit dhe ngjyrosjes së përdorur. Konsumi i përgjithshëm i ujit i ngjyrosjes së penjëve është rreth 60 litra për kg fije. Ngjyrosja kontribuon në 15% - 20% të rrjedhës totale të ujërave të ndotura. Uji është gjithashtu është i nevojshëm për të pastruar tekstin dhe fijet e lyera nga papastërtit e procesit. Uji përdoret gjithashtu për pastrimin e makinave ngjyrosëse dhe makinave tjera.

Kimikatet që më së shpeshti përdoren në industrinë e tekstit janë: Enzimet (për hidrolizë të celulozës), acidi acetik (neutralizimi i alkalinitetit dhe kontrolli i pH), detergjentet (largimi i papastërtive dhe vajrave minerale), agjentët anti-statik, zbardhuesit pluhur (agjent oksidues për ngjyrosjen e xhinseve), hiposulfit natriumi (për të neutralizuar zbardhuesin nga klori), hidroksid natriumi (për pastrim dhe ngjyrosje), sode e hirit (krijim i mjedisit bazik dhe zbërthimin e pigmenteve të ngjyrës), bikarbonat natriumi (për ngjyrosje dhe printim), kalium permanganati (për ngjyrosje të xhinseve), zbutës kationik, kripërat (shërim të molekulave të ngjyrës), peroksid hidrogjeni (për shtrirjen e ngjyrës); rrëshira (për zbutjen e tekstit), natrium metabisulfit (për eliminimin e permangant kaliumit), etj.

Mbeturinat nga industria e tekstit janë shumë diverse duke përfshirë ndërmjet tjerash vetë pjesë të tekstit dhe fibrave pastaj elastomereve dhe plastomereve, vajërave të dyllit, efluentëve dhe llumit.

Mbeturinat e rrezikshme përbëhen nga efluentët që përmbajnë tretës organik, dhe metale të rënda. Përveq papastërtive natyrale që hasen tek fibrat natyrale (leshi, pambuku dhe mëndafshi) ato përmbajnë edhe një spektër të gjerë të biocide të dëmshme të cilat gjatë shpërlarjes përfundojnë në efluate. Edhe fibrat sintetike gjatë prodhimit dhe trajtimit të tyre përmbajnë ndotës të shumtë organik disa prej tyre me veti bioakumuluese. Edhe proceset e përpunimit dhe ngjyrosjes së tekstit shoqërohen me ndotës të shumtë organik dhe joorganik një pjesë e të cilave qëndron në tekstil dhe pjesa tjetër përfundon në efluate.

Ndër ndotës organik më të përhapur janë: urea, amonjaku, sulfatet dhe sulfidet, poliakrilatet, glicerina, m-nitrobenzeni sulfonatet dhe amino derivativët e tij, alkooli polivinik, hidrokarbure alifatike, vajra minerale, komponime organike të halogjenizuara, esteret e acidit acetik, ketonet, tolueni, ksileni, etandioli, propandioli, etj. Nga metalet e rrezikshme të hasura në industrinë e tekstit përfshihen: Kadmiumi, kromi, bakri, zhiva, plumbi, zingu, arseni, nikli, mangani, argjendi dhe metale tjera. Substancat e hasuar në efluentët nga industria e tekstit bartin rreziqet kancerogjene, mutagjene dhe rreziqe tjera.







Në tabelën Nr. 22 është dhënë klasifikimi dhe etiketimi i kimikateve të rrezikshme të trashëguara nga ish kombinati i lëkurës në Pejë, ndërsa në tabelën N3. 23 kimikatet më të shpeshta që përmbahen nga mbeturinat e rrezikshme të përpunimit të lëkurës.

**Tabela Nr. 22: Klasifikimi dhe etiketimi i mbeturinave nga industria e tekstilit**

Numri rendor	Kodi nga katalogu i mbeturinave	Emërtimi i mbeturinave sipas katalogut	Informata mbi lokacionin e mbeturinës	Informacion mbi sasinë e mbeturinave			Informacion mbi përbërësit kimik të mbeturinës					
				Gjendja në fillim të vitit raportues (t)	Sasia e krijuara në vitin raportues (t)	Gjendja në fund të vitit raportues (t)	Emërtimi i kimikatit	Identifikuesit nga lista e harmonizuar			Klasifikimi dhe etiketimi i kimikatit	
								EC No.	Cas No.	Index No.	Klasa e rrezikut dhe kodet e kategorisë	Kodet apo shenjat e piktogrameve të rrezikut
1	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Ish Emin Duraku Gjakovë	50kg		50kg	Acetic acid	200-580-7	64-19-7	607-002-00-6	Flam. Liq. 3, Skin Corr. 1A	
2	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Ish Emin Duraku Gjakovë	100kg		100kg	Xylene	215-535-7	1330-20-7	601-022-00-9	Flam. Liq. 3, Acute Tox. 4 *, Skin Irrit. 2	
3	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Ish Emin Duraku Gjakovë	900kg		900kg	Hydrogen Peroxide	231-765-0	7722-84-1	008-003-00-9	Ox. Liq. 1, Acute Tox. 4 *, Skin Corr. 1A	
4	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Ish Emin Duraku Gjakovë	210kg		210kg	Propane	200-827-9	74-98-6	74-98-6	Press. Gas, Flam. Gas 1	
5	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Ish Emin Duraku Gjakovë	1250Kg		1250Kg	Sodium Hydroxide	215-185-5	1310-73-2	011-002-00-6	Skin Corr. 1A	
6	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Ish Emin Duraku Gjakovë	50Kg		50Kg	Sodium acid	NA	NA	NA	NA	NA
7	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Ish Emin Duraku Gjakovë	750Kg		750Kg	Sodium Hydrosulphite	231-890-0	7775-14-6	016-028-00-1	Self-heat. 1 H251 H251 EUH031 Acute Tox. 4 * H302	
8	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Ish Emin Duraku Gjakovë	750Kg		750Kg	Sodium Nitrite	231-555-9	7632-00-0	007-010-00-4	Ox. Sol. 3, Acute Tox. 3 * Aquatic Acute 1	

9	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Ish Emin Duraku Gjakovë	150Kg	150Kg	Sodium Acetate	204-823-8	127-09-3	NA	Eye Irrit. 2, Skin Irrit. 2, Acute Tox. 4	
10	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Ish Emin Duraku Gjakovë	50Kg	50Kg	Sodium Sulphite	231-821-4	7757-83-7	NA	Skin Corr. 1B, Acute Tox. 4, Skin Irrit. 2, Eye Irrit. 2	
11	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Ish Emin Duraku Gjakovë	10Kg	10Kg	Terpilolene	NA	NA	NA	NA	NA
12	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Ish Emin Duraku Gjakovë	2500L	2500L	Various Chemicals dyes	NA	NA	NA	NA	NA
14	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Sharrtex Dragash	10L	10L	Formic acid	200-579-1	64-18-6	607-001-00-0	Skin Corr. 1A	
15	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Sharrtex Dragash	10L	10L	Methanol	200-659-6	67-56-1	603-001-00-X	Flam. Liq. 2 H225, Acute Tox. 3 * H301, Acute Tox. 3 * H311, Acute Tox. 3 * H331, STOT SE 1 H370 **	
16	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Sharrtex Dragash	500Kg	500Kg	Sodium acetate	204-823-8	127-09-3	NA	Skin Irrit. 2, Eye Irrit. 2, Acute Tox. 4,	
17	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Sharrtex Dragash	500Kg	500Kg	Sodium sulfide	215-211-5	1313-82-2	016-009-00-8	Acute Tox. 4 *, Acute Tox. 3 *, Skin Corr. 1B, Aquatic Acute 1	
18	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Sharrtex Dragash	500Kg	500Kg	Ammonium sulfate	231-984-1	7783-20-2	NA	NA	NA
19	04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	Sharrtex Dragash	2000L	2000L	Acetic acid	200-580-7	64-19-7	607-002-00-6	Flam. Liq. 3, Skin Corr. 1A	

**Tabela Nr. 23: Klasifikimi dhe etiketimi i kimikateve që hasen në procesin e përpunimit të tekstilit**

	EC List No.	CAS No.	Index No.	Hazard Class and Category Code(s)	Hazard Statement Code(s)	Pictograms, Signal	Pictograms
Acetic acid	200-580-7	64-19-7	607-002-00-6	Flam. Liq. 3 Skin Corr. 1A	H226 H314	GHS07 GHS02 GHS05 Dgr	
Potassium permanganate	231-760-3	7722-64-7	025-002-00-9	Ox. Sol. 2 Acute Tox. 4 * Aquatic Acute 1 Aquatic Chronic 1 Repr. 2	H272 H302 H400 H410 H361d	GHS03 GHS09 GHS08 GHS07 Dgr	
Sodium Metabisulphite	231-673-0	7681-57-4	016-063-00-2	Acute Tox. 4 * Eye Dam. 1	H302 H318	GHS05 GHS07 Dgr	
Formaldehyde ...%	200-001-8	50-00-0	605-001-00-5	Acute Tox. 3 * Acute Tox. 3 * Skin Corr. 1B Skin Sens. 1 Acute Tox. 3 * Muta. 2 Carc. 1B	H301 H311 H314 H317 H331 H341 H350	GHS08 GHS05 GHS06 Dgr	
Dibutyl phthalate	201-557-4	84-74-2	607-318-00-4	Aquatic Acute 1 Repr. 1B	H400 H360Df	GHS09 GHS08 Dgr	
Hexabromocyclododecane	247-148-4	25637-99-4	602-109-00-4	Repr. 2 Lact.	H361 H362	GHS08 Ëng	

#### 4.4.3 Kuantifikimi i mbeturinavë të rrezikshme nga procesimi dhe konservimi i lëkurës dhe gëzofave

Në vitet e paraluftës ka funksionuar kombinati i lëkurë këpucëve në Pejë i cili ka trajtuar lëkurën dhe gëzofin por i cili është jashtë funksionit që nga paslufta. Në hapësirat e ish kombinatit ruhen disa kimikate të skaduara të cilat janë nevojitur për trajtimin e lëkurës.

Në Kosovë nuk është identifikuar ndonjë operator i cili proceson lëkurat dhe gëzofat. Lëkura importohet e procesuar dhe nuk konservohet në vend të paktën jo me shumicë. Poashtu edhe lëkurat nga kafshët e prera grumbullohen me shumicë dhe eksportohen jashtë vendit.

Tabela në vijim e nxjerrun nga të dhënat e DK ofron të dhënat e importit për lëkurat në sasi prej 48 ton dhe në vlerë monetare 492,789 €.

<b>Tabela Nr. 24: Importet e lëkurave të papërpunuara (përveçse gëzofeve) dhe lëkurave të përpunuara sipas DK për 2019</b>			
Kategoria	Sasia	Vlera €	Pesha kg
4107 Lëkurë e përpunuar më tej mbas rregjies apo tharjes, përfshirë lëkurën e veshur pergamene, të gjedheve (përfshirë dhe buajt) apo kuajve, pa qime, nëse është e ndarë apo jo, përveç lëkurës të Kreut 4114:	34,371.83	378,048.89	31,840.77
4107921000 - Lëkurë gjedhesh (duke përfshirë buajt)	20,243.76	242,299.49	19,231.15
4107919000 - Të tjera	294.49	5,806.28	247.00
4107911000 - Lëkurë putrash	0	1712.09	66.84
4107191000 - Sholle dhe lëkurë gjedhesh (duke përfshirë buajt) me një sipërfaqe që nuk i kalon 2,6 m <sup>2</sup>	6,399.80	51,904.02	4,694.51
4107129100 - Lëkurë gjedhesh (duke përfshirë buajt)	6,073.75	59,589.17	5,681.85
4107121900 - Të tjera	1,360.03	16,737.84	1,919.42
4113 Lëkurë e përpunuar me tej mbas rregjies apo tharjes, përfshirë lëkurën e veshur pergamene, të kafshëve të tjera, pa lesh ose qime, nëse është e ndarë apo jo, përveç lëkurës të Kreut 4114:	9,445.74	58,830.57	5,269.86
4113900000 - Të tjera	787.13	25,929.89	1,262.30
4113200000 - Të derrave	8,648.49	32,652.72	4,003.11
4113100000 - E dhive apo e kecave	10.12	247.96	4.45
4114 Lëkurë kamoshi (përfshirë kamoshin e kombinuar); lëkurët e ilustrura dhe lëkurët e ilustrura të laminuara; lëkurë e metalizuar:	6,780.59	47,374.44	7,821.22
4114200000 - Lëkurët e ilustrura dhe lëkurët e ilustrura të laminuara; lëkurë e metalizuar	6,070.59	43,704.44	6,151.22
4114109000 - Prej kafshëve të tjera	710.00	3,670.00	1,670.00
4115 Lëkurë e rindërtuar me bazë lëkure apo të fibrave të lëkurëve, në formë pllakash, fletësh apo shiritash, nëse janë apo jo në role; prerje dhe mbeturina të tjera prej lëkure apo prej lëkure të rindërtuar, të papërshtatshme për prodhimin e artikujve prej lëkure; pluhur, pudër dhe miell lëkure:	0	8535.18	3447.442
4115100000 - Lëkurë e rindërtuar me bazë lëkure apo të fibrave të lëkureve, në formë pllakash, fletash apo shiritash, nëse janë apo jo në role	0	8535.18	3447.442
<b>Total</b>	<b>50,598.16</b>	<b>492,789.08</b>	<b>48,379.29</b>

Prandaj duke iu referuar mungesës së aktiviteteve të procesimit të lëkurës dhe gëzofit për këtë cikël nuk është hapur provizion për mbeturina të rrezikshme nga kjo kategori! Në kalkulim janë përfshirë vetëm mbeturinat e rrezikshme nga "SWiss General Group Shpk"- Ish Kombinati i Lëkurës – Pejë.

Megjithatë ngelet tek ministria që në bashkëpunim me inspektoratin dhe institucionet tjera që të identifikoj nëse ka ndonjë operator të trajtimit dhe konservimit të lëkurës dhe gëzofave dhe që ti fusë në skemën e raportimit dhe rrjedhimisht në regjistrin e mbeturinave të rrezikshme.

Në Kosovë nuk është identifikuar ndonjë operator i cili prodhon tekstilin por vetën disa operator që përdorin tekstilin e importuar. Nga të dhënat e siguruar nga DK vlera e importuar e materialeve të ndryshme të tekstilit të prezantuara në tabelën e mëposhtme është në sasi 9.6 ton dhe në vlerë monetare prej 24.5 milion euro.

Tabela Nr. 25: Importet e materialeve të tekstilit		
Kategoria	Vlera e importit €	Pesha kg
50 Mëndafshi	11,505.9	1,099.1
52 Pambuku	3,766,440.2	1,078,723.1
56 Mbushje, shajak dhe pëlhura të paendura; fijet speciale; spango, kordone, litar dhe kablo dhe artikujt prej tyre	6,224,672.0	2,779,685.0
57 Qilimat dhe veshje të tjera të dyshemesë prej tekstili	9,715,266.8	4,380,725.7
58 Pëlhura speciale të endura; pëlhura tekstile me xhufka; tantellat; tapicerite; zburimet, q ndismat	1,711,102.4	429,874.2
59 Pëlhurat tekstile të ngopura, të veshura, të mbuluara apo të laminuara; artikujt tekstile të një lloji të përshtatshëm për përdorim industrial	3,150,129.7	1,014,455.6
<b>Total</b>	<b>24,579,369.9</b>	<b>9,684,657.0</b>

Në vitet e paraluftës ka funksionuar kombinati i tekstilit Emin Duraku në Gjakovë dhe Sharrtex në Dragash të cilat kanë prodhuar tekstilin por që të dyja janë jashtë funksionit që nga paslufta. Në hapësirat e këtyre dy ish kombinateve ruhen disa kimikate të skaduara të cilat janë nevojitur për prodhimin e tekstilit dhe këto kimikate janë klasifikuar në hyrjen 16 të mbeturinave si mbeturina të paspecifikuara.

Prandaj për këtë cikël nuk është hapur provizion për mbeturina të rrezikshme nga kjo kategori!

Megjithatë ngelet tek ministria që në bashkëpunim me inspektoratin dhe institucionet tjera që të identifikoj nëse ka ndonjë operator të prodhimit të tekstilit dhe që ti fusë në skemën e raportimit dhe rrjedhimisht në regjistrin e mbeturinave të rrezikshme.

Tabela Nr. 26: Mbeturinat e rrezikshme nga industria e lëkurës, gëzofit dhe tekstilit				
Kodi	Emërtimi	Sasia në fillim të vitit raportues	Sasia e mbeturinave e krijuar në 2019	Sasia e mbeturinave në fund të periudhës raportuese
<b>04 01</b>	<b>Mbeturinat nga industria e lëkurës dhe gëzofit</b>	0.25 ton	0 ton	0.25 ton
04 01 03*	Mbeturinat nga heqja e yndyrës që përmbajnë tretës pa fazë të lëngët	0.25 ton	0 ton	0.25 ton
04 01 03*	Karbonat natriumi	200 kg	0 ton	200 kg
04 01 03*	Futramine	50 kg	0 ton	50 kg
<b>04 02</b>	<b>Mbeturinat nga industria e tekstilit</b>	10.325 ton	0 ton	10.325 ton
04 02 14*	Mbeturinat nga procesi përfundimtar që përmbajnë tretës organik	7,825 ton	0 ton	7,825 ton
04 02 14*	Acid acetik - (E. Duraku Pejë)	50		50
04 02 14*	Acid acetik - (Sharrtex Dragash)	2000		2000
04 02 14*	Ksilen - (E. Duraku Pejë)	100		100
04 02 14*	Peroksid i hidrogjenit - (E. Duraku Pejë)	900		900
04 02 14*	Propan - (E. Duraku Pejë)	210		210
04 02 14*	Hidroksid natriumi - (E. Duraku Pejë)	1250		1250
04 02 14*	Acidi i natriumit - (E. Duraku Pejë)	50		50
04 02 14*	Hidro-sulfit i natriumit - (E. Duraku Pejë)	750		750
04 02 14*	Nitriti i natriumit - (E. Duraku Pejë)	750		750
04 02 14*	Acetate natriumi - (E. Duraku Pejë)	150		150

04 02 14*	Sulfati i natriumit - (E. Duraku Pejë)	50		50
04 02 14*	Terpinolene - (E. Duraku Pejë)	10		10
04 02 14*	Carbon tetrachlorid	30		30
04 02 14*	Aceton - (Sharrtex Dragash))	5		5
04 02 14*	Acid formik - (Sharrtex Dragash)	10		10
04 02 14*	Methanol - (Sharrtex Dragash)	10		10
04 02 14*	Acetat natriumi - (Sharrtex Dragash)	500		500
04 02 14*	Sulfidi i natriumit - (Sharrtex Dragash)	500		500
04 02 14*	Sulfat amoniumi - (Sharrtex Dragash)	500		500
04 02 16*	Lëndët për ngjyrosje dhe pigmentet që përmbajnë substanca të rrezikshme	2.5 ton	0 ton	2.5 ton
04 02 16*	Ngjyra të ndryshme kimikate	2,500 kg		2,500 kg
<b>Total mbeturina të rrezikshme nga industria e lëkurës, gëzofit dhe tekstilit</b>		<b>10.575 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>10.575 ton</b>

#### 4.5 Mbeturinat nga rafinimi i naftës nga pastrimi i gazit natyror dhe nga trajtime pirolotike të thëngjillit

Mbeturinat nga rafinimi i naftës nga pastrimi i gazit natyror dhe nga trajtime pirolotike të thëngjillit është kategoria e pestë e mbeturave me dy nënkategori 4 shifrore katërbëdhjetë nënkategori 6 shifrore prej të cilave 12 nënkategori janë me hyrje absolute.

Kategorizimi i mbeturinave është prezantuar në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr. 27: Mbeturinat nga rafinimi i naftës nga pastrimi i gazit natyror dhe nga trajtime pirolotike të thëngjillit		
Kodi	Emërtimi	Lloji hyrjes
<b>05 01</b>	<b>Mbeturina nga rafinimi i naftës</b>	<b>ARr</b>
05 01 02*	Llumrat nga shkripëzimi	ARr
05 01 03*	Llumrat nga fundi i rezervuarit	ARr
05 01 04*	Llumrat nga acidi alkilik	ARr
05 01 05*	Derdhjet e vajrave	ARr
05 01 06*	Llumrat nga mirëmbajtja e impianteve ose pajisjeve	ARr
05 01 07*	Acidet e katranit	ARr
05 01 08*	Katranet tjera	ARr
05 01 09*	Llumrat nga rrjedhja ne vendet e trajtimit që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
05 01 11*	Mbeturinat që vijnë nga pastrimi i lëndëve djegëse me baza( alkale)	ARr
05 01 12*	Vajrat që përmbajnë acide	ARr
05 01 15*	Argjila nga filtrat e hargjuar	ARr
<b>05 06</b>	<b>Mbeturinat nga përpunimi pirolitik i thëngjillit</b>	
05 06 01*	Acidet e katranit	ARr
05 06 03*	Katranet tjera	ARr
<b>05 07</b>	<b>Mbeturinat nga purifikimi (pastrimi) dhe transporti i gazit natyror</b>	
05 07 01*	Mbeturinat që përmbajnë merkur	PRr

##### 4.5.1.1 Kuantifikimi i mbeturinave nga rafinimi i naftës nga pastrimi i gazit natyror dhe nga trajtime pirolotike të thëngjillit

Nuk janë identifikuar këso lloj mbeturinash në Kosovë për vitin 2019. Megjithatë nëse ekzistojnë këso lloj operimesh atëherë duhen të raportohen mbeturinat e rrezikshme nga kjo kategori.

Tabela Nr. 28: Mbeturinat nga rafinimi i naftës nga pastrimi i gazit natyror dhe nga trajtime pirolotike të thëngjillit				
Kodi	Emërtimi	Sasia në fillim të vitit raportues	Sasia e mbeturinave e krijuar në 2019	Sasia e mbeturinave në fund të periudhës raportuese
<b>05 01</b>	<b>Mbeturina nga rafinimi i naftës</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>
05 01 02*	Llumrat nga shkripëzimi	-	-	-
05 01 03*	Llumrat nga fundi i rezervuarit	-	-	-
05 01 04*	Llumrat nga acidi alkilik	-	-	-
05 01 05*	Derdhjet e vajrave	-	-	-
05 01 06*	Llumrat nga mirëmbajtja e impianteve ose pajisjeve	-	-	-
05 01 07*	Acidet e katranit	-	-	-
05 01 08*	Katranet tjera	-	-	-
05 01 09*	Llumrat nga rrjedhja ne vendet e trajtimit që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-

05 01 11*	Mbeturinat që vijnë nga pastrimi i lëndëve djegëse me baza( alkale)	-	-	-
05 01 12*	Vajrat që përmbajnë acide	-	-	-
05 01 15*	Argjila nga filtrat e hargjuar	-	-	-
<b>05 06</b>	<b>Mbeturinat nga përpunimi pirolitik i thëngjillit</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>
05 06 01*	Acidet e katranit	-	-	-
05 06 03*	Katranet tjera	-	-	-
<b>05 07</b>	<b>Mbeturinat nga purifikimi (pastrimi) dhe transporti i gasit natyror</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>
05 07 01*	Mbeturinat që përmbajnë merkur	-	-	-
<b>Total mbeturina nga rafinimi i naftës nga pastrimi i gazit natyror dhe nga trajtime pirolotike të thëngjillit</b>		<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>

#### 4.6 Mbeturinat nga proceset kimike inorganike

Një nga kategoritë e mbeturinave me më së shumti hyrje është hyrja numër katër: „Mbeturinat nga proceset kimike organike“. Në këtë kategori të mbeturinave ekzistojnë dymbëdhjetë hyrje katër shifrore dhe tridhjetë e dy hyrje të rrezikshme gjashtë shifrore të prezantuara në tabelën në vijim:

Tabela Nr. 29: Mbeturinat e rrezikshme nga proceset kimike inorganike		
Kodi	Emërtimi	Lloji hyrjes
<b>06 01</b>	<b>Mbeturina nga PFSHP i acideve</b>	
06 01 01*	Acidi sulfurik dhe acidi sulfuror	ARr
06 01 02*	Acidi klorhidrik	ARr
06 01 03*	Acidi fluorhidrik	ARr
06 01 04*	Acidi fosforor dhe fosforik	ARr
06 01 05*	Acidi nitrik dhe acidi nitror	ARr
06 01 06*	Acide të tjera	ARr
<b>06 02</b>	<b>Mbeturina PFSHP i solucioneve alkaline</b>	
06 02 01*	Hidroksidi i kalciumit	ARr
06 02 02*	Hidroksidi i amonit	ARr
06 02 03*	Hidroksidi i natriumit dhe kaliumit	ARr
06 02 04*	Baza tjera	ARr
<b>06 03</b>	<b>Mbeturina PFSHP i kripërave dhe tretësirave të tyre dhe i oksideve metalike</b>	
06 03 11*	Kripërat dhe solucionet që përmbajnë cianide	PRr
06 02 13*	Kripëra të ngurta dhe tretësira që përmbajnë metale të rënda	PRr
06 02 15*	Okside metalike që përmbajnë metale të rënda	PRr
<b>06 04</b>	<b>Mbeturina që përmbajnë metale, ndryshe nga ato të përmendura në 06 03</b>	
06 04 03*	Mbeturinat që përmbajnë arsen	ARr
06 04 04*	Mbeturinat që përmbajnë merkur	ARr
06 04 05*	Mbeturinat që përmbajnë metale të tjera të rënda	ARr
<b>06 05</b>	<b>Mbeturina PFSHP i llumrave nga rrjedhja në vendet e trajtimit</b>	
06 05 02*	Llumrat nga rrjedhja në vendet e trajtimit që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
<b>06 06</b>	<b>Mbeturinat nga PFSHP të kimikateve të sulfurit, të proceseve të kimike të sulfurit dhe të proceseve të desulfurimit</b>	
06 06 02*	Mbeturinat që përmbajnë sulfide të rrezikshme	PRr
<b>06 07</b>	<b>Mbeturinat nga PFSHP të halogjeneve dhe proceseve kimike halogjene</b>	
06 07 01*	Mbeturinat që përmbajnë asbest nga elektroliza	ARr
06 07 02*	Karboni i aktivizuar nga prodhimi i klorit	ARr
06 07 03*	Llumra të sulfatit të bariumit që përmbajnë merkur	ARr
06 07 04*	Solucione dhe acide, p.sh. acide kontakti	ARr
<b>06 08</b>	<b>Mbeturinat nga PFSHP i silicit dhe derivative të silicit</b>	
06 08 02*	Mbeturina që përmbajnë silikone të rrezikshme	ARr
<b>06 09</b>	<b>Mbeturinat nga PFSHP i kimikateve të fosforit dhe të proceseve të kimitës së fosforit</b>	
06 09 03*	Mbeturinat e reaksioneve me bazë kalciumin që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme	ARr
<b>06 10</b>	<b>Mbeturinat nga PFSHP i kimikateve të azotit, nga proceset kimike të azotit dhe nga prodhimi i plehrave azotik</b>	
06 10 02*	Mbeturina që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
<b>06 11</b>	<b>Mbeturinat nga PFSHP i të paspecifikuara ndryshe</b>	

06 13 01*	Produkte inorganike për mbrojtjen e bimëve, konservues të drurit dhe biocide të tjera	ARr
06 13 02*	Karboni aktiv i harxhuar (përveç 06 07 02)	ARr
06 13 04*	Mbeturinat nga përpunimi i asbestit	ARr
06 13 05*	Bloza	ARr

Mbeturinat prej proceseve kimike inorganike gjenerohen nga një gamë të gjerë procesesh në të cilat kimikatet inorganike prodhohen, formulohen, furnizohen ose përdoren. Kimikatet inorganike përfshijn acide, baza, halogjene, kripëra, squfur, fosfor, kimikate azotike dhe pigmente dhe mjegulluesit. Është e vështirë në mos e pamundur të identifikohen të gjitha proceset në të cilat proceset kimike inorganike përdoren dhe prodhohen për shkak të shtrirjes së gjërë të tyre.

Në vijim janë adresuar mbeturinat sipas kategorive veq e veq.

#### 4.6.1 Mbeturinat e rrezikshme nga prodhimi formulimi shpërndarja dhe përdorimi PFSHP i acideve inorganike

**Acidi sulfurik:** ( $H_2SO_4$  ; EC / List no.: 231-639-5; CAS no.: 7664-93-9) është kimikati më i përhapur i përfituar nga squfuri, oksigjeni dhe uji përmes procesit të kontaktit konvencional ose procesit të lagësht. Vetë procesi i prodhimit të acidit nuk karakterizohet me gjenerimin e mbeturinave. Acidi sulfurik përdoret gjerësisht për prodhimin e plehruesve inorganik, detergjenteve, akumulatorët e veturave, ngjyrosjen e tekstileve, largimin e papasërtive nga nafta, kondicionimin e ujit, prodhimin e farmaceutikëve, letrës, eksplozivëve, etj.

Te prodhimi i fertilizuesve superfosfat kryesisht kemi emitime të gazrave si: florit dioksidit të sulfurit dhe amonjakut dhe mbeturinave të ngurta në formë piriti. Për industrinë e ujit dhe pastrimin e efluentëve, acidi sulfurik përdoret për rregullimin e PH. Poashtu acidi sulfurik përdoret për ngjyrosjen e tekstilit me PH të ulët si psh nga leshi i deleve. Acidi sulfurik përdoret edhe për prodhimin e acideve tjera si psh acidit nitrik duke e aplikuar atë në kripëra nitriti. Acidi sulfurik është një substancë e rrezikshme e cila mundë të shkaktoj dëmtime serioze të lëkurës dhe syve. Acidi sulfurik nuk klasifikohet si i rrezikshëm për mjedisin sipas kriterëve të Rregullores (KE) Nr. 1272/2008. Ekologjia - uji: I dëmshëm për krustaqe dhe peshq. Ndotës i ujërave nëntokësore. Ndotës i moderuar i ujit sipërfaqësor. Toksik ndaj planktonit.

**Acidi klorhidrik – HCl** EC / List no.: 933-977-; CAS no.- 7647-01-0: Acidi klorhidrik përfitohet duke tretur klorurin e hidrogjenit në ujë  $HCl + H_2O \rightarrow H_3O^+ + Cl^-$ . Zakonsiht prodhohet në koncentrimet 30-35%. Acidi klorhidrik ka një përdorim të gjerë në fusha të ndryshme si prodhimin e acidit fosforik, dioksidit të klorit, klorurit të amojakut, plehrave, ngjyrave, etj. Përdoret si një mineral i rafinimit në prodhimin e kallajit dhe tantalit, si një reagent laboratorit dhe si një agjent trajtues metali. Poashtu ai përdoret për të rregulluar nivelin e pH-së në pishinat, banjot, etj. Përdoret gjithashtu si vrasës i baktereve si fungicid, dhe virucid për dezinfektimin e hapësirave publike. Poashtu acidi përdoret për pastrimin e ndotjeve të rënda, heqjen e korrodimit nga metali, pastrimin e kalldajave, etj.

Acidi klorhidrik në mbeturinë konsiderohet si substancë e rrezikshme dhe duhet të trajtohet në përputhje me rregullat e sigurisë. Duhet të etiketohet siç duhet dhe depozitohet nga një kontraktues i mbeturinave të rrezikshme. Magazinimi duhet të jetë brenda një zonë e caktuar që është larg nga popullsia e përgjithshme e punëtorëve, dhe të mirë-shënuar, të ventiluar mirë dhe që nuk i nënshtrohen cikleve të nxehtësisë. Ndalohet që të derdhet acidi në kanalizim apo të derdhet në tokë. Informatat e rrezikshmërisë: Physical and Chemical Hazards Met. Corr. 1 - H290; Human health Skin Corr. 1A - H314; STOT SE 3 - H335; Environment Not classified.

**Acidi tjera të rrezikshme:** Mbeturinat e rrezikshme nga PFSHP i acideve tjera inorganike përfshijn acidin fluorhidrik, acidin fosforik dhe acidin nitrik.


#### 4.6.1.1 Kuantifikimi i mbeturinave të rrezikshme nga PFSHP i acideve inorganike

Acidi Sulfurik është prodhuar në ish kombinatin Trepça si pjesë e prodhimit të plehut artificial. Gjatë këtij procesi si mbeturinë reziduale është prodhuar piriti së bashku me metalet e rënda nga xehja sulfide si dhe metalet e rënda si kadmiumi, plumbi dhe mercuri. Këto reziduale janë hedhur në deponinë në parkun industrial mbeturinave së bashku me mbeturinat toksike nga prodhimi i baterive dhe kjo sasi vlerësohet të jetë rreth 1 milion ton. Prodhimi i acidit sulfurik është ndërpre pas luftës dhe së bashku me të prodhimit të mbeturinave nga acidi sulfurik.

Acidet tjera poashtu importohen kështuqë nuk ka mbeturina nga prodhimi i tyre dhe poashtu nuk ka mbeturina nga përdorimi i tyre. Vlera e importuar e acideve inorganike për 2019 ka qenë 1 milion € dhe me peshë prej 6,978 ton.

Tabela Nr. 30: Acidet inorganike të importuara			
Emërtimi i acidit inorganik	Emërtimi sipas IUPAC	Vlera e importit €	Pesha kg
2806 Acidi klorhidrik dhe klorosulfurik:		295,215.8	1,873,948.7
2932209000 - Të tjera	23,307.5	655.4
<b>2933 Përbërjet heterociklike vetëm me hetero-atome(t) e azotit</b>	<b>238,652.8</b>	<b>41,561.2</b>
2933119000 - Të tjera	90.0	2.0
2933210000 - Hidantoine dhe derivatet e tij	1,340.2	320.0
2933299000 - Të tjera	17,923.6	105.8
2933310000 - Piridini dhe kripërat e tij	12.8	1.0
2933391000 - Iproniazid (INN); ketobemidone hidrokloride (INNM); pyridostigmine bromide (INN)	326.0	0.1
2933399900 - Të tjera	13,544.2	65.3
2933540000 - Derivate të tjera të maloniurea (acid barbiturik); kripërat e tyre	138.1	0.2
2933599500 - Të tjera	99,980.1	416.3
2933998000 - Të tjera	105,297.8	40,650.6
<b>2934 Acidet nukleike dhe kripërat e tyre</b>	<b>15,164.1</b>	<b>1,871.5</b>

2934100000 - Përbërjet që përmbajnë një rreth tiazol të padjegshëm (nëse është apo jo e hidrogjenizuar) në strukture	259.4	0.2
2934208000 - Të tjera	457.7	0.3
2934309000 - Të tjera	90.6	0.2
2934996000 - Klorprotiksene (INN); thenalidine (INN) dhe tartratet dhe maleatet e tij; Furazolidone (INN); Acid 7 - Aminocefalosporanik; Kripërat dhe esteret e acidit (6R, 7R) - 3 - acetoksimetyl - 7 - [? - 2 - formyloksi - 2 - fenylacetamido] - 8 - okso -	176.1	0.0
2934999000 - Të tjera	14,180.3	1,870.8
<b>2935 Sulfonamidet</b>	<b>19,294.1</b>	<b>757.4</b>
2935909000 - Other	19,294.1	757.4
<b>XII. Glykocidet dhe alkaloidet, natyrale apo të riprodhuara nga sintezat, dhe kripërat, eteret, esteret dhe derivatet e tjera të tyre</b>	<b>19,124.0</b>	<b>1,385.9</b>
<b>2938 Glykosidet, natyrale apo të riprodhuara nga sintezat</b>	<b>1,805.1</b>	<b>160.0</b>
2938903000 - Acid glycyrrhizic dhe glycyrrhizatet	110.18	130.00
2938909000 - Të tjera	1,694.94	30.00
<b>2939 Alkaloidet, natyrale apo të riprodhuara nga sintezat, dhe kripërat, eteret, esteret dhe derivatet e tjera të tyre</b>	<b>17,318.9</b>	<b>1,225.9</b>
2939300000 - Kafeine dhe kripërat e tij	17,057.3	1,225.1
2939590000 - Të tjera	251.6	0.3
2939800000 - Te tjera	10.0	0.5
<b>XIII. Përbërje të tjera organike</b>	<b>19,529.4</b>	<b>1,448.2</b>
<b>2942 Përbërje të tjera organike</b>	<b>19,529.4</b>	<b>1,448.2</b>
2942000000 - Përbërje të tjera organike	19,529.4	1,448.2
<b>Total kimikate organike të importuara në 2019</b>	<b>7,203,260.1</b>	<b>5,595,583.2</b>

Sa i përket mbeturinave që krijohen nga PFSHP i kimikateve organike si plastikës, preparateve për mbrojtjen e bimëve, produkteve farmaceutike, vajrave, yndyrërave, sapunëve, detergjentëve, dezinfektuesve dhe kozmetikës, etj. në munges të të dhënave nuk jemi në pozitën të konstatojmë se a ka këso lloj mbeturina dhe eventualisht sa është sasia e tyre. Por ngelet tek ministria t'i identifikojnë operatorët që merren me PFSHP të kimikateve organike dhe t'i detyrojnë që ti raportojn mbeturinat e tyre dhe kimikatet e përdorura dhe ku do të identifikoheshin mbeturinat nga PFSHP i kimikateve organike.

Tabela Nr. 44: Mbeturinat e rrezikshme nga PFSHP i kimikateve të rrezikshme organike				
Lloji i kimikatit mbeturinë	Kategoria e mbeturinave	Sasia e krijuara në vitin raportues (t)	Gjendja në fund të vitit raportues (t)	Lloji i kimikatit mbeturinë
<b>07 01</b>	<b>Mbeturina nga PFSHP i kemikateve bazike organike</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>
07 01 01*	Lëngjet ujore për larje dhe lëngjet bazë/amë	-	-	-
07 01 03*	Tretësat organik halogjenik, lëngjet për larje dhe lëngjet bazë/amë	-	-	-
07 01 04*	Tretësat organik halogjenik, lëngjet për larje dhe lëngjet bazë/amë	-	-	-
07 01 07*	Fundërrina të halogjenuara dhe llumra nga reaksionet	-	-	-
07 01 08*	Fundërrina tjera dhe llumra nga reaksionet	-	-	-
07 01 09*	Shtresat e filtrave të halogjenuara dhe absorbuesit e shpenzuar	-	-	-
07 01 10*	Shtresat e filtrave tjerë dhe absorbuesit e shpenzuar	-	-	-
07 01 11*	Llumrat nga rrjedhja në vendin e trajtimit që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
<b>07 02</b>	<b>Mbeturina nga PFSHP i plastikave, gomave sintetike dhe fibrave që i prodhon njeriu</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>
07 02 01*	Lëngjet ujore për larje dhe lëngjet bazë/amë	-	-	-

07 02 03*	Tretësas organik të halogjenuar, lëngjet për larje dhe lëngjet bazë/amë	-	-	-
07 02 04*	Tretësas tjerë organik, lëngjet për larje dhe lëngjet bazë/amë	-	-	-
07 02 07*	Fundërrina të halogjenuara të distilimit dhe mbeturina të halogjenuara të reaksioneve	-	-	-
07 02 08*	Fundërrina tjera të distilimit dhe mbeturina tjera të reaksioneve	-	-	-
07 02 09*	Shtresat e filtrave të halogjenuara dhe absorbuesit e shpenzuar	-	-	-
07 02 10*	Shtresat e filtrave tjerë, absorbuesit e shpenzuar	-	-	-
07 02 11*	Llumrat nga rrjedhja në vendet e trajtimit që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
07 02 14*	Mbeturinat nga materialet shtesë që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
07 02 16*	Mbeturinat që përmbajnë silikone të rrezikshme	-	-	-
<b>07 03</b>	<b>Mbeturina nga PFSHP i ngjyrave organike dhe pigmenteve (përveç 06 11)</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>
07 03 01*	Lëngjet ujore për larje dhe lëngjet bazë/amë	-	-	-
07 03 03*	Tretësas organik të halogjenuar, lëngjet për larje dhe lëngjet bazë/amë	-	-	-
07 03 04*	Tretësas tjerë organik, lëngjet për larje dhe lëngjet bazë/amë	-	-	-
07 03 07*	Fundërrina të halogjenuara të distilimit dhe mbeturina të halogjenuara të reaksioneve	-	-	-
07 03 08*	Fundërrina tjera të distilimit dhe mbeturina tjera të reaksioneve	-	-	-
07 03 09*	Shtresat e filtrave halogjenor, absorbuesit e shpenzuar	-	-	-
07 03 10*	Shtresat e filtrave tjerë, absorbuesit e shpenzuar	-	-	-
07 03 11*	Llumra nga rrjedhjet në vendet e trajtimit që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
<b>07 04</b>	<b>Mbeturina nga PFSHP i produkteve organike për mbrojtjen e bimëve (përveç 02 01 08 dhe 02 01 09), agjentëve të ruajtjes (konservimit) të drurit (përveç 03 02) dhe biocideve tjera</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>
07 04 01*	Lëngjet ujore për larje dhe lëngjet bazë/amë	-	-	-
07 04 03*	Tretësas organik të halogjenuar, Lëngjet ujore për larje dhe lëngjet bazë/amë	-	-	-
07 04 04*	Tretësit tjerë organik, lëngjet ujore për larje dhe lëngjet bazë/amë	-	-	-
07 04 07*	Fundërrina të halogjenuara të distilimit dhe mbeturina të halogjenuara të reaksioneve	-	-	-
07 04 08*	Fundërrina tjera të distilimit dhe mbeturina tjera të reaksioneve	-	-	-
07 04 09*	Shtresat e filtrave të halogjenuar, absorbuesit e shpenzuar	-	-	-
07 04 10*	Shtresat e filtrave tjerë, absorbuesit e shpenzuar	-	-	-
07 04 11*	Llumrat nga rrjedhjet në vendet e trajtimit që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
07 04 13*	Mbeturina të ngurta që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
<b>07 05</b>	<b>Mbeturinat nga PFSHP i produkteve farmaceutike</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>
07 05 01*	Lëngjet ujore për larje dhe lëngjet bazë/amë	-	-	-
07 05 03*	Tretësas organik të halogjenuar, lëngjet për larje dhe lëngjet bazë/ amë	-	-	-
07 05 04*	Tretësit tjerë organik, lëngjet për larje dhe lëngjet bazë/amë	-	-	-
07 05 07*	Fundërrina të halogjenuara të distilimit dhe mbeturina të halogjenuara të reaksioneve	-	-	-
07 05 08*	Fundërrina tjera të distilimit dhe mbeturina tjera të reaksioneve	-	-	-
07 05 09*	Shtresat e filtrave të halogjenuar dhe absorbuesit e shpenzuar	-	-	-

07 05 10*	Shtresat e filtrave tjerë, absorbuesit e shpenzuar	-	-	-
07 05 11*	Llumrat nga rrjedhja në vendet e trajtimit që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
07 05 13*	Mbeturina të ngurta që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
<b>07 06</b>	<b>Mbeturinat nga PFSHP i vajrave, yndyrërave, sapunëve, detergjentëve, dezinfektuesve dhe kozmetikës</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>
07 06 01*	Lëngjet ujore për larje dhe lëngjet bazë/ amë	-	-	-
07 06 03*	Tretësat organik të halogjenuar, lëngjet për larje dhe lëngjet bazë/amë	-	-	-
07 06 04*	Tretësat tjerë organik, lëngjet për larje dhe lëngjet bazë/amë	-	-	-
07 06 07*	Fundërrina të halogjenuara të distilimit dhe mbeturina të halogjenuara të reaksioneve	-	-	-
07 06 08*	Fundërrina të tjera të distilimit dhe mbeturina të tjera të reaksioneve	-	-	-
07 06 09*	Shtresat e filtrave të halogjenuar, absorbuesit e shpenzuar	-	-	-
07 06 10*	Shtresat e filtrave tjerë, absorbuesit e shpenzuar	-	-	-
07 06 11*	Llumrat nga rrjedhja në vendet e trajtimit që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
<b>07 07</b>	<b>Mbeturinat nga PFSHP i i kemikateve specifike dhe produkteve kimike të pa specifikuar ndryshe</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>
07 07 01*	Lëngjet ujore për larje dhe lëngjet bazë/ amë	-	-	-
07 07 03*	Tretësat organik të halogjenuar, lëngjet për larje dhe lëngjet bazë amë	-	-	-
07 07 04*	Tretësat tjerë organik, lëngjet për larje dhe likuidet amë	-	-	-
07 07 07*	Fundërrina halogjenike dhe llumra nga reaksionet	-	-	-
07 07 08*	Fundërrina të tjera dhe llumra nga reaksionet	-	-	-
07 07 09*	Kallëpat e filterëve halogjenik, absorbuesit e harxhuar	-	-	-
07 07 10*	Kallëpat e filterëve tjerë, absorbuesit e harxhuar	-	-	-
07 07 11*	Llumrat nga rrjedhja në vendet e trajtimit që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
<b>Mbeturinat e rrezikshme nga PFSHP i kimikateve të rrezikshme organike</b>		<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>

#### 4.8 Mbeturinat nga (PFSHP) i ngjyrëve, ngjitësve, puthitësve dhe ngjyrave të shtypësve

Në tabelën në vijim janë dhënë hyrjet 4 dhe 6 shifrore për kategorinë 8 të mbeturinave të ashtuquajtur „Mbeturinat nga (PFSHP) i ngjyrëve, ngjitësve, puthitësve dhe ngjyrave të shtypësve“. Kjo kategori përmban 4 nënkategori dhe gjithësej 17 hyrje të rrezikshme gjashtëshifrore

Tabela Nr. 45: Mbeturinat nga (PFSHP) i veshjeve (ngjyrëve, llaqeve, ngjitësve), adhezivëve, puthitësve dhe ngjyrave të shtypësve		
Kodi	Emërtimi	Lloji hyrjes
<b>08 01</b>	<b>Mbeturinat nga PFSHP heqja e ngjyrave dhe llaqeve</b>	
08 01 11*	Mbeturinat e ngjyrëve dhe llaqeve që përmbajnë tretës organik ose substanca tjera të rrezikshme	PRr
08 01 13*	Llumrat nga ngjyrat apo llaqet që përmbajnë tretës organik ose substanca tjera të rrezikshme	PRr
08 01 15*	Llumrat ujore që përmbajnë ngjyra apo llaqe të cilët përmbajnë tretës apo substanca të tjera të rrezikshme	PRr
08 01 17*	Mbeturinat nga largimi i ngjyrave dhe llaqeve, që përmbajnë tretës organik apo substanca të tjera të rrezikshme	PRr
08 01 19*	Suspensionet ujore që përmbajnë ngjyra apo llaqe të cilët përmbajnë tretës organik apo substanca tjera të rrezikshme	PRr
08 01 21*	Mbeturina nga ngjyrat apo larguesit e llaqeve	PRr
<b>08 03</b>	<b>Mbeturinat nga PFSHP i ngjyrave të printimit</b>	
08 03 12*	Mbeturina të ngjyrave që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
08 03 14*	Llumrat e ngjyrave që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
08 03 16*	Mbeturina të tretësirave gërryese	ARr
08 03 17*	Mbeturinat nga ngjyra e printimit që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
08 03 19*	Vajrat disperse	ARr
<b>08 04</b>	<b>Mbeturina nga PFSHP i ngjitësve dhe puthitësve (përfshirë edhe produktet rezistuese nga uji)</b>	
08 04 09*	Mbeturinat nga ngjitësit dhe puthitësit që përmbajnë tretës organik apo substanca të tjera të rrezikshme	PRr
08 04 11*	Llumrat nga ngjitësit dhe puthitësit që përmbajnë tretës organik apo substanca tjera të rrezikshme	PRr
08 04 13*	Llumrat ujore që përmbajnë ngjitës apo puthitës që përmbajnë tretës organik apo substanca tjera të rrezikshme	PRr
08 04 15*	Mbeturinat e lëngëta ujore që përmbajnë ngjitës apo puthitës me tretës organik apo substanca tjera të rrezikshme	PRr
08 04 17*	Vajra rezinë	ARr
<b>08 05</b>	<b>Mbeturinat të paspecifikuara ndryshe në 08</b>	
08 05 01*	Mbeturinat e izocianateve	ARr

**08 01 Mbeturinat nga PFSHP dhe heqja e ngjyrëve dhe llaqeve:** Në këtë kategori përfshihen ngjrat ndryshe ato organiket të përfshira në nënakategorin 07 03 si dhe llaqet. Ngjyrat dhe llaqet shërbejnë për dekorim dhe mbrojtje për objektet në të cilat aplikohen. Ngjyra përbëhet prej pigmentit, lëndës ngjitëse dhe tretësit. Një shumicë e pigmenteve përfitohet nga katrani dhe distilatet e naftës. Tretësit organikë më të zakonshëm, që rrjedhin nga nafta, janë shpirtusi i përdorur në ngjura alkide, dhe terpentina minerale. Tretësirat organikë të tjerë përfshijnë alkanet (izoparafina), metil etil ketonet, përzierjet e metanolit dhe etanolit, ksilenin, toluenin dhe acetoinin. Ngjyrat përmbajnë poashtu aditive të caktuara psh biocidet për të parandaluar zhvillimin e këpurdhave, tharësve (kobalti, mangani, ceriumi, zirkoni dhe kalciumi) për katalizimin e oksidimit.

Në Kosovë janë identifikuar disa operator që merren me PFSHP dhe heqje të ngjyrave dhe llaqeve si Gemix, Start-X, Orbita colors, Ntp Oraca, OMC, German Color, Graniti, etj.

**08 03 Mbeturinat nga PFSHP i ngjyrave të printimit:** Më shumë se një milion fishekë boje dhe tonerë printimi të zbrazët hidhen çdo ditë në botë, dhe shumica e tyre përfundojnë në deponi për shkak të dështimit të grumbullimit të ndarë. Fishekët e bojës mund të zgjasin diku midis 400 dhe 1000 vjet deri sa të dekompozohen në deponi. Jo të gjithë fishekët e bojës dhe tonerët e printimit konsiderohen si mbeturina të rrezikshme përveq në rastet kur ato përmbajnë pigmente me metale të rënda (të tilla si plumbi, kadiumi, ose kromi) ose përzihen me tretës organik që përmbajnë materiale të rrezikshme. Efluentët e ujërave të zeza nga procesi i prodhimit të ngjyrave të printimit janë të kontaminuara nga presenca e mineraleve organike dhe metaleve të rënda dhe si të tilla duhet të paratrajtohen para se të shkarkohen në kanalizimin publik. Poashtu deponitë sanitare nuk duhet të jenë destinacioni i duhur për deponimin e këtyre mbeturinave meqë këto mbeturina përmbajnë substanca të rrezikshme të cilat nuk mundë ti pastroj procesi i trajtimit dhe kështu përfundojnë në ujërat kulluese dhe potencialisht e kontaminonë akuiferin dhe mjedisin e përrethëm.

**08 04 Mbeturinat nga PFSHP i ngjitësve dhe puthitësve (përfshirë edhe produktet rezistuese nga uji):** Ngjitësit dhe puthitësit kanë një përdorim të gjerë në ndërtimtari, industri, teknologji, prodhim mobiljesh, prodhim këpucëve, stomatologji, e aplikime në shumë fusha tjera. Në përgjithësi adhezivët dhe puthitësit fitohen nga substanca inorganike dhe organike ndërsa shumica e adhezivëve dhe puthitësve nga polimeret kanë veti toksike për shëndetin dhe mjedisin. Ujërat e zeza nga impijantet që prodhojnë ngjitës dhe puthitës si shkuma poliuretani përmbajnë përzierje komplekse të kimikateve dhe polimereve të cilat duhen të paratrajtohen para se të shkarkohen në ujëra të zeza. Poashtu këto substanca kur të fitojnë statusin e mbeturinës nuk duhen të hidhen në deponitë për shkak të toksicitetit të tyre. Vajrat rezinë që i shtohen adhesivëve dhe puthitësve për arritjen e cilësive të tyre ngjitëse dhe izoluese janë sidomos të rrezikshme dhe mbeturinat e këtyre materialeve kanë hyrje absolute të rrezikshme dhe për këtë arsye meritojnë trajtim të veçantë. Shumica nga ngjitësit dhe puthitësit për shkak të përmajtësve organik mundë të ndizen aksidentalisht prandaj magazinimi dhe transporti i tyre i nënshtrohet kërkesave speciale.

*4.8.1.1 Kuantifikimi i mbeturinave të rrezikshme nga PFSHP i ngjyrëve, ngjitësve, puthitësve dhe ngjyrave të shtypësve*

Ekipi i projektit nuk ka mundur të identifikojë operator të PFSHP të ngjyrave, ngjitësve, puthitësve dhe ngjyrave të shtypësve dhe se shumica dërmuese e këtyre artikujve sigurohen nga importi të paraqitura në tabelën në vijim nr. 46.

<b>Tabela Nr. 46: Importet e ngjyrëve, ngjitësve, puthitësve dhe ngjyrave të shtypësve</b>		
<b>Kategoria</b>	<b>Vlera Mallrave</b>	<b>Netëeight</b>
<b>3201 Ekstraktet tanine me origjinë vegjetale; taninet dhe kripërat e tyre, eteret, esteret dhe derivatet e tjere:</b>	<b>3,268.8</b>	<b>1,360.0</b>
3201909000 - Të tjera	2,120.00	1,300.00
3201902000 - Ekstrakt valanidhi, ekstrakt vallonia, ekstrakt lisi apo ekstrakt gështenje	1,148.82	60.00
<b>3202 Substancat organike sintetike tanine; substancat inorganike tanine; preparatet tanine</b>	<b>32,249.3</b>	<b>10,852.6</b>
2942000000 - Përbërje të tjera organike	19,529.4	1,448.2
3202100000 - Substancat organike sintetike tanine	6,738.9	9,165.0
3202900000 - Të tjera	5,981.1	239.4
<b>3203 Lëndë ngjyrosëse me origjinë bimore apo shtazore përfshirë edhe ekstraktet ngjyrosëse</b>	<b>98,591.5</b>	<b>12,168.6</b>
3203001000 - Lëndë ngjyrosëse me origjinë bimore dhe preparatet e bazuara në to :	96,775.1	12,127.0
3203009000 - Lëndë ngjyrosëse me origjinë shtazore dhe preparatet e bazuara në to :	1,816.3	41.6

<b>3204 Lëndë ngjyrosëse organike sintetike; preparatet e bazuara në lëndë ngjyrosëse organike sintetike</b>	<b>505,044.8</b>	<b>131,498.2</b>
3204110000 - Ngjyruarit në tretësirë koloidale dhe preparatet e bazuara në to	25,852.4	3,131.4
3204120000 - Ngjyruarit acide, nëse janë apo jo të parametalizuara, dhe preparatet e bazuara në to; fiksuesit e ngjyrave dhe preparatet e bazuara në to	23,380.9	3,561.4
3204130000 - Ngjyruarit bazikë dhe preparatet e bazuara në to	261.6	0.2
3204140000 - Ngjyruarit direkt dhe preparatet e bazuara në to	5,091.7	1,976.0
3204160000 - Ngjyruarit reaktive dhe preparatet e bazuara në to	41,006.3	10,275.0
3204170000 - Pigmentet dhe preparatet e bazuara në to	297,872.7	61,998.1
3204190000 - Të tjera, përfshirë përzierjet e lëndëve ngjyruarë të dy apo më shumë nënkrahë Nr. 3204 11 deri 3204 19	107,784.0	50,405.8
3204900000 - Të tjera	3,795.2	150.4
<b>3205 Llaqet ngjyruarë; preparatet e bazuara në llaqet ngjyrosëse</b>	<b>10,486.6</b>	<b>712.6</b>
3205000000 - Llaqet ngjyruarë; preparatet e bazuara në llaqet ngjyrosëse siç janë të specifikuar në Shënimin 3 të këtij Kapitulli	10,486.6	712.6
<b>3206 Lëndë të tjera ngjyruarë; produktet inorganike të një lloji të përdorur si luminifore</b>	<b>1,637,266.8</b>	<b>723,110.2</b>
3206110000 - Që përmbajnë ndaj peshës 80% apo më shumë dioksid titaniumi të llogaritur mbi peshën e thatë	964,427.3	375,880.9
3206190000 - Të tjera	126,025.3	54,143.2
3206200000 - Pigmentet dhe preparatet e bazuara në përbërjet e kromit	1,018.7	559.0
3206410000 - Ultramarine dhe preparatet e bazuara në të	948.9	135.7
3206420000 - Lithopon dhe pigmente të tjera dhe preparatet e bazuara në sulfidin e zinkut	2,989.1	1,162.0
3206491000 - Magnetit	31,280.0	24,000.0
3206497000 - Të tjera	510,577.5	267,229.4
<b>3207 Pigmentet e përgatitura, preparatet opake të përgatitura dhe ngjyruarit e përgatitur, smaltat dhe glazurat e qelqëzuara, bojrat e glazurave, llustra të lëngshme dhe preparate të ngjashme</b>	<b>209,968.5</b>	<b>16,720.8</b>
3207100000 - Pigmente të përgatitura, preparatet opake të përgatitura dhe ngjyruarit e përgatitur dhe preparate të ngjashme	52,263.4	15,210.4
3207209000 - Të tjera	132,123.9	977.5
3207300000 - Llustra të lëngshme dhe preparate të ngjashme	1,394.8	42.0
3207404000 - Qelq, në formën e fetëzave me gjatësi prej 0,1 mm apo më shumë por jo më shumë se 3,5 mm dhe me trashësi prej 2 mikrometra apo më shumë por jo më shumë se 5 mikrometra; qelq, në formë pluhuri apo granulash, që përmban ndaj peshës 99% apo më shumë dio	205.0	189.0
3207408500 - Të tjera	23,981.4	301.9
<b>3208 Bojrat dhe llustrosesit bazuar në polimere sintetike apo polimere natyrale kimikisht të modifikuara</b>	<b>5,769,474.4</b>	<b>2,664,937.1</b>
3208101000 - Bojra dhe llustroses, me baze poliestere, në solucione siç janë përcaktuar në shënimin 4 të këtij kapitulli	210,098.4	157,216.4
3208109000 - Bojra dhe llustroses, me baze poliestere	753,681.8	298,062.2
3208201000 - Bojra dhe llustroses, me baze poliestere akrilik ose vinil, në solucione siç janë përcaktuar në shënimin 4 të këtij kapitulli	310,074.1	88,915.0
3208209000 - Bojra dhe llustroses, me baze poliestere akrilik ose vinil	1,069,128.8	647,103.5
3208901100 - Bojra dhe llustroses, të tjera (poliuretani prej 2,2? - (tert - butylimino)diolanoli dhe diizocianat 4,4? - metilendiciklohegzil, në formën e një solucioni në N,N -	8,908.6	5,725.0

dimetilacetamid, që përmban ndaj peshës 48% apo më shumë polimer		
3208901900 - Bojra dhe llustrueses te tjere ne solucione	1,142,504.7	529,802.7
3208909100 - Bojra dhe llustrueses te tjere, bazuar në polimer sintetik	1,687,206.5	630,080.8
3208909900 - Bojra dhe llustrueses te tjere, bazuar në polimer natyral kimikisht të modifikuar	587,871.6	308,031.6
<b>3209 Bojrat dhe llustruesit bazuar në polimeret sintetike apo në polimeret natyrale të modifikuara kimikisht</b>	<b>4,244,030.0</b>	<b>6,127,372.4</b>
3209100000 - Bojra dhe llustrues, bazuar në polimere akrilike apo vinil, tretur ne mjedis uJOR	2,146,274.7	2,926,015.8
3209900000 - Bojra dhe llustrues, bazuar në polimere ndryshe nga ato akrilike apo vinili, tretur ne mjedis uJOR	2,097,755.4	3,201,356.6
<b>3210 Bojra dhe llustrueses të tjerë përfshirë smaltrat, llaqet dhe distemperat</b>	<b>335,296.3</b>	<b>262,780.0</b>
3210001000 - Bojrat e vajit dhe llustruesit (përfshire smaltrat dhe llaqet)	52,890.9	18,576.8
3210009000 - Të tjera	282,405.4	244,203.3
<b>3211 Tharësit e përgatitur</b>	<b>195,046.8</b>	<b>65,388.2</b>
3211000000 - Tharësit e përgatitur	195,046.8	65,388.2
<b>3212 Pigmentet përfshirë pluhurat dhe fetezat metalike të shpërndara në një mjedis jo uJOR</b>	<b>251,063.6</b>	<b>52,539.5</b>
3212100000 - Krisafet stampuese	10,641.0	2,051.2
3212900000 - Pigmentet (përfshirë pluhurat dhe fetezat metalike) në formë të lëngët apo pastë, të një lloji të përdorur në prodhimin e bojrave; bojrat dhe lënde të tjera ngjyruese të vendosura në forma apo paketa për shitjen me pakicë	240,422.7	50,488.3
<b>3213 Bojëra për piktura artistike, të studenteve apo bojrat për table, modifikuesit e gradacionit të ngjyrave, ngjyrat për zbavitje</b>	<b>246,248.9</b>	<b>50,778.8</b>
3213100000 - Ngjyrosësit në komplete	104,997.2	30,113.6
3213900000 - Të tjera	141,251.8	20,665.2
<b>3214 Stuko xhami, stuko transplatuese, çimento resini, përbërjet stukuese dhe mastice të tjera; mbushjet që përdoren në piktura</b>	<b>19,120,465.1</b>	<b>61,498,818.0</b>
3214101000 - Stuko xhami, stuko transplatuese, çimento resini, përbërjet stukuese dhe mastice të tjera	4,992,020.0	2,269,219.9
3214109000 - Mbushje që përdoren në pikura	220,090.1	665,460.0
3214900000 - Preparate jo refraktare sipërfaqësore për fasada, mure të brendeshme, dysheme, tavane	13,908,355.0	58,564,138.2
<b>3215 Bojra shkrimi, bojrat shtypi dhe vizatimi dhe bojra të tjera</b>	<b>1,270,887.7</b>	<b>227,913.3</b>
3215110010 - Kartrigjat me ngjyre ( pa koke printuese te integruar) per tu vendosur ne aparaturat e nenkreteve 8443 31, 843 32 apo 843 39, dhe qe perfshin komponente mekanike po elektrike	32,864.8	469.6
3215110090 - Te tjera	135,762.3	31,284.4
3215190010 - Kartrigjat me ngjyre ( pa koke printuese te integruar) per tu vnedosur ne aparaturat e nenkreteve 8443 31, 843 32 apo 843 39, dhe qe perfshin komponente mekanike apo elektrike	39,423.7	836.1
3215190090 - Te tjera	847,237.2	169,681.9
3215902000 - Kartrigjat me ngjyre ( pa koke printuese te integruar) per tu vendosur ne aparaturat e nenkreteve 8443 31, 843 32 apo 843 39, dhe qe perfshin komponente mekanike apo elektrike; bojra te ngurta ne forma te projektuara per tu vendosur ne aparaturat e nenkreteve 8443 31, 843 32 apo 843 39.	62,392.6	415.6
3215907000 - Te tjera	153,207.1	25,225.8

<b>3809 Agjentet ilustrues, agjentet mbajtëset e bojës për të shpejtuar ngjyrosjen apo fiksimin e bojrave dhe produkte dhe preparate të tjera të një lloji përdorur në industrinë e tekstilit, të letrës, lëkurës apo në industri të ngjashme,</b>	<b>2,319,804.1</b>	<b>2,328,416.9</b>
3809101000 - Që përmbajnë ndaj peshës së substancave të tilla më pak se 55%	5,375.5	3,879.5
3809109000 - Që përmbajnë ndaj peshës së substancave të tilla 83% apo më shumë	2,310.5	1,617.5
3809910000 - Të një lloji të përdorur në industrinë e tekstilit dhe industrinë e ngjashme	2,305,326.1	2,319,787.6
3809920000 - Të një lloji të përdorur në industrinë e letrës apo industri të ngjashme	4,321.9	2,949.0
3809930000 - Të një lloji të përdorur në industrinë e lëkurës apo industri të ngjashme	2,470.2	183.3
<b>3814 Solventet dhe hollues me përbërje organike, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër; fshirësit e përgatitur të bojrave apo të llustruesve</b>	<b>694,999.63</b>	<b>544,995.29</b>
3814001000 - Solventet dhe hollues me përbërje organike, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër, bazuar në acetat butili	42,394.75	28,313.86
3814009000 - Solventet dhe hollues me përbërje organike, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër, jo të bazuar në acetat butili	652,604.88	516,681.43
<b>3824 Lidhësit e përgatitur për format apo kallëpet apo zemrat në fonderi; produktet kimike dhe preparatet kimike të industrive kimike apo të lidhjeve</b>	<b>7,250,401.3</b>	<b>47,622,056.0</b>
3824100000 - Lidhësit e përgatitur për format apo zemrat në fonderi	35,403.3	4,641.2
3824400000 - Shtesat e përgatitura për çimentot, llaçrat apo betonet	2,297,483.3	3,712,733.8
3824509000 - Llaçra jo refraktare	3,451,309.6	42,825,493.7
3824601900 - Sorbitol (ndryshe nga ai në nënkreun 290544) në solucion ujor, me mbi 2% D-manitol	740.4	1,200.0
3824782000 - Me përmbajtje vetëm të 1,1,1-tripfluoroetanit ,pentafluoroetanit dhe 1,1,1,2 tetra...	73,485.3	11,242.2
3824783000 - Me përmbajtje vetëm të difluorometanit dhe pentafluoroetanit	25,583.0	3,941.4
3824784000 - Me përmbajtje vetëm të difluorometanit, pentafluoroetanit dhe 1,1,1,2-tetrafluoroetanit	17,218.4	2,843.5
3824789000 - Të tjera	148,982.6	23,503.1
3824810000 - Përzirjet dhe përgatitjet që përmbajnë oksid të etilenit	2,326.1	256.0
3824840000 - Që përmbajnë aldrin (ISO), camphechlor (ISO) (toxaphene), chlordane (ISO), chlordecone (ISO), DDT (ISO) (clofenotane (INN), 1,1,1-trichloro-2,2-bis(pchlorophenyl) ethane), dieldrin (ISO, INN), endosulfan (ISO), endrin (ISO), heptachlor (ISO) apo mirex (ISO)	2,349.3	313.7
3824880000 - Që përmbajnë tetra-, penta-, hexa-, hepta- apo octabromodiphenyl ethers	1,608.6	400.0
3824910000 - Perzirjet dhe përgatitjet të perbera kryesisht prej (5-ethyl-2-methyl-2-oxido-1,3,2-dioxaphosphan-5-yl)methyl methyl methylphosphonate and bis[(5-ethyl-2-methyl-2-oxido-1,3,2-dioxaphosphan-5-yl)methyl] methylphosphonate	17,158.7	2,929.6
3824991000 - Sulfonatet e naftës, përjashtuar sulfonatet e vajrave të metaleve alkaline, të amonit apo të etanolaminave; acidet sulfonike të tiofenatuara prej vajrave të fituara nga mineralet bituminoze, dhe kriperat e tyre	237.3	27.8
3824991500 - Jon shkëmbyesit	138,291.7	225,458.0
3824992000 - Perzirjet gazthithëse për tubat në vakum	184.4	14.4
3824993000 - Acidet naftenike, kriperat e tyre të patretshme në ujë dhe esteret e tyre	302.5	500.0
3824994500 - Anti smercet dhe produkte të ngjashme	19,236.3	4,932.8
3824995000 - Preparatet për elektrogalvanizim	9,327.1	1,909.1
3824995500 - Perzirjet e mono , di , dhe tri , estereve acide yndyrore prej gliceroli (emulsues për yndyrat)	31,270.4	11,413.5
3824995600 - Që përmbajnë produkte të nënkreut 29397910	12,097.8	182.1
3824996400 - Të tjera	90,988.5	22,564.9

3824996500 - Produkte ndihmese per fonderite (pervec atyre qe klasifikohen brenda nenkreteut 3824 10 00 )	9,211.1	448.8
3824997000 - Preparate mbrojtese kunder zjarrit, kunder ujit dhe preparate te ngjashme perdorur ne industrine e ndertimeve	68,223.0	66,592.1
3824998500 - 3 (1 Etil 1 metilpropil)izoksazol 5 ilamin, ne formen e solucionit ne toluen	7,292.8	409.5
3824998600 - Perzierje kryesishte me permbajtje te dimethyl methylphosphonate, oxirane dhe diphosphorus pentaoxide	5,127.0	817.1
3824999200 - Ne gjendje te lenget ne 20 Å°C	97,448.8	43,589.4
3824999300 - Te tjera	380,502.8	300,717.8
3824999600 - Te tjera	307,011.2	352,980.6
<b>TOTAL:</b>	<b>44,194,594.1</b>	<b>122,342,418.5</b>

Sasi e mbeturinave nga kjo kategori krijohet në fazën e përdorimit qoftë si skadim i këtyre kimikateve ashtu edhe një pjese si rezidual gjatë përdorimit të tyre.

Për këtë cikël të kadastrit është paraparë që 20% e sasisë së importuar të konsiderohet si mbeturinë dmth 10% në emër të kimikateve të skaduara dhe 10% si mbeturina të përdorura. Sipas këtij kalkulimi del se sasia e mbeturinave për këtë kategori për 2019 është 24,684 ton.

Megjithatë me identifikimin e operatorëve që i përdorin këto kimikate dhe raportimit të tyre do të dihet sasia me saktë e mbeturinave të rrezikshme nga kjo kategori.

<b>Tabela Nr. 47: Sasia e Mbeturinave nga PFSHP dhe heqja e ngjyrave. ngjitësve, puthitësve dhe ngjyrave të shtypësve</b>				
Kodi	Lloji i kimikatit mbeturinë	Gjendja në fillim të vitit raportues (t)	Sasia e krijuara në vitin raportues (t)	Gjendja në fund të vitit raportues (t)
<b>08 01</b>	<b>Mbeturinat nga PFSHP heqja e ngjyrëve dhe llaqeve</b>	-	-	-
08 01 11*	Mbeturinat e ngjyrëve dhe llaqeve që përmbajnë tretës organik ose substanca tjera të rrezikshme	-	-	-
08 01 13*	Llumrat nga ngjyrat apo llaqet që përmbajnë tretës organik ose substanca tjera të rrezikshme	-	-	-
08 01 15*	Llumrat ujore që përmbajnë ngjyra apo llaqe të cilët përmbajnë tretës organik apo substanca të tjera të rrezikshme	-	-	-
08 01 17*	Mbeturinat nga largimi i ngjyrave dhe llaqeve, që përmbajnë tretës organik apo substanca të tjera të rrezikshme	-	-	-
08 01 19*	Suspensionet ujore që përmbajnë ngjyra apo llaqe të cilët përmbajnë tretës organik apo substanca tjera të rrezikshme	-	-	-
08 01 21*	Mbeturina nga ngjyrat apo larguesit e llaqeve	-	-	-
<b>08 03</b>	<b>Mbeturinat nga Prodhimi Formulimi, Shpërndarja dhe Përdorimi (PFSHP) i ngjyrave të printimit</b>	-	-	-
08 03 12*	Mbeturina të ngjyrave që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
08 03 14*	Llumrat e ngjyrave që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
08 03 16*	Mbeturina të tretësirave gërryese	-	-	-
08 03 17*	Mbeturinat nga ngjyra e printimit që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
08 03 19*	Vajrat disperse	-	-	-
<b>08 04</b>	<b>Mbeturina nga PFSHP i ngjitësve dhe puthitësve (përfshirë edhe produktet rezistuese nga uji)</b>	-	-	-
08 04 09*	Mbeturinat nga ngjitësit dhe puthitësit që përmbajnë tretës organik apo substanca të tjera të rrezikshme	-	-	-

08 04 11*	Llumrat nga ngjitësit dhe puthitësit që përmbajnë tretësa organik apo substanca tjera të rrezikshme	-	-	-
08 04 13*	Llumrat ujore që përmbajnë ngjitës apo puthitës që përmbajnë tretës organik apo substanca tjera të rrezikshme	-	-	-
08 04 15*	Mbeturinat e lëngëta ujore që përmbajnë ngjitës apo puthitës me tretësa organik apo substanca tjera të rrezikshme	-	-	-
08 04 17*	Vajra rezinë	-	-	-
<b>08 05</b>	<b>Mbeturinat të paspecifikuara ndryshe në 08</b>	-	-	-
08 05 01*	Mbeturinat e izocianateve	-	-	-
<b>Total importe të ngjyrëve, ngjitësve, puthitësve dhe ngjyrave të shtypësve</b>		-	<b>122,342 t</b>	-
<b>Total kimikate të skaduara 10% nga totali i përdoruar</b>		-	<b>12,234 t</b>	-
<b>Total mbeturina të përdorura 10% nga totali i përdoruar</b>		-	<b>12,234 t</b>	-
<b>Total mbeturina nga PFSHP dhe heqja e ngjyrëve, ngjitësve, puthitësve dhe ngjyrave të shtypësve</b>		-	<b>24,684 t</b>	-

#### 4.9 Mbeturinat nga industria fotografike

Mbeturina nga industria fotografike janë kategoria e nëntë sipas katalogut shtetëror të mbeturinave me një hyrje katër shifrore dhe gjithsej tetë nëkategorori 6 shifrore të rrezikshme të prezantara në tabelën në vijim nr. 48.

Tabela Nr. 48: Mbeturinat nga industria fotografike		
Kodi	Emërtimi	Lloji i hyrjes
<b>09 01</b>	<b>Mbeturinat nga PFSHP heqja e ngjyrëve dhe llaqeve</b>	
09 01 01*	Zhvilluesit që kanë për bazë ujin dhe tretësirat aktivizuese	ARr
09 01 02*	Tretësirat e zhvilluesit të diskut ofset që kanë për bazë ujin	ARr
09 01 03*	Tretësirat që kanë për bazë tretësit e zhvilluesit	ARr
09 01 04*	Tretësirat e fikserit	ARr
09 01 05*	Tretësirat për zbardhje dhe tretësirat për zbardhje të fikserit	ARr
09 01 06*	Mbeturinat që përmbajnë argjend nga vendi i trajtimit të mbeturinave fotografike	PRr
09 01 11*	Aparatet fotografuese me bateri për një përdorim të përfshira në: 16 06 01, 16 06 02 ose 16 06 03	ARr
09 01 13*	Mbeturinat e lëngëta ujore nga tharja në vendet e argjendit, tjera nga ato të përmendura në 09 01 06	ARr

Mbeturinat nga industria fotografike përmbajnë një larmi mbetjesh kimike shpesh me sfond të rrezikshëm që përfshijnë zhvilluesit, pllakat, dhe tretësirat. Kimikatet kryesore që hasen në mbeturinat fotografike janë komponimet e argjendit, amoniakut dhe sqfurit. Komponimet e argjendit grumbullohen në nënprodukte të ngurta (biosolide) nga impiantet e trajtimit të ujërave të zeza dhe mund të kufizojnë potencialin. Ato gjithashtu mund të kenë një efekt toksik në mjedis.

Synim është të minimizohet shkarkimi i argjendit në sistemin e ujërave të zeza. Meqenëse argjendi është një metal i çmuar, është gjithashtu në interesin e operatorëve të laboratorëve fotografikë të minimizojnë mbeturinat e tyre, dhe për këtë arsye të zvogëlojnë kostot e tyre kimike. Përbërjet e amoniakut dhe sqfurit, në kushte të caktuara, mund të prodhojnë gazra të dëmshëm ose substanca korozive në sistemin e ujërave të zeza që mund të jenë një rrezik për stafin ose të përshpejtojnë dëmtimin e gypave të ujërave të zeza.

Nuk ka informatë mbi sasinë e mbeturinave nga industria fotografike meqë një pjesë e madhe e këtyre mbeturinave bëhet nga përdorues individual që janë vështirë të identifikohen dhe të raportojnë mëpastaj. Megjithatë referencë do të bëhet nga vlera e importit të produkteve fotografike e cila është prezantuar në tabelën në vijim nga ku shihet se 70 ton është sasia e importit të këtyre produkteve dhe me vlerë afër 1 milion €.

Tabela Nr. 49: Importet nga industria fotografike		
Kategoria	Vlera Mallrave €	Pesha kg
<b>3701 Pllakat fotografike dhe filma jo në role prej çdo lloj materiali, të ndjeshëm dhe të paekspozuar, përveçse letrës, kartonit apo tekstileve; filma fotografike të menjëhershëm jo në role, të ndjeshme, të paekspozuar, nëse janë apo jo në paketa</b>	<b>505,031.1</b>	<b>29,067.6</b>
3701100010 - Për përdorime mjeksore, dentare apo veterinare	304,113.8	12,928.7
3701100090 - Të tjera	10,287.0	61.9
3701200000 - Filma të menjëhershëm	17,717.0	600.1
3701300000 - Pllaka dhe filma të tjere, me çdo anë jo më tepër se 255 mm	169,529.3	14,985.2
3701990000 - Të tjera	3,384.0	491.7
<b>3702 Filma fotografike në role, të ndjeshëm, të paekspozuara, prej çdo lloj materiali përveç letrës, kartonit apo tekstileve; filma fotografike të menjëhershëm në role, të ndjeshëm të paekspozuar</b>	<b>15,332.8</b>	<b>1,712.1</b>

3702430000 - Të një gjërësie më tepër se 610 mm dhe të një gjatësie jo më tepër se 200 m	3,597.6	48.0
3702440000 - Të një gjërësie më tepër se 105 mm por jo më tepër se 610 mm	2,398.4	32.0
3702540000 - Të një gjërësie më tepër se 16 mm por jo më tepër se 35 mm dhe të një gjatësie jo më tepër se 30 m, të tjera nga ato për diapozitive	9,336.8	1,632.1
<b>3703 Letër, karton dhe tekstil fotografik, të ndjeshme, të paeksponuara</b>	<b>62,860.0</b>	<b>18,131.2</b>
3703100000 - Në role të një gjërësie më tepër se 610 mm	93.6	3.0
3703200000 - Të tjera, për fotografi me ngjyra (polikrom)	29,802.8	3,098.5
3703900000 - Të tjera	32,963.6	15,029.7
<b>3704 Pllaka, filma, letër, karton dhe material tekstili fotografik, të ekspozuara por jo të zhvilluara</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>
<b>3705 Pllakat dhe filma fotografike, të ekspozuara dhe të zhvilluar, përveçse filmat kinematografike</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>
<b>3706 Filma kinematografike, të ekspozuara dhe të zhvilluara, nëse janë të ndërthurur apo jo me kotone zanore apo që konsistojnë vetëm në gjurmët e zërit:</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>
<b>3707 Preparatet kimike për përdorim fotografik</b>	<b>352,578.3</b>	<b>21,866.7</b>
3707100000 - Emulsionet e ndjeshme për përdorime në fotografi	3,010.1	214.0
3707902100 - Kartrigjat termoplastik apo elektrostatik të tonerve (pa pjese levizese) për tu vendosur në aparatet e enkrereve 8443 31, 8443 32 or 8443 39	153,558.8	3,836.9
3707902900 - Te tjera	143,932.5	11,354.2
3707909000 - Preparatet e tjera kimike për përdorime në fotografi	52,077.0	6,461.6
<b>TOTAL:</b>	<b>935,802.2</b>	<b>70,777.6</b>

Sasia e mbeturinave të rrezikshme e kësaj kategorie të mbeturinave llogaritet si 10% e aplikuar në sasinë e importuar respektivisht të përdorur. Nga kjo del se sasia e mbeturinave të rrezikshme nga industria fotografike është 7 ton/vjet.

Tabela Nr. 51: Mbeturinat nga industria fotografike				
Kodi	Lloji i kimikatit mbeturinë	Gjendja në fillim të vitit raportues (t)	Sasia e krijuara në vitin raportues (t)	Gjendja në fund të vitit raportues (t)
<b>09 01</b>	<b>Mbeturinat nga PFSHP heqja e ngjyrëve dhe llaqeve</b>	-	-	-
09 01 01*	Zhvilluesit që kanë për bazë ujën dhe tretësirat aktivizuese	-	-	-
09 01 02*	Tretësirat e zhvilluesit të diskut ofset që kanë për bazë ujën	-	-	-
09 01 03*	Tretësirat që kanë për bazë tretësit e zhvilluesit	-	-	-
09 01 04*	Tretësirat e fikserit	-	-	-
09 01 05*	Tretësirat për zbardhje dhe tretësirat për zbardhje të fikserit	-	-	-
09 01 06*	Mbeturinat që përmbajnë argjend nga vendi i trajtimit të mbeturinave fotografike	-	-	-
09 01 11*	Aparatet fotografuese me bateri për një përdorim të përfshira në: 16 06 01, 16 06 02 ose 16 06 03	-	-	-
09 01 13*	Mbeturinat e lëngëta ujore nga tharja në vendet e argjendit, tjera nga ato të përmendura në 09 01 06	-	-	-
	<b>Total sasia e përdorur e produkteve fotografike</b>	-	<b>70.7 ton</b>	-
	<b>Total mbeturina të rrezikshme nga industria fotografike</b>	-	<b>7 ton</b>	-

#### 4.10 Mbeturinat nga proceset termike

Mbeturinat nga proceset termike klasifikohet si kategoria e dhjetë në katalogun shtetëror të mbeturinave e cila përmban 14 nënkategori me hyrje katërshifrore dhe gjithsej 69 lloje të mbeturinave të rrezikshme me hyrje gjashtë shifrore të paraqitura si në tabelën në vijim:

Tabela Nr. 52: Mbeturinat nga proceset termike		
Kodi	Emërtimi	Lloji hyrjes
<b>10 01</b>	<b>Mbeturinat nga elekranat dhe impiantet tjera me djegie (përveç 19)</b>	
10 01 04*	Hiri nga djegia e hidrokarbureve dhe pluhuri i kaldajave	ARr
10 01 09*	Acidi sulfurik	ARr
10 01 13*	Hiri nga emulsionet e hidrokarbureve të përdorura si lëndë djegëse	ARr
10 01 14*	Hiri fundërrues, skorja dhe pluhur kaldajash si rezultat i bashkëdjegies që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 01 16*	Hiri nga bashkëdjegia, që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 01 18*	Mbeturinat nga pastrimi i gazit që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 01 20*	Llumrat nga trajtimi në vend i efluentëve që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 01 22*	Llumrat ujore nga pastrimi i kaldajave që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
<b>10 02</b>	<b>Mbeturinat nga industria e hekurit dhe çelikut</b>	
10 02 07*	Mbeturinat e ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 02 11*	Mbeturinat nga trajtimet e ujërave ftohës që përmbajnë vaj	PRr
10 02 13*	Llumrat dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
<b>10 03</b>	<b>Mbeturinat nga metalurgjia termike e aluminit</b>	
10 03 04*	Skorjet nga prodhimi primar	ARr
10 03 08*	Kriprat e skorjes nga prodhimi sekondar	ARr
10 03 09*	Mbeturina të zeza nga prodhimi sekondar	ARr
10 03 15*	Shkuma që janë të djegshme ose emetojnë, në kontakt me ujin, gazra të djegshme në sasi të rrezikshme	PRr
10 03 17*	Mbeturinat nga prodhimi i anodave që përmbajnë katran	ARr
10 03 19*	Pluhur nga tymi i oxhakut që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 03 21*	Grimca tjera të imëta dhe pluhur (përfshirë pluhurin e kushinetave të mullirit ) që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 03 23*	Mbeturinat e ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 03 25*	Llumrat dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 03 27*	Mbeturinat nga trajtimet e ujërave ftohës, që përmbajnë vajra	PRr
<b>10 04</b>	<b>Mbeturinat nga metalurgjia termike e plumbit</b>	
10 04 01*	Llumrat nga prodhimi primar dhe sekondar	ARr
10 04 02*	Shkuma nga prodhimi primar dhe sekondar	ARr
10 04 03*	Arsenati kalciumit	ARr
10 04 04*	Pluhuri nga gazi i oxhakut	ARr
10 04 05*	Grimcat tjera dhe pluhuri	ARr
10 04 06*	Mbeturinat e ngurta nga trajtimi i gazit	ARr
10 04 07*	Llumrat dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve	ARr
10 04 09*	Mbeturinat nga trajtimet e ujërave ftohës që përmbajnë vajra	PRr
<b>10 05</b>	<b>Mbeturinat nga metalurgjia termike e zinkut</b>	
10 05 03*	Pluhuri nga gazi i oxhakut	ARr
10 05 05*	Mbeturinat e ngurta nga trajtimi i gazit	ARr
10 05 06*	Llumrat dhe shtresat e filtrit nga trajtimi i gazit	ARr

10 05 08*	Mbeturinat nga trajtimet e ujërave ftohës, që përmbajnë vajra	PRr
10 05 10*	Zgjyra dhe shkuma që janë të djegshme, në rast kontakti me ujin emitojnë gaze të djegshme në sasi që paraqesin rrezik	PRr
<b>10 06</b>	<b>Mbeturinat nga metalurgjia termike e bakrit</b>	
10 06 03*	Pluhuri nga gazi i oxhakut	ARr
10 06 06*	Mbeturinat e ngurta nga përpunimi i gazit	ARr
10 06 07*	Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimi i gazit	ARr
10 06 09*	Mbeturinat nga trajtimet e ujërave ftohës, që përmbajnë vajra	PRr
<b>10 07</b>	<b>Mbeturinat nga metalurgjia termike të metaleve joferike</b>	
10 07 07*	Mbeturinat nga trajtimet e ujërave ftohës që përmbajnë vajra	PRr
<b>10 08</b>	<b>Mbeturinat nga metalurgjia termike të metaleve me ngjyrë</b>	
10 08 08*	Llumra të kripërave nga prodhimi primar dhe sekondar	ARr
10 08 10*	Zgjyra dhe shkuma që janë të djegshme në rast kontakti me ujin emitojnë gazra të djegshme në sasi që paraqesin rrezik	PRr
10 08 12*	Mbeturina nga prodhimi i anodave që përmbajnë zift	ARr
10 08 15*	Pluhur nga gazit i oxhakut që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 08 17*	Llumrat dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazit të oxhakut që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 08 19*	Mbeturinat nga trajtimet e ujërave ftohës, që përmbajnë vajra	PRr
<b>10 09</b>	<b>Mbeturinat nga derdhja e pjesëve të hekurit</b>	
10 09 05*	Bërthamat dhe kallëpat e derdhjeve të cilat nuk kanë pësuar derdhje që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 09 07*	Bërthamat dhe kallëpet e derdhjeve të cilat kanë pësuar derdhje që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 09 09*	Pluhur nga gazi i oxhakut që përmban substanca të rrezikshme	PRr
10 09 11*	Grimca të imëta që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 09 13*	Mbeturina të lidhjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
<b>10 10</b>	<b>Mbeturinat nga derdhjet e pjesëve të metaleve të ngjyrosura</b>	
10 10 05*	Bërthamat dhe kallëpat e derdhjeve të cilat nuk i janë nënshtruar derdhjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 10 07*	Bërthamat dhe kallëpet e derdhjeve të cilat nuk i janë nënshtruar derdhjeve që përmbajnë substancash të rrezikshme	PRr
10 10 09*	Pluhur nga gazi i oxhakut që përmban substanca të rrezikshme	PRr
10 10 11*	Grimca tjera të imëta që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 10 13*	Mbeturina të lidhjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
<b>10 11</b>	<b>Mbeturinat nga çelqi dhe produktet e çelqit</b>	
10 11 09*	Mbeturina të përzierjeve të përgatitura përpara përpunimit termik, që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 11 11*	Mbeturina qelqi në grimca të imëta dhe pudër qelqi që përmbajnë metale të rënda (nga tubat e rrezeve katodike)	PRr
10 11 13*	Llumra të lustrimit dhe bluarjes (grimcimit) të qelqit, që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 11 15*	Mbeturina të ngurta nga trajtimet e gazit të oxhakut, që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 11 17*	Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazit të oxhakut, që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
<b>10 12</b>	<b>Mbeturinat nga prodhimi i mallrave nga qeramika, tullat, tjegullat dhe produktet për ndertim</b>	
10 12 09*	Mbeturina të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
10 12 11*	Mbeturinat nga lustrimi që përmbajnë metale të rënda	PRr
<b>10 13</b>	<b>Mbeturinat nga prodhimi i çimentos, gëlqeres, allçisë si dhe artikujve dhe produkteve të bëra prej tyre</b>	
10 13 09*	Mbeturinat nga prodhimi i azbest çimentos që përmbajnë asbest	PRr
10 13 12*	Mbeturinat e ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
<b>10 14</b>	<b>Mbeturina nga krematoriumet</b>	

### **10 01 Mbeturinat nga elektranat dhe impiantet tjera me djegie (përveç 19):**

Proceset e gjenerimit të energjisë nga energjia termike përfshijnë djegien e thëngjillit, hidrokarbureve, gazit natyror dhe hidrokarbureve të emulsifikuara që përdoren për të ngrohur kalldajat përmes prodhimit të avullit të ujit në shtypje të lartë i cili rrjedh nëpër turbina duke lëvizur gjeneratorët dhe prodhuar energji. Avulli mëpastaj ftohet, kondensohet përsëri në ujë dhe kthehet në kazan për të filluar procesin. Impijantet e djegies përveq gjenerimit të energjisë aplikohen dhe për gjenerimin e avullit i cili përdoret nga ngrohtoret qendrore si dhe industritë e ushqimit, kimike, tekstilit etj.

Në këtë kategori paraqiten gjithsej 8 lloje mbeturina të rrezikshme nga të cilat 3 janë me hyrje absolute. Lloji më i përhapur i mbeturinave nga elektranat përfshin hirin nga djegia e lëndës së parë fosile dhe skorjen e kalldajave ndërsa mbeturinat e rrezikshme kanë të bëjnë me djegjen e hidrokarbureve qoftë në formë të vetme apo me bashkdjegje me karburantet tjera fosile.

Mbetjet nga djegia e thëngjillit nuk konsiderohen si të rrezikshme sipas katalogut të mbeturinave që hasen në termocentralet Kosova A dhe B.

Përveq hirit mbeturinat tjera të rrezikshme përfshijn acidin sulfurik i cili përdoret për kondicionimin e ujit industrial si dhe llumërave që vijnë nga trajtimi i efluentëve industrial dhe pastrimi i kalldajave në rastet kur janë djegur hidrokarburet apo hidrokarburet e emulsifikuara.

### **10 02 Mbeturinat nga industria e hekurit dhe çelikut:**

Industria e hekurit dhe çelikut është një nga sektorët më të rëndësishme të industrisë dhe në fakt paraqet një nga shtyllat e ekonomisë globale. Çeliku fitohet nga xehja e mineraleve të pasura me hekur si hematiti, magnetiti, limoniti dhe sideriti e cila thërmohet dhe dërgohet në shkretore ku hekuri i lëngshëm shndërrohet në çelik. Poashtu hekuri i lëngshëm fitohet duke shkrië çelikut e skrapit në furrë. Procesi sekondar i çelikut konsiston në rafinimin duke i shtuar çelikut aliazhe të caktuara dhe duke i hequr papastërtitë. Edhe pse mineralet e hekurit dhe procesi metalurgjik nuk karakterizohet me toksicitet sikur degët tjera të metalurgjisë, megjithatë procesi ka tre hyrje gjashtë shifrore të rrezikshme pasqyruese që ndërliken me gazrat që përmbajnë substanca të rrezikshme si SO<sub>x</sub>, NO<sub>x</sub>, CO, CO<sub>2</sub>, komponime organometalike, dibenzodioksinet -p- të poliklorinuar dhe dibenzofuranet (polychlorinated-p-and dibenzofurans - PCCD/Fs) si dhe trajtimin e ujit të përdorur për ftohje nëse për djegie janë përdorur hidrokarburet.

Nga ekipi i projektit nuk ka mundur të identifikohet industri metalurgjike të përpunimit të hekurit dhe çelikut në Kosovë e cila do të gjeneronte mbeturina të kësaj kategorie nga procesi i prodhimit.

### **10 03 Mbeturinat nga metalurgjia termike e aluminit:**

Industria e aluminit përfshin prodhimin parësor nga minierat e boksitit ashtu edhe prodhimi sekondar të aluminit nga skrapit. Prodhimi i aluminit parësor fillon me nxjerrjen e xehes së boksitit duke e shtypur dhe thërmuar më tej dhe duke tretur atë me një përzierje të hidroksidit të natriumit. Hapi i fundit është reduktimi elektrolitik i aluminit duke fituar aluminin e lëngshëm.

Mbeturinat nga metalurgjia termike e aluminit përmbajnë 11 lloje mbeturinash të rrezikshme me hyrje gjashtë shifrore, tre prej të cilave janë hyrje absolute. Skorjet së bashku me kriprat e tyre janë veqanërisht të rrezikshme meqë ato përmbajnë supstanca si oksid alumini, klorur natriumi, klorur kaliumi, karbide, nitride, sulfide dhe fosfide.

Nga ekipi i projektit nuk ka mundur të identifikohet industri metalurgjike të përpunimit të hekurit dhe çelikut në Kosovë e cila do të gjeneronte mbeturina të kësaj kategorie nga procesi i prodhimit.

#### **10 04 Mbeturinat nga metalurgjia termike e plumbit:**

Metalurgjia termike e plumbit aplikohet që të ndahet plumbi nga xehja duke aplikuar procesin termik në temperatura të larta. Koncentrati i xehes së plumbit pasi të i jetë nënshtruar proceseve fizike dhe fiziko-kimike dhe hidrometalurgjike dërgohet në shkritore. Faza e shkrijës përfshin heqjen e sulfurit nga xehja duke përdorur proces të djegies me ajër të nxehtë. Lëndët e para të para mund ti shtohen koncentratit përfshi hekurin, silicin, gëlqeren, koxsin, hirin, piritin, zinkun dhe sodën kaustike. Pasi të largohet sulfuri, plumbi dërgohet në shkritore ku nxehtet në temperatura jashtëzakonisht të larta. Plumbi i shkrijës përshkak të peshës specifike precipiton në fund të furrës. Metalet si arseniku dhe antimoni formojnë një shtresë të izoluar ndërsa shtresa tjetër përbëhet nga sulfati i bakrit dhe sulfatet e metaleve tjera. Këto dy shtresa largohen ndaras nga furra për përpunim të mëtejshëm. Skorja në furrë e cila përbëhet nga silici, gëlqerja dhe pjesërisht metale në përqindje më të ulët formon një shtresë të veçantë në furrë. Varësisht nga përmbajtja e metaleve skorja mund të i nënshtrohet procesit të rafinimit apo të deponohet si mbeturinë e procesit.

Pluhuri dhe tymi i plumbit emetohen gjatë të gjitha proceseve të mësipërme, së bashku me skorjen e kontaminuar me grimcat e plumbit. Shkrijja sekondare e plumbit është e ngjashme me shkrijën primare, por në vend të koncentratit nga xehja përdoret plumbi nga materialet e përdorura si baterive me acid plumbi, mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike MPEE të cilat - vendosen në furrë ku nxehen me koks ose qymyr në mënyrë që të izolohet plumbi nga komponimet e tjera. Ashtu si shkrijja kryesore e plumbit, përpunimi i plumbit sekondar gjithashtu mund të prodhojë pluhur plumbi dhe skorje toksike. Nëse shkrijja dhe pajisjet e shkrijës nuk janë ndërtuar siç duhet për të minimizuar emitimin e ndotësve, toksinat e plumbit shpesh mund të depërtojnë në mjedisin përreth dhe të kontaminojnë tokën, ujën dhe ushqimin.

Në Kosovë nuk ka industri metalurgjike të përpunimit të plumbit e cila do të gjeneronte mbeturina në formë skorje nga procesi termik. Shkrijja e plumbit dhe e zinkut në Zveçan është nxjerrun nga përdorimi në vitin 2000 dhe e cila i ka krijuar mbeturinat që janë deponuar në deponinë e afërme në Zveçan.

#### **10 05 Mbeturinat nga metalurgjia termike e zinkut:**

Procesi i rafinimit pirometalurgjik të zinkut kalon nëpër katër faza; pjekja, kullimi, pastrimi dhe elektrodepozitimi. Kalcifikimi, ose pjekja, me temperatura (700°C deri 1000°C) konverton koncentratin e sulfurit të zinkut në një oksid të papastër të zinkut të quajtur kalcinë. Në përgjithësi, pjekja fillon me përzierjen e koncentratit të zinkut me qymyr për të avulluar oksidin e zinkut, i cili largohet nga dhoma e reaktorit dhe bllokohet nga filtrat. Procesi i kalcinimit gjeneron dioksid të sulfurit, i cili shndërrohet në acid sulfurik. Kalcina e desulfurizuar kalon tre hapa dmth: kullimin, pastrimin dhe elektrolizën. Kullimi i referohet tretjes së kalcinës në acidin sulfurik për të formuar sulfatin e zinkut. Gjatë kullimit bëhet edhe për largimin nga tretja e shumë papastërtive të hekurit dhe vetë zinkut. Pas kullimit, tretësira pastrohet duke shtuar pluhur zinku i cili ndihmon papastërtitë të precipitojnë dhe filtrohen. Pastrimi zakonisht kryhet në rezervuarë të mëdhenj në temperatura 40 deri në 85°C dhe presione deri në 2.4 atmosfera. Elementet e izoluar gjatë pastrimit përfshijnë bakrin dhe kadmiumin. Pas pastrimit, tretja e zinkut i nënshtrohet hapit përfundimtar të elektrodepozitimit i cili zhvillohet në një qelizë elektrolitike dhe përfshin drejtimin e rrymës elektrike nga një anodë prej plumbit dhe argjendit. Ky proces e detyron zinkun të depozitohet në një katodë alumini e cila është e zhytur në tretje. Katodat e veshura nga zinku hiqen dhe shpëlahen, dhe zinku hiqet mekanikisht nga pllakat e aluminit. Koncentrati i zinkut pastaj shkrijëhet dhe hidhet në shufra dhe shpesh efikasiteti i pastrimit arrin deri 99,995%. Procesi i rafinimit pirometalurgjik të zinkut shoqërohet me emitim të gazrave të helmueshme si dioksid sulfurik dhe grimca pluhuri që përmbajnë zink dhe plumb. Poashtu edhe efluentët dhe llumërat përmbajnë acid sulfurik dhe metale të rënda si plumb, zink, bakër, argjent dhe kadmium dhe si të tilla janë shumë toksike.

Në Kosovë nuk ka industri metalurgjike të përpunimit të zinkut e cila për rrjedhojë do të gjeneronte mbeturina në formë skorje nga procesi termik.

Mbeturinat nga trajtimi fiziko-kimik i xeheve sulfide përmes procesit të flotacionit janë klasifikuar në kategorinë e parë.

#### **10 06 Mbeturinat nga metalurgjia termike e bakrit:**

Xehja e bakrit zakonisht përmban më pak se 1% bakër në formën e mineraleve sulfide. Xehja së pari grimcohet, hollohet me ujë, i shtohen reagentë kimikë dhe kompresohet me ajër. Flluskat e ajrit bashkohen me mineralet e bakrit dhe koncentrat i përmban midis 20 dhe 30% bakër. Mbeturinat e xeheve që fundërojnë largohen, kullohen, dendësohen dhe transportohen deri në deponi. Bakri mund të prodhohet në mënyrë pirometallurgjike ose hidometrike në varësi të llojit të xeheve. Xehet të cilat përmbajnë sulfide bakri dhe minerale të sulfurit të hekurit, trajtohen me procese pirometallurgjike për të dhënë produkte bakri me pastërti të lartë. Shndërrimi i bakrit nga xehja në metal bëhet përmes shkrirjes. Në furrë xehja sulfide thahet, oksidohet pjesërisht dhe shkrirë për të prodhuar një përzierje sulfide të bakrit dhe hekurit, dhe skorje. Skorja largohet nga furra dhe ruhet, shfrytëzohet ose hidhet në deponi. Dioksidi i sulfurit i cili gjenerohet në furrë mbledhet, pastrohet dhe shndërrohet në acid sulfurik për t'u shitur ose për t'u përdorur në operacionet e kullimit hidrometallurgjik. Gëlqerja dhe silici shtohen në koncentratin e bakrit për të reaguuar me oksidin e hekurit. Bakri i skrapit gjithashtu mund të shtohet në konvertues. Furra rrotullohet dhe ajri fryhet në koncentratin e shkrirë duke formuar oksidin e hekurit dhe dioksidin e sulfurit. Pastaj konverteri rrotullohet për të hedhur skorjen e silikatit të hekurit. Pasi të largohet i gjithë hekuri, i jepet një fryrje e dytë e ajrit gjatë së cilës pjesa tjetër e sulfurit oksidohet dhe hiqet nga sulfidi i bakrit. Konvertuesi rrotullohet më pas për të derdhur bakrin e shkrirë, Dioksidi i sulfurit nga konvertuesit grumbullohet dhe futet në sistemin e pastrimit të gazit së bashku me atë nga furra e shkrirjes. Për shkak të përmbajtjes së tij të mbetur të bakrit, skorja riciklohet përsëri në furrën e shkrirjes. Bakri i flluskës i prodhuar në këtë mënyrë përmban minimumin 98.5% bakër. Bakri i flluskës mundet të rafinohet tutje për të larguar papastërtit. Prosesi i rafinimit pirometallurgjik të bakrit shoqërohet me emitim të gazrave të helmueshme si dioksid sulfur dhe grimca pluhuri që përmbajnë zink dhe plumb. Poashtu edhe efluentët dhe llumërat përmbajnë acid sulfurik dhe metale të rënda si plumb, zink, bakër, argjent dhe kadmium dhe si të tilla janë shumë toksike.

Nga ekipi i projektit nuk ka mundur të identifikohet industri metalurgjike të përpunimit të bakrit në Kosovë e cila rrjedhimisht do të gjeneronte mbeturina të kësaj kategorie nga procesi i prodhimit.

#### **10 07 Mbeturinat nga metalurgjitë termike të metaleve joferike:**

Prodhimi i metaleve të çmuara nënkupton shkrirjen e koncentrateve të flotacionit nga xehet e sulfideve dhe heqjen e pjesës më të madhe të metaleve si bakri, kobalti, sulfuri dhe hekuri përmes kullimit me ose pa presion në një rafineri të metaleve bazë për të prodhuar një koncentrat të pasur me metale të çmuara. Një numër papastërtish, kryesisht seleni, teluri, arseniku, bizmuti, dhe plumbi, nuk hiqen ndjeshëm gjatë procesit të kullimit oksidues në praninë e acidit sulfurik. Për më tepër, përfshirjet e skorjeve në koncentrat çojnë në ndotje të metaleve të çmuara me mbeturina si silici, fajaliti, magnetiti dhe trevori. Përpunimi pirometallurgjik përfshin procesin shumëpjesësh të pjekjes, procesin e shkrirjes dy-hapëshe të kalcinës së pjekur dhe atomizimin pasues të lidhjes së shkrirë e cila mund të ushqehet si një hollim në reaktorët e tretjes me acid klorhidrik. Këto hapa pirometallurgjike përmirësojnë koncentrimin deri në një shkallë aliazhi të 90% të metaleve të çmuara. Mbeturinat e procesit të rafinimit prodhojnë ujëra të zeza dhe llumra si dhe skorje me prezencë të acideve dhe metaleve të rënda me një toksicitet të lartë.

Nga ekipi i projektit nuk ka mundur të identifikohet industri metalurgjike termike të metaleve joferike në Kosovë e cila rrjedhimisht do të gjeneronte mbeturina të kësaj kategorie nga procesi i prodhimit.

#### **10 08 Mbeturinat nga metalurgjia e metaleve me ngjyrë:**

Metalet me ngjyra përfshijnë aluminin, bronzin, bakrin, nikel, kallajin, plumbin dhe zinkun, si dhe metale të çmuara si ari dhe argjendi. Plumbi, zinku, bakri dhe metalet e çmuara janë

përmbajtur në nënkategoritë tjera. Në këtë kategori përfshihen mbeturinat e rrezikshme nga metalurgjia termike në formë të llumrave, zgjyrës, katranit, blözës dhe efluentëve.

Nga ekipi i projektit nuk ka mundur të identifikohet industri metalurgjike të përpunimit të metaleve me ngjyrët në Kosovë e cila rrjedhimisht do të gjeneronte mbeturina të kësaj kategorie nga procesi i prodhimit.

#### **10 09 Mbeturinat nga derdhja e pjesëve të hekurit:**

Derdhja e materialeve të hekurit të shkrirë realizohet në kallëpe dhe rërë. Në kallëp materialet metalike më të përdorura, të tilla si aliazhet e gizës dhe të hekurit, përfshirë gizën gri, hekurin duktil dhe çelikon. Gjatë këtij procesi, materiali i hekurt përmes trajtimit termik shkrihet dhe derdhet në kallëp me formë të paracaktuar dhe pastaj metali i derdhur ftohet dhe ngurtësohet. Disa procese mund të gjenerojn mbetje të rrezikshme. Gjatë prodhimit të hekurit duktil për të zvogëluar përmbajtjen e sulfurit të hekurit, disa shkritore përdorin desulfurizimin e karbidit të kalciumit. Skorja nga ky proces mund të shfaqë karakteristikën e reaktivitetit. Materialet e shkrira që përmbajnë sasi të konsiderueshme të metaleve të caktuara të rënda (si plumbi, kadiumi dhe kromi) mund të rezultojnë në mbeturina të cilat klasifikohen si të rrezikshme. Gjatë përpunimit të sipërfaqeve të brendëshme përdoren substanca acidike për pastrimin e gazrave. Llumrat nga ky proces i pastrimit mund të shfaqin karakteristikën korozive. Poashtu bloza nga tymtarët mund të përmbaj materiale të rrezikshme nga emetimi i gazrave.

Ky proces metalurgjik nuk zbatohet aktualisht në Kosovë dhe për rrjedhojë nuk gjenerohen këso lloj mbeturinash përfshi edhe mbeturina të rrezikshme.

#### **10 10 Mbeturinat nga derdhjet e pjesëve të metaleve të ngjyrosura:**

Derdhjet e pjesëve të metaleve të ngjyrosura përfshin përpunimin e metaleve të ngjyrosura si alumini, bakri, plumbi, nikeli, kallaji, titaniumi dhe zinku, dhe aliazhet si bronzi. Procesit teknologjik është i ngjashëm me materialet e hekuri vetëm se prezenca e metaleve të rënda rezulton në mbeturina të procesit me rrezikshmëri më të lartë.

Ky proces metalurgjik nuk zbatohet aktualisht në Kosovë dhe për rrjedhojë nuk gjenerohen këso lloj mbeturinash përfshi edhe mbeturina të rrezikshme.

##### *4.10.1.1 Kuantifikimi i mbeturinave nga proceset termike*

Në tabelën në vijim janë dhënë mbeturinat nga proceset termike. Në Kosovë ekzistojnë operatorë dhe disa tjerë janë jashtë operimit dhe që potencialisht kanë mundur të gjenerojn mbeturina të rrezikshme nga kjo kategori. Këtu mund të përfshihen termocentralet Kosova A dhe B, Feronikeli, Sharrcem si dhe shkritorja në Zveçan e cila është jashtë përdorimit.

Megjithatë operatorët në fjalë nuk kanë raportuar gjenerimin e këtyre mbeturinave dhe për rrjedhojë sasia e mbeturinave nga kjo kategori për 2019 është përvetësuar zero.

Për ciklet e ardhëshme raportuese ministria dhe inspektorati duhet të identifikojnë operatorët potencial që mund të gjenerojn mbeturina nga kjo kategori dhe të marrin raportet nga këta operator me mbeturina potenciale.

<b>Tabela Nr. 53: Mbeturinat e rrezikshme nga proceset termike</b>				
Kodi	Gjendja në fillim të vitit raportues (t)	Sasia e krijuara në vitin raportues (t)	Gjendja në fund të vitit raportues (t)	Gjendja në fillim të vitit raportues (t)
<b>10 01</b>	<b>Mbeturinat nga elektranat dhe impiantet tjera me djegie (përveç 19)</b>	-	-	-
10 01 04*	Hiri nga djegia e hidrokarbureve dhe pluhuri i kaldajave	-	-	-
10 01 09*	Acidi sulfurik	-	-	-
10 01 13*	Hiri nga emulsionet e hidrokarbureve të përdorura si lëndë djegëse	-	-	-

10 01 14*	Hiri fundërrues, skorja dhe pluhur kaldajash si rezultat i bashkëdjegies që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 01 16*	Hiri nga bashkëdjegia, që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 01 18*	Mbeturinat nga pastrimi i gazit që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 01 20*	Llumrat nga trajtimi në vend i efluentëve që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 01 22*	Llumrat ujore nga pastrimi i kaldajave që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
<b>10 02</b>	<b>Mbeturinat nga industria e hekurit dhe çelikut</b>	-	-	-
10 02 07*	Mbeturinat e ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 02 11*	Mbeturinat nga trajtimet e ujërave ftohës që përmbajnë vaj	-	-	-
10 02 13*	Llumrat dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
<b>10 03</b>	<b>Mbeturinat nga metalurgjia termike e aluminit</b>	-	-	-
10 03 04*	Skorjet nga prodhimi primar	-	-	-
10 03 08*	Kriprat e skorjes nga prodhimi sekondar	-	-	-
10 03 09*	Mbeturina të zeza nga prodhimi sekondar	-	-	-
10 03 15*	Shkuma që janë të djegshme ose emetojnë, në kontakt me ujin, gazra të djegshme në sasi të rrezikshme	-	-	-
10 03 17*	Mbeturinat nga prodhimi i anodave që përmbajnë katran	-	-	-
10 03 19*	Pluhur nga tymi i oxhakut që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 03 21*	Grimca tjera të imëta dhe pluhur (përfshirë pluhurin e kushinetave të mullirit ) që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 03 23*	Mbeturinat e ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 03 25*	Llumrat dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 03 27*	Mbeturinat nga trajtimet e ujërave ftohës, që përmbajnë vajra	-	-	-
<b>10 04</b>	<b>Mbeturinat nga metalurgjia termike e plumbit</b>	-	-	-
10 04 01*	Llumrat nga prodhimi primar dhe sekondar	-	-	-
10 04 02*	Shkuma nga prodhimi primar dhe sekondar	-	-	-
10 04 03*	Arsenati kalciumit	-	-	-
10 04 04*	Pluhuri nga gazi i oxhakut	-	-	-
10 04 05*	Grimcat tjera dhe pluhuri	-	-	-
10 04 06*	Mbeturinat e ngurta nga trajtimi i gazit	-	-	-
10 04 07*	Llumrat dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve	-	-	-
10 04 09*	Mbeturinat nga trajtimet e ujërave ftohës që përmbajnë vajra	-	-	-
<b>10 05</b>	<b>Mbeturinat nga metalurgjia termike e zinkut</b>	-	-	-
10 05 03*	Pluhuri nga gazi i oxhakut	-	-	-
10 05 05*	Mbeturinat e ngurta nga trajtimi i gazit	-	-	-
10 05 06*	Llumrat dhe shtresat e filtrit nga trajtimi i gazit	-	-	-
10 05 08*	Mbeturinat nga trajtimet e ujërave ftohës, që përmbajnë vajra	-	-	-
10 05 10*	Zgjyra dhe shkuma që janë të djegshme, në rast kontakti me ujin emitojnë gaze të djegshme në sasi që paraqesin rrezik	-	-	-
<b>10 06</b>	<b>Mbeturinat nga metalurgjia termike e bakrit</b>	-	-	-
10 06 03*	Pluhuri nga gazi i oxhakut	-	-	-
10 06 06*	Mbeturinat e ngurta nga përpunimi i gazit	-	-	-

10 06 07*	Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimi i gazit	-	-	-
10 06 09*	Mbeturinat nga trajtimet e ujërave ftohës, që përmbajnë vajra	-	-	-
<b>10 07</b>	<b>Mbeturinat nga metalurgjia termike të metaleve joferike</b>	-	-	-
10 07 07*	Mbeturinat nga trajtimet e ujërave ftohës që përmbajnë vajra	-	-	-
<b>10 08</b>	<b>Mbeturinat nga metalurgjia termike të metaleve me ngjyrë</b>	-	-	-
10 08 08*	Llumra të kripërave nga prodhimi primar dhe sekondar	-	-	-
10 08 10*	Zgjyra dhe shkuma që janë të djegshme në rast kontakti me ujin emitojnë gazra të djegshme në sasi që paraqesin rrezik	-	-	-
10 08 12*	Mbeturina nga prodhimi i anodave që përmbajnë zift	-	-	-
10 08 15*	Pluhur nga gazit i oxhakut që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 08 17*	Llumrat dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazit të oxhakut që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 08 19*	Mbeturinat nga trajtimet e ujërave ftohës, që përmbajnë vajra	-	-	-
<b>10 09</b>	<b>Mbeturinat nga derdhja e pjesëve të hekurit</b>	-	-	-
10 09 05*	Bërthamat dhe kallëpat e derdhjeve të cilat nuk kanë pësuar derdhje që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 09 07*	Bërthamat dhe kallëpet e derdhjeve të cilat kanë pësuar derdhje që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 09 09*	Pluhur nga gazi i oxhakut që përmban substanca të rrezikshme	-	-	-
10 09 11*	Grimca të imëta që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 09 13*	Mbeturina të lidhjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
<b>10 10</b>	<b>Mbeturinat nga derdhjet e pjesëve të metaleve të ngjyrosura</b>	-	-	-
10 10 05*	Bërthamat dhe kallëpat e derdhjeve të cilat nuk i janë nënshtruar derdhjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 10 07*	Bërthamat dhe kallëpet e derdhjeve të cilat nuk i janë nënshtruar derdhjeve që përmbajnë substancash të rrezikshme	-	-	-
10 10 09*	Pluhur nga gazi i oxhakut që përmban substanca të rrezikshme	-	-	-
10 10 11*	Grimca tjera të imëta që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 10 13*	Mbeturina të lidhjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
<b>10 11</b>	<b>Mbeturinat nga çelqi dhe produktet e çelqit</b>	-	-	-
10 11 09*	Mbeturina të përzierjeve të përgatitura përpara përpunimit termik, që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 11 11*	Mbeturina qelqi në grimca të imëta dhe pudër qelqi që përmbajnë metale të rënda (nga tubat e rrezeve katodike)	-	-	-
10 11 13*	Llumra të lustrimit dhe bluarjes (grimcimit) të qelqit, që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 11 15*	Mbeturina të ngurta nga trajtimet e gazit të oxhakut, që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 11 17*	Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazit të oxhakut, që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
<b>10 12</b>	<b>Mbeturinat nga prodhimi i mallrave nga qeramika, tullat, tjegullat dhe produktet për ndertim</b>	-	-	-
10 12 09*	Mbeturina të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
10 12 11*	Mbeturinat nga lustrimi që përmbajnë metale të rënda	-	-	-
<b>10 13</b>	<b>Mbeturinat nga prodhimi i çimentos, gëlqeres, allçisë si dhe artikujve dhe produkteve të bëra prej tyre</b>	-	-	-

10 13 09*	Mbeturinat nga prodhimi i azbest çimentos që përmbajnë asbest	-	-	-
10 13 12*	Mbeturinat e ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
<b>10 14</b>	<b>Mbeturina nga krematoriumet</b>	-	-	-
10 14 01*	Mbeturina nga pastrimi i gazeve që përmbajnë merkur	-	-	-
<b>Total mbeturinat të rrezikshme nga proceset termike</b>		<b>0 t</b>	<b>0 t</b>	<b>0 t</b>

#### 4.11 Mbeturinat nga trajtimi kimik i sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve dhe materialeve tjera

Mbeturinat nga trajtimi kimik i sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve klasifikohet si kategoria e njëmbëdhjetë në katalogun shtetëror të mbeturinave që përmban 4 nënkategori me hyrje katërshifrore dhe gjithsej 17 lloje të mbeturinave të rrezikshme me hyrje gjashtë shifrore të paraqitura si në tabelën në vijim:

Tabela Nr. 54: Mbeturinat nga trajtimi kimik i sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve dhe materialeve tjera		
Kodi	Emërtimi	Lloji hyrjes
<b>11 01</b>	<b>Mbeturinat nga trajtimi kimik i sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve dhe materialeve tjerë (p.sh. procesi galvanik, procesi i veshjeve me Zn, proceset për heqjen e skorieve, gravurat, fosfatet, delubrifikimi alkaline, anodizimi)</b>	
11 01 05*	Adidet konservuese	ARr
11 01 06*	Acidet të pa specifikuar ndryshe	ARr
11 01 07*	Bazat konservuese	ARr
11 01 08*	Llumrat nga fosfatimi	ARr
11 01 09*	Llumrat dhe shtresat e filtrit, që përmbajnë substancë të rrezikshme	PRr
11 01 11*	Lëngje ujore të shpërlarjes, që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
11 01 13*	Mbeturinat e delubrifikimit që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
11 01 15*	Eluate dhe llumra nga sistemet e membranave ose nga sisteme të jonoshkëmbyesve që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
11 01 16*	Rrëshira të ngopura ose të shpenzuara gjatë jonoshkëmbimit	ARr
11 01 98*	Mbeturinat tjera që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
<b>11 02</b>	<b>Mbeturinat nga proceset hidrometalurgjike të metaleve me ngjyrë</b>	
11 02 02*	Llumrat nga hidrometalurgjia e zinkut (përfshirë jarositet, goetit)	ARr
11 02 05*	Mbeturinat nga proceset hidrometalurgjike të bakrit që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
11 02 07*	Mbeturinat tjera që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
<b>11 03</b>	<b>Llumrat dhe mbeturinat e ngurta nga procesi i kalitjes</b>	
11 03 01*	Mbeturinat që përmbajnë cianide	ARr
11 03 02*	Mbeturinat tjera	ARr
<b>11 05</b>	<b>Mbeturinat nga procese të galvanizimit në të nxehtë</b>	
11 05 03*	Mbeturina të ngurta nga trajtimi i gazeve	ARr
11 05 04*	Shkrirësi i shpenzuar	ARr

#### 11 01 Mbeturinat nga trajtimi kimik i sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve dhe materialeve tjerë (p.sh. procesi galvanik, procesi i veshjeve me Zn, proceset për heqjen e skorieve, gravurat, fosfatet, delubrifikimi alkaline, anodizimi):

Trajtimi kimik i sipërfaqes metalike është një proces ku pjesët metalike përgatiten për veshje. Kjo zakonisht përfshin krijimin e një pengese fizike që do të mbron metalin nga korodimi. Filmat sipërfaqësor të përdorur në veshjet kimike formojnë reaksionin kimik jo elektrolitik që ndodh midis sipërfaqes së metalit dhe trësisës. Për të krijuar trajtimin e duhur të sipërfaqes metalike, filmi duhet të neutralizojë zonat e mundshme të korrodimit anodik dhe katodik. Ekzistojnë disa hapa në procesin e trajtimit të sipërfaqes metalike. Hapi i parë është pastrimi ku vajrat dhe papastërtit hiqen nga sipërfaqja e metaleve duke përdorur acidin klorhidrik, sulfurik, fosforik, hidrofluorik dhe nitrik. Kjo pasohet nga një shpërlarje dhe më pas një veshje prej fosfatit të hekurit ose zinkut. Hapi i fundit i paratrajtit është shpërlarja me ujë të pastër si ujë të dejonizuar dhe tharja në furrë. Ekzistojnë disa procese të veshjes së metaleve më të rëndësishme nga të cilët është galvanizimi i realizuar nga një shtresë mbrojtëse e zinkut. Ekzistojnë disa metoda për galvanizimin e metaleve: Galvanizimi me zhytje të nxehtë përfshin zhytjen e metaleve bazë në një vaskë të shkrirë të zinkut. Elektrogalvanizimi është një metodë

alternative e cila përdor një rrymë elektrike në një solucion elektrolit për të transferuar jonet e zinkut në metalin bazë. Kjo përfshin reduktimin elektrik të joneve pozitive të zinkut të cilat më pas depozitohen në materialin e ngarkuar pozitivisht. Procesi i galvanizimit të metalit karakterizohet me gjenerimin e mbeturinave të shumta të rrezikshme në formë të acideve, bazave, efluate, llumërave, rrëshirave etj.

Në Kosovë këso lloj veprimtarie është zbatuar në GC Metal Janjevë e cila për momentin është jashtë përdorimit. Aty për momentin janë të deponuara acide dhe baza konzervuese mbeturinë si dhe kimikate të skaduara të cilat ruhen në kushte të papërshtatshme. Sasia e mbeturinave të rrezikshme për këtë kategori është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela Nr. 55: Mbeturinat nga trajtimi kimik i sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve dhe materialeve tjerë					
Kodi	Kategoria	Formula	Mbeturinat në fillim të 2019	Mbeturinat në 2019	Total mbeturinat
11 11			2,445 kg	0kg	2,445 kg
11 11 05*	Acidet konservuese		510 kg	0 kg	510 kg
	Acidi sulfurik	H <sub>2</sub> SO <sub>4</sub>	80 kg	0 kg	80 kg
	Acidi acetik	CH <sub>3</sub> COOH	30 kg	0 kg	30 kg
	Treoksid i kromit	CrO <sub>3</sub>	400 kg	0 kg	400 kg
11 11 07*	Bazat konservuese		1,790 kg	0 kg	1,790 kg
	Kalium cianidi	KCN	1,750 kg	0 kg	1,750 kg
	Kalium hidroksid	KOH	30 kg	0 kg	30 kg
	Hidroksid Amonium	NH <sub>4</sub> OH	10 kg	0 kg	10 kg
11 01 98*	Mbeturinat tjera që përmbajnë substanca të rrezikshme		145 kg	0 kg	145 kg
	Metanol	CH <sub>3</sub> OH	15 kg	0 kg	15 kg
	Nitrat i zinkut	Zn(NO <sub>3</sub> ) <sub>2</sub>	50 kg	0 kg	50 kg
	Klorur i zinkut	ZnCl <sub>2</sub>	80 kg	0 kg	80 kg

### 11 02 Mbeturinat nga proceset hidrometalurgjike të metaleve me ngjyrë:

Në hidrometalurgji, metali së pari ndahet nga xehja duke përdorur një reaksion kimik, i cili më pas nxirret në formë të pastër duke përdorur elektrolizën ose precipitimin. Një tjetër ndryshim i madh hidrometalurgjisë së metaleve me ngjyra është përmirësimi i efikasitetit të procesit respektivisht minimizimit të përmbajtjes së metaleve në skorje. Elektrometalurgjia përfshin përpunimin elektrolitik ose elektrotermik. Xehja distilohet në një tretje elektroliti ose acidi, pastaj depozitohet magnetikisht në një pllakë katodike; ose shkrihet dhe pastrohet duke përdorur një furre. Disa nga proceset hidrometalurgjike përfshijnë kullimin, precipitimin e përbërjeve të patretshme dhe uljen e presionit. Mbeturinat e rrezikshme nga proceset hidrometalurgjike të metaleve me ngjyrë përfshijnë llumrat nga hidrometalurgjia e zinkut si dhe mbeturina tjera të procesimit të metaleve të rënda kryesisht në formë të efluentëve.

### 11 03 Llumrat dhe mbeturinat e ngurta nga procesi i kalitjes:

Kalitja është një proces për trajtimin termik të çelikut i cili i nënshtrohet variacionit të ngrohjes, dhe ftohjes së shpejtë. Kur çeliku ftohet shpejt, atomet "ngrihen" në një pozicion të paqëndrueshëm. Çeliku është shumë i fortë por edhe i brishtë. Me anë të kalitjes çeliku bëhet më i qëndrueshëm duke iu shtuar elasticiteti. Kalitja zakonisht kryhet me flakë duke djegur thëngjillin apo lëndë tjera djegie. Kalitja me cianid është një mënyrë e forcimit të sipërfaqes së çelikut me karbon i cili futet në një vaskë me cianid të natriumit dhe kaliumit, i holluar me karbonat natriumi dhe i ulur në vaj. Ky trajtim i kalitjes funksionon për të krijuar një shtresë të hollë me ngurtësi shumë të lartë. Trajtimi me këtë metodë gjeneron mbeturina me bazë cianidi me toksicitet shumë të lartë.

4.11.1.1 Kuantifikimi i mbeturinave të rrezikshme nga trajtimi kimik i sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve dhe materialeve tjera

Në Kosovë në përjashtim të mbeturinave që ndërlidhen me nënkategorinë 11 01 dmth Mbeturinat nga trajtimi kimik i sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve dhe materialeve tjerë (p.sh. procesi galvanik, procesi i veshjeve me Zn, proceset për heqjen e skorieve, gravurat, fosfatet, delubrifikimi alkaline, anodizimi) nuk ka mbeturina të rrezikshme të llojeve tjera të nënkategorive tjera.

Sasia e mbeturinave të rrezikshme për nënkategorinë 11 është paraqitur në tabelën e mëposhtme dhe i referohet mbeturinave të gjeneruara nga periudhat paraprake.

Tabela Nr. 56: Mbeturinat nga trajtimi kimik i sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve dhe materialeve tjera				
Kodi	Emërtimi	Sasia në fillim të vitit raportues	Sasia e mbeturinave e krijuar në 2019	Sasia e mbeturinave në fund të periudhës raportuese
<b>11 01</b>	<b>Mbeturinat nga trajtimi kimik i sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve dhe materialeve tjerë (p.sh. procesi galvanik, procesi i veshjeve me Zn, proceset për heqjen e skorieve, gravurat, fosfatet, delubrifikimi alkaline, anodizimi)</b>	2.4 ton	0 ton	2.4 ton
11 01 05*	Adidet konservuese	1.8 ton	0 ton	1.8 ton
11 01 06*	Acidet të pa specifikuar ndryshe	0 ton	0 ton	0 ton
11 01 07*	Bazat konservuese	0.5 ton	0 ton	0.5 ton
11 01 08*	Llumrat nga fosfatimi	0 ton	0 ton	0 ton
11 01 09*	Llumrat dhe shtresat e filtrit, që përmbajnë substancë të rrezikshme	0 ton	0 ton	0 ton
11 01 11*	Lëngje ujore të shpërlarjes, që përmbajnë substanca të rrezikshme	0 ton	0 ton	0 ton
11 01 13*	Mbeturinat e delubrifikimit që përmbajnë substanca të rrezikshme	0 ton	0 ton	0 ton
11 01 15*	Eluate dhe llumra nga sistemet e membranave ose nga sisteme të jonoshkëmbyesve që përmbajnë substanca të rrezikshme	0 ton	0 ton	0 ton
11 01 16*	Rrëshira të ngopura ose të shpenzuara gjatë jonoshkëmbimit	0 ton	0 ton	0 ton
11 01 98*	Mbeturinat tjera që përmbajnë substanca të rrezikshme	0.15 ton	0 ton	0.15 ton
<b>11 02</b>	<b>Mbeturinat nga proceset hidrometalurgjike të metaleve me ngjyrë</b>	0 ton	0 ton	0 ton
11 02 02*	Llumrat nga hidrometalurgjia e zinkut (përfshirë jarositet, goetitit)	0 ton	0 ton	0 ton
11 02 05*	Mbeturinat nga proceset hidrometalurgjike të bakrit që përmbajnë substanca të rrezikshme	0 ton	0 ton	0 ton
11 02 07*	Mbeturinat tjera që përmbajnë substanca të rrezikshme	0 ton	0 ton	0 ton
<b>11 03</b>	<b>Llumrat dhe mbeturinat e ngurta nga procesi i kalitjes</b>	0 ton	0 ton	0 ton
11 03 01*	Mbeturinat që përmbajnë cianide	0 ton	0 ton	0 ton
11 03 02*	Mbeturinat tjera	0 ton	0 ton	0 ton
<b>11 05</b>	<b>Mbeturinat nga procese të galvanizimit në të nxehtë</b>	0 ton	0 ton	0 ton
11 05 03*	Mbeturina të ngurta nga trajtimi i gazeve	0 ton	0 ton	0 ton
11 05 04*	Shkrirësi i shpenzuar	0 ton	0 ton	0 ton
	<b>Total mbeturinat nga trajtimi kimik i sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve dhe materialeve tjera</b>	<b>2.4 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>2.4 ton</b>

#### 4.12 Mbeturinat nga trajtimi fiziko-mekanik dhe dhënia e formës së metaleve dhe plastikave

Mbeturinat nga trajtimi fiziko-mekanik i metaleve dhe plastikave klasifikohet si kategoria e dymbëdhjetë në katalogun e mbeturinave e cila përmban 2 nënkategori me hyrje katërshifrore dhe gjithsej 13 lloje të mbeturinave të rrezikshme me hyrje gjashtë shifrore të paraqitura si në tabelën në vijim:

Tabela Nr. 57: Mbeturinat nga trajtimi kimik i sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve dhe materialeve tjera		
Kodi	Emërtimi	Lloji hyrjes
<b>12 01</b>	<b>Mbeturinat nga gdhendja dhe trajtimi fiziko-mekanik i sipërfaqes së metaleve dhe plastikave</b>	
12 01 06*	Vajrat minerale të makinerive që përmbajnë halogjenë (përveç emulsioneve dhe solucioneve)	ARr
12 01 07*	Vajrat minerale të makinerive që nuk përmbajnë halogjenë, (përveç emulsioneve dhe solucioneve)	ARr
12 01 08*	Solucione dhe emulsione të makinerive që përmbajnë halogjene	ARr
12 01 09*	Solucione dhe emulsione të makinerive që nuk përmbajnë halogjene	ARr
12 01 10*	Vajrat sintetike të makinave	ARr
12 01 12*	Parafinat dhe yndyrat e shpenzuar	ARr
12 01 14*	Llumrat e makinerive që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
12 01 16*	Mbeturina të materialeve shpërthyes që përmbajnë substanca të rrezikshme	PRr
12 01 18*	Llumra metalike (bluarjeve dhe grirjeve) që përmbajnë vajra	PRr
12 01 19*	Vajra të makinave lehtësisht të biodegradueshme	PRr
12 01 20*	Trupat e shpenzuara gjatë bluarjes dhe materialet e shpenzuar që përmbajnë substanca të rrezikshme	ARr
<b>12 03</b>	<b>Mbeturinat nga proceset e heqjes së vajit me ujë apo avull (përveq 11)</b>	
12 03 01*	Lëngjet ujore për larje	ARr
12 02 02*	Mbeturina nga heqja e yndyrës me avull	ARr

##### 4.12.1 Kuantifikimi i mbeturinave nga trajtimi fiziko-mekanike dhe dhënia e formës së metaleve dhe plastikave 12

Mbeturinat nga kjo kategori janë kryesisht në formë të vajrave minerale, solucioneve dhe emulsione të makinerive dhe janë të paraqitura në tabelën në vijim Nr. 56.

Për këtë cikël të kadastrit nuk kanë mundur të identifikohen operatorët që bëjnë trajtimin kimik të sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve dhe materialeve tjera, rrjedhimisht nuk është bërë provizionim i këtyre mbeturinave.

Megjithatë për ciklet e ardhëshme raportuese duhen të identifikohen këta operatorë dhe të kuantifikohen këso lloj mbeturinash.

Tabela Nr. 58: Mbeturinat nga trajtimi kimik i sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve dhe materialeve tjera				
Kodi	Emërtimi	Sasia në fillim të vitit raportues	Sasia e mbeturinave e krijuar në 2019	Sasia e mbeturinave në fund të periudhës raportuese
<b>12 01</b>	<b>Mbeturinat nga gdhendja dhe trajtimi fiziko-mekanik i sipërfaqes së metaleve dhe plastikave</b>	-	-	-
12 01 06*	Vajrat minerale të makinerive që përmbajnë halogjenë (përveç emulsioneve dhe solucioneve)	-	-	-
12 01 07*	Vajrat minerale të makinerive që nuk përmbajnë halogjenë, (përveç emulsioneve dhe solucioneve)	-	-	-
12 01 08*	Solucione dhe emulsione të makinerive që përmbajnë halogjene	-	-	-

12 01 09*	Solucione dhe emulsione të makinerive që nuk përmbajnë halogjene	-	-	-
12 01 10*	Vajrat sintetike të makinave	-	-	-
12 01 12*	Parafinat dhe yndyrat e shpenzuar	-	-	-
12 01 14*	Llumrat e makinerive që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
12 01 16*	Mbeturina të materialeve shpërthyesë që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
12 01 18*	Llumra metalike (bluarjeve dhe grirjeve) që përmbajnë vajra	-	-	-
12 01 19*	Vajra të makinave lehtësisht të biodegradueshme	-	-	-
12 01 20*	Trupat e shpenzuara gjatë bluarjes dhe materialet e shpenzuar që përmbajnë substanca të rrezikshme	-	-	-
<b>12 03</b>	<b>Mbeturinat nga proceset e heqjes së vajit me ujë apo avull (përveq 11)</b>	-	-	-
12 03 01*	Lëngjet ujore për larje	-	-	-
12 02 02*	Mbeturina nga heqja e yndyrës me avull	-	-	-
<b>Total mbeturinat nga trajtimi kimik i sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve dhe materialeve tjera</b>		<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>

#### 4.13 Mbeturinat e vajrave dhe mbeturinat e karburanteve të lëngshme

Mbeturinat e vajrave dhe mbeturinat e karburanteve të lëngshme klasifikohet si kategoria e trembëdhjetë në katalogun e mbeturinave që përmban 7 nënkategori me hyrje katërshifrore dhe gjithsej 34 lloje të mbeturinave të rrezikshme me hyrje gjashtë shifrore të paraqitura si në tabelën në vijim:

Tabela Nr. 59: Mbeturinat e vajrave dhe mbeturinat e karburanteve të lëngshme		
Kodi	Emërtimi	Lloji hyrjes
<b>13 01</b>	<b>Mbeturinat e vajrave hidraulike</b>	
13 01 01*	Vajrat hidraulike, që përmbajnë PCB	ARr
13 01 04*	Emulsionet e kloruara	ARr
13 01 05*	Emulsionet e pa-kloruara	ARr
13 01 09*	Vajrat hidraulike të kloruara me bazë minerale	ARr
13 01 10*	Vajrat hidraulike të pakloruara me bazë minerale	ARr
13 01 11*	Vajrat hidraulike sintetike	ARr
13 01 12*	Vajrat hidraulike lehtësisht të biodegraduara	ARr
13 01 13*	Vajrat tjerë hidraulikë	ARr
<b>13 02</b>	<b>Mbeturinat e vajrave nga motori, ingranazhi dhe lubrifikimi</b>	
13 02 04*	Vajra motori ingranazhesh dhe lubrifikues të kloruar me bazë minerale	ARr
13 02 05*	Vajra motori, ingranazhesh/dhëmbzorët dhe lubrifikues të pa kloruar me bazë minerale	ARr
13 02 06*	Vaj sintetik motori, ingranazhi/dhëmbzori dhe lubrifikues	ARr
13 02 07*	Vajra lehtësisht të biodegradueshme: motori, ingranazha dhe lubrifikanti	ARr
13 02 08*	Vajra tjera motori, ingranazhi dhe lubrifikante	ARr
<b>13 03</b>	<b>Mbeturina vajrash izoluese dhe vajrat përcjellës nxehtësie</b>	
13 03 01*	Mbeturina vajrash izoluese dhe vajrave përcjellës të nxehtësisë që përmbajnë PCB	ARr
13 03 06*	Mbeturina vajrash izolues dhe vajrat përcjellës të nxehtësisë të klorinuar me bazë minerale, tjera nga ato të përmendura në 13 03 01	ARr
13 03 07*	Vajra izoluese dhe vajra përcjellës të paklorinuar me bazë minerale	ARr
13 03 08*	Vajra izoluese, përcjellës nxehtësie dhe sintetike	ARr
13 03 09*	Vajra lehtësisht të biodegradueshme, vajra izoluese dhe përcjellës nxehtësie	ARr
13 03 10*	Vajra tjerë izolues dhe përcjellës nxehtësie	ARr
<b>13 04</b>	<b>Vajra të ndotura anijesh</b>	
13 04 01*	Vajra të ndotur anijesh nga lundrimi pranë tokës	ARr
13 04 02*	Vajra nga ujëra të zeza të bankinave	ARr
13 04 03*	Vajra të ndotur nga lundrime të tjera	ARr
<b>13 05</b>	<b>Përbërës të seperatoreve ujë/vaj</b>	
13 05 01*	Pjesë të ngurta nga seperatorët ujë/vaj	ARr
13 05 02*	Llumrat nga ndarja ujë/vaj	ARr
13 05 03*	Llumrat ndërmjetes	ARr
13 05 06*	Vaj nga seperatorët ujë/vaj	ARr
13 05 07*	Ujë me vaj nga seperatorët ujë/vaj	ARr
13 05 08*	Përzierje mbeturinash nga seperatorët ujë/vaj	ARr
<b>13 07</b>	<b>E karburanteve të langshme</b>	
13 07 01*	Naftë dhe diesel	ARr
13 07 02*	Benzinë	ARr
13 07 03*	Lëndë tjera djegëse (përfshi edhe përzierjet)	ARr

<b>13 08</b>	<b>Mbeturinë vajrash të paspecifikuar diku tjetër</b>	
13 08 01*	Llumrat nga shkripëzimet ose emulsionet	ARr
13 08 02*	Emulsione tjera	ARr
13 08 99*	Mbeturinat të pa specifikuara ndryshe	ARr

### 13 01 Mbeturinat e vajrave hidraulike:

Vaji hidraulik është një lëng jo i kompresueshëm që përdoret për të transferuar energjinë brenda makinerive dhe pajisjeve hidraulike. Vaji hidraulik ka përdorim të gjerë tek vinçat në ndërtimtari ashensorët e ndërtesave shumëkatëshe dhe makinat tjera hidraulike. Poashtu ai shfrytëzohet tek mjetet motorrike të rënda dhe të lehta. Vaji hidraulik mundet me qenë me bazë të hidrokarbureve, i sintetizuar me bazë minerale, i klorinuar, dhe i paklorinuar, me shtesë të sulfurit varësisht nga lloji i makinerisë apo pajisjes që përdoret dhe karakteristikave tjera. Vaji hidraulik ka afatin e përdorimit pas të cilit i humb vetitë e kërkuara psh viskoziteti dinamik dhe për rrjedhojë duhet të zëvendësohet duke fituar statusin e vajit mbeturinë. Intervali tek vinçat dhe makinat e rënda hidraulike shkon prej 300-600 orë punëve. Tek ashensorët servisimi nuk bëhet në bazë të orëve por testimi të vajit. Tek kamionët dhe automobilat servisimi bëhet në intervalet 50,000 – 100,000 km etj. Vajërat hidraulike mbeturinë pavarësisht llojit dhe përmbajtjes konsiderohen mbeturina të rrezikshme.

### 13 02 Mbeturinat e vajrave nga motori, ingranazhi dhe lubrifikimi:

Vajrat motorrike të ingranazhit dhe lubrifikuese përdoren nga makinat transportuese dhe makineria e rëndë me motorr me djegie të brendshme. Është vështirë të identifikohen të gjitha tipet e makinerisë që përdorin vajëra por tipet kryesore dhe numri janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Poashtu sasia e konsumit të vajrave si dhe periudha e servisimit variron nga lloji i makinerisë.

Tabela Nr. 60: Kalkulimi i vajrave motorrike mbeturinë					
Lloji	Numri	Konsumi mesatar i vajrave për servisim	Harxhimi (humbja) i vajit 10% (ton)	Numri i servisimeve në vjet	Vajrat mbeturinë
Vetura	267,125	6 l/servisim	240.4	1.5 servisime	2,164
Autobusët	17,433	20 l/servisim	104.6	3 servisime	941
Automjetet e transportit 3.5t dhe mbi 3.5t	31,154	20 l/servisim	124.6	2 servisim/vjet	1,122
Automjetet e transportit nën 3.5t	1,843	15 l/servisim	5.5	2 servisime	50
Kombibusët	602	10 l/servisim	1.8	3 servisime	16
Makinë bujqësore - traktorët	1,423	6 l/servisim	0.85	1 servisim	8
Eskavatorë	17,433	25 l/servisim	-	2 servisime	-
Buldozerë	-	35 l/servisim	-	2 servisime	-
<b>Total</b>			<b>477.8 t</b>		<b>4,300.3 t</b>

### 13 03 Mbeturina vajrash izoluese dhe vajrat përcjellës nxehtësie

Pajisjet kryesore që e përdorin këtë lloj vaji janë transformatorët në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Këta transformator gjenden në posedim të KEK dhe pjesa tjetër operohet nga KEDS. Disa nga këta transformatorë iu është shtuar si aditiv poliiklorur bifenili si aditiv për kontrollin e nxehtësisë që konsiderohet si ndotës i vazhdueshëm organik.

Në KEK ndodhen gjithësejt 31 transformator që janë supozuar që përmbajnë vaj me PCB

- 21 transformator me përbërje vaji me PCB gjinden në Hangarin A2 pranë TC "Kosova B".
- Në TC "Kosova A" nga 5 transformator që dyshohet se kanë në përbërje vaj me PCB , dy edhe më tutje janë në operim ndërsa 3 transformator janë jashtë operimit.
- Dhe në Departamentin e Seperimeve Kimike si pjesë e Divizionit të TC "Kosov A" gjenden 5 transormoter të dyshuara që në përbërje kanë vaj me PCB, aktualisht janë objekt i procesit të dekomisionimit. Dekontaminimi zakonisht kryhet kur vaji në transformator përmban më tepër se 50 ppm PCB (analiza e vajit e përcakton këtë).

#### 4.13.1.1 Kuantifikimi i vajrave mbeturinë

Në tabelën në vijim janë dhënë të dhënat nga DK mbi importet e vajërave gjatë vitit 2019 të cilat do të përdoren si bazë për kalkulimin e sasisë së këtyre mbeturinave:

Tabela Nr. 61: Importi I vajrave 2019 sipas DK		
Kategoria	Vlera €	Pesha kg
2710198110 - Vajrat lubrifikante për motore, kompresorë dhe turbina, në paketime të drejtpërdrejta apo në kontenjer jo më tepër se 220 litra	4,769,667.2	2,313,375.3
2710198190 - Vajrat lubrifikante për motore, kompresorë dhe turbina, në konteiner më tepër se 220 litra	1,845,995.5	945,187.9
2710198310 - Vajrat lubrifikante për qelime hidraulike, në paketime të drejtpërdrejta apo në kontenjer jo më tepër se 220 litra	842,408.9	700,248.4
2710198390 - Vajrat lubrifikante për qelime hidraulike, në konteiner më tepër se 220 litra	397,011.4	302,089.2
2710198500 - Vajra të bardha dhe parafine e lëngshme	2,224.5	209.4
2710198710 - Vajrat për ingranazhe dhe reduktore, në paketime të drejtpërdrejta apo në kontenjer jo më tepër se 220 litra	675,592.9	305,356.7
2710198790 - Vajrat për ingranazhe dhe reduktore, në konteiner më tepër se 220 litra	226,064.1	115,591.6
2710199100 - Vajrat e përgatitur për punimin e metaleve, vajra për çlirimin e kallëpeve, vajra kundër ndryshkjes	10,552.1	3,053.3
2710199300 - Vajra për izolim elektrik	14,707.3	10,368.1
2710199910 - Vajra të tjera lubrifikuese (jo specifikuar me lart), në paketime të drejtpërdrejta apo në kontenjer jo më tepër se 220 litra	330,419.3	162,519.9
2710199990 - Vajra të tjera lubrifikuese (jo specifikuar me lart), në konteiner më tepër se 220 litra	625,664.7	694,148.7
2710209000 - Vajra tjera	264.1	16.0
2710990000 - Të tjera	20,174.9	21,930.0
<b>Total:</b>	<b>9,760,746.9</b>	<b>5,574,094.7</b>

Nëse merret se kohëzgjatja mesatare e vajrave është 1 vjeçare me koeficient të humbjes prej 10% atëherë sasia e vajrave mbeturinë është 5,016.6 ton e prezentuar në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr. 62: Mbeturinat e vajrave dhe mbeturinat e karburanteve të lëngshme				
Kodi	Emërtimi	Sasia në fillim të vitit raportues	Sasia e mbeturinave e krijuar në 2019	Sasia e mbeturinave në fund të periudhës raportuese
<b>13 01</b>	<b>Mbeturinat e vajrave hidraulike</b>	-	-	-
13 01 01*	Vajrat hidraulike, që përmbajnë PCB	-	-	-
13 01 04*	Emulsionet e kloruara	-	-	-
13 01 05*	Emulsionet e pa-kloruara	-	-	-
13 01 09*	Vajrat hidraulike të kloruara me bazë minerale	-	-	-
13 01 10*	Vajrat hidraulike të pakloruara me bazë minerale	-	-	-
13 01 11*	Vajrat hidraulike sintetike	-	-	-
13 01 12*	Vajrat hidraulike lehtësisht të biodegraduara	-	-	-

13 01 13*	Vajrat tjerë hidraulikë	-	-	-
<b>13 02</b>	<b>Mbeturinat e vajrave nga motori, ingranazhi dhe lubrifikimi</b>	-	-	-
13 02 04*	Vajra motori ingranazhesh dhe lubrifikues të kloruar me bazë minerale	-	-	-
13 02 05*	Vajra motori, ingranazhesh/dhëmbzorët dhe lubrifikues të pa kloruar me bazë minerale	-	-	-
13 02 06*	Vaj sintetik motori, ingranazhi/dhëmbzori dhe lubrifikues	-	-	-
13 02 07*	Vajra lehtësisht të biodegradueshme: motori, ingranazha dhe lubrifikanti	-	-	-
13 02 08*	Vajra tjera motori, ingranazhi dhe lubrifikante	-	-	-
<b>13 03</b>	<b>Mbeturina vajrash izoluese dhe vajrat përcjellës nxehtësie</b>	-	-	-
13 03 01*	Mbeturina vajrash izoluese dhe vajrave përcjellës të nxehtësisë që përmbajnë PCB	-	-	-
13 03 06*	Mbeturina vajrash izolues dhe vajrat përcjellës të nxehtësisë të klorinuar me bazë minerale, tjera nga ato të përmendura në 13 03 01	-	-	-
13 03 07*	Vajra izoluese dhe vajra përcjellës të paklorinuar me bazë minerale	-	-	-
13 03 08*	Vajra izoluese, përcjellës nxehtësie dhe sintetike	-	-	-
13 03 09*	Vajra lehtësisht të biodegradueshme, vajra izoluese dhe përcjellës nxehtësie	-	-	-
13 03 10*	Vajra tjerë izolues dhe përcjellës nxehtësie	-	-	-
<b>13 04</b>	<b>Vajra të ndotura anijesh</b>	-	-	-
13 04 01*	Vajra të ndotur anijesh nga lundrimi pranë tokës	-	-	-
13 04 02*	Vajra nga ujëra të zeza të bankinave	-	-	-
13 04 03*	Vajra të ndotur nga lundrime të tjera	-	-	-
<b>13 05</b>	<b>Përbërës të seperatoreve ujë/vaj</b>	-	-	-
13 05 01*	Pjesë të ngurta nga seperatorët ujë/vaj	-	-	-
13 05 02*	Llumrat nga ndarja ujë/vaj	-	-	-
13 05 03*	Llumrat ndërmjetes	-	-	-
13 05 06*	Vaj nga seperatorët ujë/vaj	-	-	-
13 05 07*	Ujë me vaj nga seperatorët ujë/vaj	-	-	-
13 05 08*	Përzierje mbeturinash nga seperatorët ujë/vaj	-	-	-
<b>13 07</b>	<b>E karburanteve të langshme</b>	-	-	-
13 07 01*	Naftë dhe diezel	-	-	-
13 07 02*	Benzinë	-	-	-
13 07 03*	Lëndë tjera djegëse (përfshi edhe përzierjet)	-	-	-
<b>13 08</b>	<b>Mbeturinë vajrash të paspecifikuar diku tjetër</b>	-	-	-
13 08 01*	Llumrat nga shkripëzimet ose emulsionet	-	-	-
13 08 02*	Emulsione tjera	-	-	-
13 08 99*	Mbeturinat të pa specifikuara ndryshe	-	-	-
<b>Total mbeturina të vajrave dhe karburanteve të lëngshme 13</b>		-	<b>5,016.6 t</b>	<b>5,016.6 t</b>

#### 4.14 Mbeturinat e tretësve ftohësve dhe propeluesve organik (përveq 07 dhe 08)

Mbeturinat e tretësve ftohësve dhe propeluesve organik klasifikohet si kategoria e katërmbëdhjetë në katalogun e mbeturinave që përmban një nënkategori me hyrje katërshifrore dhe gjithsej 5 lloje të mbeturinave të rrezikshme me hyrje gjashtë shifrore të paraqitura si në tabelën në vijim:

Tabela Nr. 63: Mbeturinat e tretësve ftohësve dhe propeluesve organik (përveq 07 dhe 08)		
Kodi	Emërtimi	Lloji hyrjes
<b>14 06</b>	<b>Mbeturina të tretësave organik, ftohësve dhe pompuesve (shkuma aerosole)</b>	
14 06 01*	Kloroflouro karbonet, HCFC, HEC	ARr
14 06 02*	Tretësa tjerë të halogjenizuar dhe përzierje tretësirash	ARr
14 06 03*	Tretësa tjerë dhe përzierje tretësirash	ARr
14 06 04*	Llumrat ose mbeturinat e ngurta që përmbajnë tretës të halogjenizuar	PRr
14 06 05*	Llumrat ose mbeturinat e ngurta që përmbajnë tretësa tjerë	PRr

Tretësirat halogjenë kanë përdorim të gjerë dhe shumëfishtë si psh: për të shpërndar materiale të papërpunuara ose mbeturina: si agjent pastrimi për të shpërndar ndotës; si tretës; si rregullues të viskozitetit ose tensionit sipërfaqësor, ose si plastifikues, etj.

Tretësit halogjenë përshkruhen si tretës organik të cilët përmbajnë të paktën një atom bromi, klori, fluori ose jodi për molekulë.

Sipas Direktivës së Këshillit 1999/13 / EC aktivitetet në të cilat përdoren tretësit janë renditur si më poshtë:

- Veshje ngjitëse
- Veshje të sipërfaqes së automjeteve, sipërfaqeve metalike dhe plastike, sipërfaqeve prej druri, tekstili, pëlhurave, etj. film dhe sipërfaqe letre dhe lëkure.
- Veshje spirale ku çeliku i mbështjellë, çeliku i pandryshkshëm, çeliku i veshur, lidhjet e bakrit ose shirita alumini është i veshur ose me një shtresë formuese ose veshje të petëzuar në një proces të vazhdueshëm.
- Pastrim kimik
- Prodhim këpucësh
- Prodhimi i preparateve të veshjes, bojrave, bojrave dhe ngjitësve
- Prodhimi i produkteve farmaceutike
- Printimi.
- Konvertimi i gomës
- Pastrimi i sipërfaqeve
- Nxjerrja e vajit të perimeve dhe yndyrnave shtazore dhe aktivitetet e rafinimit të vajit vegjetal
- Impregnim druri
- Petëzimi i drurit dhe plastikës

Ftohësit përfshijn substancat si klorofluorokarbonet (CFC), hidroklorofluorokarburet (HCFC), hidrofluorbarburet (HFC) dhe ftohësit natyral. Ftohësit përdoren në kondicioner, në kondicioner makinash, frigorifer dhe pajisje tjera ftohëse.

Pompuesit ose propeluesit janë substanca kimike që përdoren në prodhimin e energjis ose gazit nën presion që më pas përdoret për të krijuar lëvizjen e një lëngu ose për të gjeneruar shtytje të një automjeti, predheje ose objekti tjetër. Pompuesit përdoren në lansimin e raketave dhe të ngjashme.

#### 4.14.1 Kuantifikimi i mbeturinave të tretësve ftohësve dhe propeluesve organik

Ekzistojn aktivitete të shumta dhe të shpërndara ku përdoren tretësit organik dhe rrjedhimisht mbeturinat që shkaktohen prej tyre. Prandaj është praktikisht e pamundur që të kuantifikohet sasia e tyre meqë shumica nga këto mbeturina krijohen nga operatorë të vegjël si pastrimet kimike, serviset e e autmjeteve ose amvisëritë. Poashtu vlerësimi i sasisë së krijimit të këtyre kimikateve është i pamundur me një margjinë të pranueshme të gabimit

Për këtë arsye për këtë cikël nuk do të raportohet gjenerimi i kësaj mbeturine.

<b>Tabela Nr. 64: Mbeturinat e tretësve ftohësve dhe propeluesve organik (përveq 07 dhe 08)</b>				
Kodi	Emërtimi	Sasia në fillim të vitit raportues	Sasia e mbeturinave e krijuar në 2019	Sasia e mbeturinave në fund të periudhës raportuese
<b>14 06</b>	<b>Mbeturina të tretësve organik, ftohësve dhe pompuesve (shkuma aerosole)</b>	-	-	-
14 06 01*	Kloroflouro karbonet, HCFC, HEC	-	-	-
14 06 02*	Tretësa tjerë të halogjenizuar dhe përzierje tretësirash	-	-	-
14 06 03*	Tretësa tjerë dhe përzierje tretësirash	-	-	-
14 06 04*	Llumrat ose mbeturinat e ngurta që përmbajnë tretës të halogjenizuar	-	-	-
14 06 05*	Llumrat ose mbeturinat e ngurta që përmbajnë tretësa tjerë	-	-	-
<b>Total mbeturinat e tretësve ftohësve dhe propeluesve organik (përveq 07 dhe 08)</b>		<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>

#### 4.15 Paketime mbeturinash, absorbente, rroba fshirëse, filtrave dhe rrobave mbrojtëse

Mbeturinat e paketimit klasifikohet si kategoria e pesëmbëdhjetë në katalogun e mbeturinave që përmban 2 nënkategori me hyrje katërshifrore dhe gjithsej 3 lloje të mbeturinave të rrezikshme me hyrje gjashtë shifrore të paraqitura si në tabelën në vijim:

Tabela Nr. 65: Paketime mbeturinash, absorbente, rroba fshirëse, filtrave dhe rrobave mbrojtëse		
Kodi	Emërtimi	Lloji hyrjes
15 01	<b>Ambalazhe/paketime (duke përfshirë mbeturinat e ndara të paketuara komunale) 15 01</b>	
15 01 10*	Ambalazhe që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme	ARr
15 01 11*	Mbeturina ambalazhi metalike që përmbajnë materiale të ngurta poroze (p.sh. azbest), duke përfshirë kontenieret bosh të presioneve	ARr
15 02	<b>Absorbuesit, filterët nga materiali, lecat për fshirje dhe veshjet mbrojtëse</b>	
15 02 02*	Absorbuesit, filterat nga materiali ( përfshirë filterët me vaj të paspecifikuar ndryshe), lecat për fshirje, veshjet mbrojtëse të kontaminuara me substanca të rrezikshme	PRr

Mbeturinat nga kjo kategori përbëjnë mbeturina paketimi dhe ambalazhi që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme.

##### 4.15.1 Kuantifikimi i mbeturinave nga paketime mbeturinash, absorbente, rroba fshirëse, filtrave dhe rrobave mbrojtëse

Për këtë cikël raportues ekipi i projektit nuk ka mund të identifikoj sasin e mbeturinave përkundër se ekziston konsum i madh i kimikateve të rrezikshme në Kosovë të cilat janë të ambalazuara qe potencialisht krijohet si mbeturinë pas përdorimit të tyre. Poashtu edhe ambalazhi i mbeturinave të rrezikshme duhet të përfshihet dhe raportohet në këtë kategori.

Sipas infrastrukturës ligjore në fuqi ambalazhi dhe paketimi i substancave të rrezikshme pas përdorimit të substancës nuk guxon të trajtohet ndryshe por vetëm si mbeturinë e rrezikshme.

Operatorët e mbeturinave të rrezikshme që konsumojnë kimikate duhet që krahas mbeturinave tjera të rrezikshme të raportojnë edhe për ambalazhet dhe paketimet e kimikateve të rrezikshme.

Tabela Nr. 66: Paketime mbeturinash, absorbente, rroba fshirëse, filtrave dhe rrobave mbrojtëse				
Kodi	Emërtimi	Sasia në fillim të vitit raportues	Sasia e mbeturinave e krijuar në 2019	Sasia e mbeturinave në fund të periudhës raportuese
15 01	<b>Ambalazhe/paketime (duke përfshirë mbeturinat e ndara të paketuara komunale) 15 01</b>	-	-	-
15 01 10*	Ambalazhe që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme	-	-	-
15 01 11*	Mbeturina ambalazhi metalike që përmbajnë materiale të ngurta poroze (p.sh. azbest), duke përfshirë kontenieret bosh të presioneve	-	-	-
15 02	<b>Absorbuesit, filterët nga materiali, lecat për fshirje dhe veshjet mbrojtëse</b>	-	-	-
15 02 02*	Absorbuesit, filterat nga materiali ( përfshirë filterët me vaj të paspecifikuar ndryshe), lecat për fshirje, veshjet mbrojtëse të kontaminuara me substanca të rrezikshme	-	-	-
<b>Total paketime mbeturinash, absorbente, rroba fshirëse, filtrave dhe rrobave mbrojtëse</b>		<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>	<b>0 ton</b>

#### 4.16 Mbeturinat të paspecifikuara ndryshe në listë

Mbeturinat të paspecifikuara ndryshe në listë klasifikohet si kategoria e gjashtëmbëdhjetë në katalogun shtetëror të mbeturinave që përmban 11 nënkategori me hyrje katërshifrore dhe gjithsej 43 lloje të mbeturinave të rrezikshme me hyrje gjashtë shifrore të paraqitura si në tabelën në vijim:

Tabela Nr. 67: Mbeturinat të paspecifikuara ndryshe në listë		
Kodi	Emërtimi	Lloji hyrjes
<b>16 01</b>	<b>Mbeturinat nga automjetet mbeturinë nga mjetet e ndryshme transportuese (përfshi makinerin e ërndë) dhe mbeturinat nga çmontimi i automjeteve mbeturinë dhe mirëmbajtja e automjeteve (përpos 13, 14, 16 06 dhe 16 08)</b>	
16 01 04*	Automjetet mbeturinë	ARr
16 01 07*	Filtra vaji	ARr
16 01 08*	Komponente që përmbajnë merkur	ARr
16 01 09*	Komponentë që përmbajnë PCB	ARr
16 01 10*	Komponente shpërthyes (p.sh. thasë ajri)	ARr
16 01 11*	Tampone frenash që përmbajnë azbest	ARr
16 01 13*	Lëngje frenash	ARr
16 01 14*	Lëngje antingrirës që përmbajnë substanca të rrezikshme	ARr
16 01 21*	Përbërës të rrezikshëm, tjera nga ato të përmendura në 16 01 07 deri 16 01 11, 16 01 13 dhe 16 01 14	ARr
